

### Përmbaresit Gjenocid mbi qytetarët

Fq.5



### PËRPLASJE TOTALE Donald Trump dhe FBI

Fq.17



### Rizgjedhja e Putinit varet nga gratë

Fq. 22



# Koha

www.koha.mk



## KOHA për sport

Fq. 12-15

### FORUM

#### Ismail Kadare dhe Ukshin Hotin, këta kolosë të intelektualizmit shqiptar



Ismail Kadare në vitin 1997 për këtë qëllim zgjodhi idenë që Ukshin Hotit që ndodhej në burgun e Nishit t'ia dërgojë fshehurazi një sërë pyetjesh dhe sëbashku me përgjigjet nga Ukshin Hoti ti botojë në librin me titull "Bisedë përmes hekurash"

Fq.10-11

### RAJON

#### "Der Standard": Marrëveshja historike Kosovë-Serbi, në fund të vitit të ardhshëm

Fq.16

### KULTURË

#### Në panairin e librit "Livre Paris", edhe letërsia shqipe

Fq.9



## KUR PROKURORI MERR NË MBROJTJE VRASËSIN

# HESHTJA E 90 SEKONDAVE!



KOHA KUR BOBAN ILIÇ LARGOHET NGA VENDI I PËRLESHJES



KOHA KUR BOBAN ILIÇ KTHEHET NË VENDIN E NGJARJES DHE HAKMERRET

Nga një analizë e gazetës KOHA që i bën pamjeve të xhiruara nga kamerat e sigurisë, rezulton se pas përfundimit të përleshjes mes dy grupeve, e deri te momenti i kobshëm, kur Boban Iliç kthehet me veturën e tij dhe vret Almirin, kalojnë gjithsej 90 sekonda. Në rrethana tjera, ky moment do të vërtetonte akuzën e vrasjes me paramendim, por në rastin konkret prokurorët e vendit as që e përmendin këtë fakt

Fq.3

## Në pritje të partnerëve të rijë shqiptarë

Shkup, 18 mars - Deri në fund të kësaj jave mund të nisin zyrtarisht bisedimet mes LSDM-së dhe partive shqiptare për të zgjeruar koalicionin qeveritar. Deri më tani vërehet se nga të gjitha partitë shqiptare Lëvizja BESA me kryetar Afrim Gashin ka gjasa më reale të jetë pjesë e Qeverisë. Por për t'u zgjeruar më shumë Koalicioni Qeveritar përveç Lëvizjes BESA me kryetar Afrim Gashin, edhe me partitë tjera si me Lë-

vizjen BESA të Bilall Kasamit, ASH-në e Ziadin Selës dhe PDSH-në e Menduh Thaçit, vëshirë se do të pajtohet BDI të gjegjësisht të heq diçka nga kulaçi i saj qeveritar. Ajo që tashmë është e sigurt se Qeveria do të zgjerohet siç e tha prerë kryeministri Zoran Zev ditë më parë. Nga qëndrimet partiake shihet se veç më kanë lëvizur gjërat në drejtim të nisjes së negociatave.

Fq.4





## EDITORIAL

# INSTITUCIONET DESTABILIZUESE



Emin AZEMI

Destabilizimi i një shoqërie nuk mund të ketë përmasa dramatike, nëse institucionet e shtetit janë stabile. Në Maqedoni po ndodhë e kundërta. Shoqëria po arrin të ruaj njëfarë kohezioni sociale ndëretnik, mirëpo institucionet janë ato që po tregojnë paqëndrueshmëri, duke u bërë shembull i keq i keqmenaxhimit. Është për tu habitur se si ky shtet po funksionin sipas këtij modeli të dyzuar, ku institucionet jo rrallë punojnë kundër njëri tjetrit. Mjafton të analizohet puna e Presidencës së Ivanovit tash e disa vite, por edhe funksionimi i sistemit të gjyqësisë, institucione këto që janë bërë burim potencial krizash e ngërçesh, me pasoja shumë të rënda për qetësinë e përgjithshme dhe rendin kushtetues të vendit, për të ardhë në përfundim se kalblja nga brenda e ka emrin destabilizim institucional.

Në Maqedoni ende ka mbetje nga sistemet e kaluara, që nuk po munden të inkorporohen në realitetin e ri politik e shoqëror. Përpjekja e fundit e presidentit Ivanov për të bllokuar dekretimin e Ligjit të gjuhëve shkon në favor të tezës së institucioni që ai drejton tash më është shndërruar në një destabilizues potencial të shtetit. Sjellja e Presidentit është në frymën e ideologjisë së partisë së cilës i përket dhe ky është recidivi i fundit i një pushtetit që po mundohet të rishfaq trajtat e krizës në forma të ndryshme. Veprimi i tij në kundërshtim me frymën e Kushtetutës së vendit dhe arbitrariteti vulgar që tejkalon vullnetin e shumicës, janë konturat e një formati diktatorial, që fuqinë e vendimarrjes e mbështet mbi teke dhe njëanshmëri.

Në anën tjetër kemi edhe sistemin e drejtësisë (gjykatat dhe prokuroritë), i cili gjithnjë e më tepër po dëshmon se është një burim potencial destabilizimi në vend. Epilogu i këtij destabilizimi mund të ketë pasoja dhe përmasa të ndryshme, ndaj i takon politikës (Qeverisë dhe Kuvendit) që të ndërhyjë sa më shpejt me një ridizajnim ligjor që do ta garantonte sistem të parvarur e profesional gjyqësor. Nëse vazhdohet me këto praktika skandalozë gjyqësore, ka rrezik që situatë të delë nga kontrolli, kurse përgjegjësia për këtë do të bie domosdoshërisht mbi politikën.

Qytetarët janë të vetëdijshëm se pakënaqësitë e tyre mund të keqpërdoren nga shumë qarqe e interesa që kanë për qëllim të krjojnë alibira për destabilizim. Shqiptarët janë të fundit ata që janë të interesuar për ndonjë stabilitet, ndaj edhe protesta e paralajmëruar për rastin "Almir Aliu" ka për qëllim më tepër senzibilizimin e një deformimi gjyqësor që po bëhet në kurriz të etnisë shqiptare. Kjo protestë është sublimim i shumë pakënaqësive ndaj gjyqësisë dhe askush nuk do të duhej ta kuptojë se shqiptarët janë në anën e kundërt të interesave jetike të Maqedonisë. Përkundrazi, shqiptarët po kërkojnë të trajtohen denjësisht, madje edhe kur ulen në bankën e zezë dhe askush deri më tani nuk ka marrë në mbrojtje asnjë keqbërës në radhët e shqiptarëve.

Destabilizimi institucional tani për tani është kërcënim më serioz për Maqedoninë. Sa më parë që të evitohet ky kërcënim, aq më lehtë mund të shihen shtigjet nga duhet të shkojnë reformat në këtë vend. Në të kundërtën, forcat antireformuese, përmes institucioneve të tyre, siç janë Presidenca dhe gjykatat, bashkë me prokuroritë, shumë lehtë mund të shërbejnë si leva për të lëvizur energji të shumta negative brenda një shoqërie të pakënaqur.

## "Çfarë debate "civilizues" kërkon ambasadori Timonie?!"



"Shkëlqesia e tij, ambasadori i Francës në Maqedoni, Kristian Timonie, nuk është i kënaqur me miratimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve. Kërkon debat civilizues. Sigurisht e ka fjalën për modelin e debatit "civilizues" të ish kryeministrit Gruevski dhe kryetarit të shtetit Gjorgje Ivanov. Lajthitje!", ka shkruar në profiling e tij në FB, shkrimtari Bardhyl Zaimi.

## "Republika e Mafias"



"Banana republic" është një shtet, qeverinë e të cilit e ndërron me fare pak përpjekje. Por shteti shqiptar është një shtet ku nuk ka kush fuqi të ndërrojë qeverinë kaq lehtë. Kontrolli i parisë është i thellë. Nuk ka njerëz të zevendesojnë. Dhe populli (duket se mendon që) është mirë në këtë gjendje. Një shtet me truste dhe organizata kriminale është problem sepse me dikë që është 99-sh ndërron pronarin me shumë lehtësi. E kështu kështu, "Republika e Mafias" është një problem për të gjithë, kam shkruar në profiling e tij në FB. Prof. Shenasi Rama

## "Ankesat e Aktivistëve"



"Disa aktivistë dhe anëtarë kryesisht të Qendrave të Lëvizjes Vetëvendosje ditëve të fundit po ankohen se ish-Sekretari Organizativ, Dardan Molliqaj po organizon takime ilegale me aktivistët e Lëvizjes. Në këto takime, sipas aktivistëve, ai po pretendon se ai, dhe përkrahësit e tij, do të bëjnë një 'çarje të madhe' në organizatë, duke aluduar edhe për krijimin e një partie të re. Në këto takime, sipas aktivistëve, janë përmendur shifra që kanë të bëjnë me dëmet që ai synon t'ia shkaktojë Lëvizjes Vetëvendosje. Secili ka të drejtën e fjalës së lirë, por kjo e drejtë dhe pozicionet që njerëzit mbajnë brenda Lëvizjes Vetëvendosje nuk mund të keqpërdoren duke përhapur dezinformata brenda Lëvizjes, me qëllim të dobësimit të saj. Veprime e tilla të dëmshme janë të papranueshme dhe si të tilla duhen të ndalen menjëherë. Në Lëvizjen Vetëvendosje, angazhimi dhe puna e organeve vendimmarrëse dhe organizimi i aktiviteteve po vazhdojnë, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e brendshme, si dhe po respektohet demokracia e brendshme dhe parimet tona politike. Përkrahja e madhe për Lëvizjen që po ndodh këto ditë është garancia më e mirë se asnjë manipulim nuk mund ta ndalë rritjen dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, prandaj çfarëdo përpjekje për dobësimin e Lëvizjes Vetëvendosje është e kotë", ka komentuar zhvillimet e fundit përmes FB, sekretari Organizativ i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi.

## Sektorit privat i intereson vetëm kualiteti e jo gjinia

"Jam i habitur si mundet LDK-ja (Parti e djathtë) me propozu në kompani private të jenë me ligj në Borde të jenë 40% gjini femërore. Sektori privat vendos vet se kush duhet të jetë anëtarë i Bordit femër apo mashkull. Për arsyeje se sektori privat i intereson vetëm kualiteti e jo gjinia. Nëse e meritojnë gjinia femërore pse mos të jenë në Borde. 100%. ZOT BONE HAJR....", ka komentuar në profilin e tij në FB, ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, biznesmeni Hashim Deshishku, pas miratimit të një amendamenti të Ligjit për Shoqëritë Tregtare që ka të bëjë me përfshirjen e grave në Bordet e shoqërive aksionare me kuotën 40% që është propozuar nga deputetja Mimoza Kusari.

## MEDIACitate

### Raketat e Koresë së Veriut mund të arrijnë në Europë



Zëvendësdirigjenti i Shërbimit Federal gjerman të Inteligjencës (BND) Ole Diehl ka thënë para deputetëve se raketat e Koresë së Veriut tani janë në gjendje të bartin armatim bërthamor dhe se mund të arrijnë deri në Gjermani dhe në Evropën Qendrore, shkruan gazeta "Bild am Sonntag", ndërsa transmetojnë agjencitë botërore. Gazeta shkruan se Diehl, sipas një pjesëmarrësi anonim të brifingut, në një takim me dier të mbyllura u ka thënë deputetëve të Bundestagut se vlerësimi i këtyre mundësive të Pjong-Jangut janë "të sigurta". Ai ka shtuar se BND i sheh bisedimet mes dy Koreve si shenjë pozitive. Agjencia Reuters njofton se nga BND nuk ka pasur asnjë koment ndaj këtij lajmi. ("Bild am Sonntag")

### KQZ në Rusi thotë se ka qenë cak i një sulmi kibernetik

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Rusi ka njoftuar se ueb-faqja e tij ka qenë cak i një sulmi të pasuksesshëm kibernetik, në kohën kur në Rusi po mbahen zgjedhjet presidenciale. Kryetarja e Komisionit, Ella Pamfilova ka thënë tentim-sulmi është kryer nga kompjuterët nga 15 shtete të ndryshme, por nuk ka treguar se për cilat shtete bëhet fjalë. Pamfilova ka thënë se kjo ka ndodhur në kohën kur në Lindjen e Largët të Rusisë kishte nisur procesi zgjedhor. Autoritetet në Shtetet e Bashkuara janë duke hetuar për ndërhyrjen e dyshuar ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane më 2016, ndërkaq autoritetet ruse pretendojnë se fuqitë e huaja po tentojnë që të ndërhyjnë në zgjedhjet presidenciale në Rusi. (REL)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### A E DINI SE LULET JANË "MAGJISTARËT" E FIZIKËS?

Lulet tashmë konsiderohet edhe magjistarë të fizikës. Manipulojnë dritën dhe forcat elektrostatische, dhe përdorin truke mekanike, vetëm e vetëm që të bëjnë të mundur pllenimin. Procesin e shpjegon studimi i publikuar në revistën "New Phytologist" nga dy botanikë, Edwige Moyroud e Beverley Glover, të dy studiues dhe profesorë në universitetin britanik të Cambridge. Për shumë persona shpjegon Glover, mund të jetë

e habitshme që bimët përdorin ligjet e fizikës në avantazhin e tyre për të bërë të mundur procesin e pllenimit. Por në fakt cdo gjë ka kuptim, dhe evolucioni është bërë i mundur falë përdorimit të mundësi të mundshme në funksion të përmirësimit të riprodhimit të bimëve. Studimi bazohet në gjetjet e fundit si bimët përdorin lulet e tyre për garantuar riprodhimin, dhe se si përdorin ligjet e fizikës në avantazh të tyre.



KUR PROKURORI MERR NË MBROJTJE VRASËSIN

# HESHTJA E 90 SEKONDAVE!

Nga një analizë e gazetës KOHA që i bën pamjeve të xhiruara nga kamerat e sigurisë, rezulton se pas përfundimit të përlshjes mes dy grupeve, e deri te momenti i kobshëm, kur Boban Iliç kthehet me veturën e tij dhe vret Almirin, kalojnë gjithsej 90 sekonda. Në rrethana tjera, ky moment do të vërtetonte akuzën e vrasjes me paramendim, por në rastin konkret prokurorët e vendit as që e përmendin këtë fakt

Koha Omer Xhaferi &amp; Fatos RUSHITI

Shkup, 18 mars – Arsyetimi i vendimit të Prokurorisë Republikane, për rikualifikimin e aktakuzës në rastin e vrasjes së 4-vjeçarit Almir Aliu, “nga vrasje me paramendim në aksident komunikacioni”, është bërë kryesisht për të marrë në mbrojtje vrasësin Boban Iliç, që për Prokurorinë është vetëm një shofer i pakujdesshëm, i cili pasi nuk ka respektuar rregullat e komunikacionit, pa dashur ka shkakuar “aksident të rëndë me pasojë -vdekje”.

Shpejtësia e pakontrolluar e veturës, errësira, prezenca e madhe e qytetarëve dhe veturave, udhëkryqi i paqartë e kështu me radhë, paraqesin disa prej arsyeve të cilat janë përfshi në aktakuzën e re kundër vrasësit, Boban Iliç.

Nga një analizë e videomaterialit mbi përlshjen e cila rezulton me epilog fatal për Almirin e vogël, që ka bërë gazeta KOHA, rezulton një situatë krejt ndryshe, që mundohet ta fshehtë Prokuroria maqedonase. Bëhet fjalë për kohën pasi përfundon përlshja mes dy grupeve dhe momentit të vrasjes së Almirin nga ana e Boban Iliçit me veturën e tij. Janë në pyetje gjithsej 90 sekonda nga ndarja e dy grupeve e deri te momenti i vrasjes që mundohet ta fshehtë Prokuroria. Xhirimet nga kamera që qarkullojnë në opinion tregojnë se përlshja përfundon në orën 22:33,00, kur shihet qartë se dy vëllezërit Iliç largohen me automjetin e tyre. Prokuroria në aktakuzën e vet thotë se vëllezërit Iliç janë ndjekur nga tre personat e akuzuar për dhunë, në mesin e tyre edhe babai i Almirin, Sedat Aliu. Me këtë aktakuzë Prokuroria mundohet ta arsyetojë vrasësin, duke lënë të kuptohet se ai “për të shpëtuar veten, në panikë duke ikur edhe nga babai i Almirin”, nga pakujdesia me automjetin e tij godet Almirin, nënën e tij dhe Sedat Aliun. Shtrohet pyetja, si është e mundur që Sedati ta ketë ndjekur Bobanin dhe në të njëjtën kohë së bashku me fëminë dhe bashkëshorten e tij të hyjnë nën rrotat e Mercedesit të vrasësit?! Përgjigja nga kamerat e sigurisë është te këto 90 sekonda, nga ndarja e dy grupeve e deri te momenti i vrasjes së Almirin që ka ndodhur në orën 22:34:40 sekonda.

Ja si e arsyeton Prokuroria vrasësin! Prokuroria mundohet ta arsyetojë vrasësin, duke lënë të kuptohet se ai “për të shpëtuar veten, në panikë duke ikur edhe nga babai i Almirin”, nga pakujdesia me automjetin e tij godet Almirin, nënën e tij dhe Sedat Aliun. Shtrohet pyetja, si është e mundur që Sedati ta ketë ndjekur Bobanin dhe në të njëjtën kohë së bashku me fëminë dhe bashkëshorten e tij të hyjnë nën rrotat e Mercedesit të vrasësit?! Përgjigja nga kamerat e sigurisë është te këto 90 sekonda, nga ndarja e dy grupeve e deri te momenti i vrasjes së Almirin që ka ndodhur në orën 22:34:40 sekonda.

Mercedesit të vrasësit?! Përgjigja nga kamerat e sigurisë është te këto 90 sekonda, nga ndarja e dy grupeve e deri te momenti i vrasjes së Almirin që ka ndodhur në orën 22:34:40 sekonda. Gjatë kësaj kohe, dy vëllezërit Iliç janë larguar nga vendi i ngjarjes. Në të njëjtën kohë edhe babai, Sedati, i cili më



KOHA KUR BOBAN ILIÇ LARGOHET NGA VENDI I PËRLSHJES



KOHA KUR BOBAN ILIÇ KTHEHET NË VENDIN E NGJARJES DHE HAKMERRET

herët e ka ndjekur nga pas veturën e Bobanit, ndërsa gjatë kësaj kohe prej 90 sekondave, ai është kthyer dhe është bashkuar me bashkëshorten dhe Almirin. Ndërkohë, gjatë këtyre 90 sekondave, tani, pa u ndjekur nga askush, Boban kthehet dhe hakmerret me automjetin e tij duke goditur Almirin që ishte me nënën dhe babanë e tij Sedatin. Në këto 90 sekonda qëndron edhe motivi i vrasjes me para-

mendim, që heshtet qëllimisht nga Prokuroria e shtetit, e cila hapazi vihet në mbrojtje të vrasësit Boban Iliç.

Në favor të kësaj shkon edhe skena para burgut hetues të Shutkës, kur gazetari i TV 21 kërkon nga Boban Iliç të deklarojë nëse është përdur për vrasjen e 4 vjeçarit. Përkundër insistimit të gazetarit, vrasësi Iliç e kërcënon atë me fjalët “nuk dua të kthehem për-

sëri në burg”, duke ia lënë me dije që të thejë qafën se mund ta pësojë edhe ky.

Vlen për t'u theksua edhe një moment tjetër interesant. Kjo video që është dëshmi kryesore materiale për ndodhinë e asaj nate, ishte publikuar në Youtube nga i vëllai i Boban Iliç. Por si duket, nga shkaqe të panjohura, tani ky material është fshirë dhe nuk mund të gjendet në internet.

## MINISTRIA E DREJTËSISË, TË PËRFSHIHET NË RASTIN E ALMIRIT

Ish prokurori publik dhe ish anëtar i Këshillit të prokurorëve publik, tani avokat Miralem Hasani, për gazetën KOHA, sqaron rrugët ligjore se si mund të vijë deri tek rikualifikimi i veprës penale dhe i akuzuari Boban Iliç të merr dënimin e merituar. Siç thotë avokati Miralem Hasani, korrektor në drejtësi sipas ligjit, në Maqedonia është Gjykata e Apelit, e cila sipas tij edhe në rast se kthen në rishqyrtim në shkallë të parë dhe kjo e fundit nuk e rikualifikon veprën penale sipas udhëzimeve të saj, nëse rast ankesë të palës mbrojtës Gjykata e Apelit më pas mund ta rikualifikojë vetë aktakuzën dhe të vendosë në mënyrë meritore. “Sipas ligjit ka afat 15 ditore që pala mbrojtës apo prokuroria të ankohen ndaj vendimit të shkallës së parë deri tek Gjykata e Apelit. Kjo e fundit mundet të ndryshojë, të vërtetojë apo në rastin më të mirë mundet të kthejë në rishqyrtim lëndën në shkallë të parë dhe të urdhërojë këtë të fundit që të merr për bazë dëshmitë se nuk japin figurës e veprës penale për të cilën ka pasur aktgjykim më herët për rastin në fjalë. Gjykata e shkallës së parë duhet ta udhëzojë Prokurorinë që të

ndryshojë veprën penale. Nëse kjo nuk e bën atëherë ex-officio, atë mund ta bëjë Gjykata e shkallës së parë, pra të ndryshojë veprën penale dhe të vendosë për dënimin meritore. Në rast se këtë nuk e bën dhe len në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë përsëri ka rrugë ligjore përmes ankimit të palës mbrojtës në gjykatën e apelit dhe të kërkojë seance publike. Gjykata e Apelit në këtë rast mund të vendosë vetë për dënimin. Pas kësaj nëse pala tjetër ankohet lënda shkon në Gjykatën supreme. Kjo gjykatë me automatizim bëhet gjykatë e shkallës së dytë ndërsa Gjykata e apelit bëhet gjykatë e shkallës së parë dhe Gjykata e shkallës së parë më nuk ekziston në procedurë pra bie. Gjykata Supreme lëshohet në vlerësimin e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe vendosë në mënyrë meritore”, thotë për gazetën KOHA avokati Miralem Hasani. Profesori Universitar, Bashkim Selmani, pajtohet me avokatin Miralem Hasani, se rrugët ligjore janë të hapura për të reviduar aktgjykimin për rastin e Almirin, por kjo thotë mund të zgjas shumë, me muaj të tërë, në

kohën kur vrasësi është në liri. Profesori Selmani, thotë se vullneti duhet të jetë ndërnacional për të ndërhyr sa më shpejtë në këtë proces përmes Ministrisë së Drejtësisë. Në kohën kur këtë ministri e udhëheq kuadro shqiptar, sipas Selmanit, e njëjta duhet t'i duhet ti drejtohet menjëherë Këshillit Gjyqësor që të bëjë një revizion të plotë të këtij procesi.

“Dakord me rrugët ligjore që mundësojnë dhe rikualifikimin e veprës penale, por kjo mund të zgjas më muaj të tërë në kohën kur vrasësi është në liri dhe kur dihet si shkon puna tek gjykatat tona. Në rrugën më të mirë duhet të kemi vullnet ndërnacional përmes veprimit të Ministrisë së Drejtësisë kur kemi ministrin shqiptar. Kjo ministri duhet të kërkojë Këshillit Gjyqësor të bëjë një revizion të plotë procesit të deritashëm gjyqësor dhe të nxjerr në pah të gjitha dëshmitë dhe faktet për të akuzuarin Iliç duke kërkuar përgjegjësi penale ndaj atyre prokurorëve dhe gjykatësve që vepruan në atë mënyrë dhe rasti menjëherë të kthehet në rishqyrtim”, thotë profesori Selmani.



NEGOCIATA TË REJA PËR ZGJERIMIN E QEVERISË

# NË PRITJE TË PARTNERËVE TË RIJË SHQIPTARË

Nga LSDM thonë se ka pasur negociata joformale me partitë shqiptare për ndarjen e kulaçit qeveritar por që mohohet nga Lëvizja BESA, gjegjësisht nga të dy krahët e saj ai i Bilall Kasamit dhe Afrim Gashit si dhe nga Aleanca për Shqiptarët. Kjo e fundit më shumë është e interesuar të mund BDI-në zgjedhje eventuale të parakohshme përmes një fronti të madh opozitar se sa të jetë pjesë e qeverisë

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 18 mars - Deri në fund të kësaj jave mund të nisin zyrtarisht bisedimet mes LSDM-së dhe partive shqiptare për të zgjeruar koalicionin qeveritar. Deri më tani vërehet se nga të gjitha partitë shqiptare Lëvizja BESA me kryetar Afrim Gashin ka gjasa më reale të jetë pjesë e Qeverisë. Por për t'u zgjeruar më shumë Koalicioni Qeveritar përvë Lëvizjes BESA me kryetar Afrim Gashin, edhe me partitë tjera si me Lëvizjen BESA të Bilall Kasamit, ASH-në e Ziadin Selës dhe PDSH-në e Menduh Thaçit, vështirë se do të pajtohet BDI të gjegjësisht të heq diçka nga kulaçi i saj qeveritar. Ajo që tashmë është e sigurt se Qeveria do të zgjerohet siç e tha prerë kryeministri Zoran Zev ditë më parë. Nga qëndrimet partiake shihet se veç më kanë lëvizur gjërat në drejtim të nisjes së negociatave.

## ZGJERIMI I KOALICIONI QEVERTAR – I DOMOSDOSHËM

Nga LSDM thonë se ka pasur negociata joformale me partitë shqiptare për ndarjen e kulaçit Qeveritar por që mohohet nga Lëvizja BESA, gjegjësisht nga të dy krahët e saj ai i Bilall Kasamit dhe Afrim Gashit si dhe nga Aleanca për shqiptarët. Megjithatë nga Lëvizja BESA pranojnë se ka pasur komunikime të pandërprera me funksionarë të lartë të LSDM-së por jo dhe të negociojnë pushtetin. Jo zyrtarisht për gazetën KOHA nga LSDM konfirmojmë se janë zhvilluar negociata me mes funksionarëve të lartë të kësaj partie dhe partive shqiptare por që ende nuk kanë arritur të ndërtojnë një ofertë politike.

"Ne jemi të hapur për të gjitha partitë shqiptare që të jenë pjesë e Qeverisë. E dini se disa parti kanë disa problem mes vete por ne do të shohim disponimin e tyre për të qenë pjesë e Qeverisë. Mund të

them se nga LSDM ka pa pasur negociata me partitë shqiptare por ende nuk kemi arritur të ndërtojmë një ofertë politike për ta", thonë nga departamenti për informim i LSDM-së. Nga ky departament shojnë së shumë shpejtë ditëve në vijim edhe zyrtarisht mund të nisin bisedimet për zgjerimin e Qeverisë me partitë tjera shqiptare ndërsa qëllimi është që sa më shumë të zgjerohet koalicioni qeveritar. Nga Lëvizja BESA me kryetar Afrim Gashin thonë se me LSDM ka pasur komunikim të vazhdueshëm por që ende nuk ka arritur të konkretizohet. Nga kjo parti thonë se javën që vjen do të dalin gjëra në konkrete në drejtim të nisjes së bisedimeve për të qenë pjesë e Qeverisë. "Me LSDM-në kemi kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm, por sa i përket përfshirjes së Lëvizjes BESA në qeveri ky komunikim ende nuk ka arritur të konkretizohet. Besoj që gjatë javës që vjen për opinionin do të ketë gjëra më konkrete në këtë drejtim", thotë për gazetën KOHA zëdhënësi Orhan Murtezani. Ndërkaq nga Lëvizja BESA me kryetar Bilall Kasamin thonë se me funksionarë të LSDM-së kanë pasur komunikim por jo në nivel të negociatave për të qenë pjesë e Qeverisë. "Nëse do të kemi një ofertë konkrete do ta shqyrtojmë me seriozitet.

Siç e ka thënë kryetari Kasami Lëvizja BESA në këtë rast do të shikojë interesin shqiptar nuk do të pranojë vetëm çka ti ofrohet nga LSDM. Realisht thënë zyrtarë të LSDM në biseda individuale kanë shprehur gatishmërinë për neve që të kontribuojmë në reformat që po bën Qeveria dhe i jemi mirënjohës por më shumë nuk ka pasur deri më tani rreth hyrjes në Qeveri", thonë funksionarë të lartë të kësaj partie.

## BDI-së NUK I NGUTET

Ndryshe nga BDI thonë se rreth zgjerimit të Qeverisë kryetarët e dy partive Zoran Zaev dhe Ali Ahmeti kanë linja të drejtpërdrejta komunikimi por se si parti nuk nguten për këtë çështje. "BDI veç më korri një sukses të madh me ligjin për shqipe dhe do të vazhdojë të realizojë programin e vetë politik në Qeveri. Ne jemi mirë, as nuk na ngutet as nuk na jepet", thonë funksionarë të lartë të BDI-së. Nga ana tjetër Aleanca për Shqiptarët më shumë është e interesuar të mund BDI-në zgjedhje eventuale të parakohshme përmes një fronti të madh opozitar se sa të jetë pjesë e qeverisë. Flakron Bexheti nga ASH duke u thirru në atë se shumica parlamentare aktualisht është e paqëndrueshme për të realizuar

agjendën reformuese ai flet për dy zgjidhje ose të shkohet në zgjedhje të parakohshme ose të ketë zgjerim të plotë të shumicës parlamentare. "Ne si Aleanca për Shqiptarët, vlerësojmë se shumica parlamentare nuk është e qëndrueshme dhe e mjaftueshme për të sjellë ligje të favorshme për shtetin dhe integritetin e vendit në BE. Ka dy zgjidhje si mund të rregullohet kjo: e para të shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare, dhe e dyta të zgjerohet koalicioni qeverisës dhe shumica parlamentare. Aleanca për Shqiptarët ka vlerësuar se kjo shumicë parlamentare nuk e ka forcën e mjaftueshme politike për të ecur proceset përpara. Vlerësojmë se partitë opozitare shqiptare duhet të jenë të koordinuara dhe të unifikuara për këtë çështje, dhe duhet të zgjedhin mes një fronti opozitar shqiptar dhe mes bllokut të pushtetit. Ne kemi deklaruar se jemi të gatshëm edhe për zgjedhje parlamentare se besojmë në forcën tonë", thotë Flakron Bexheti.

Sa i përket pjesëmarrjes në Qeveri Flakron Bexheti thotë se në konsultim me organet partiake dhe me miqtë ndërkombëtar do të marrin një qëndrim nëse do të kenë ftesë zyrtare. Por më e rëndësishme për ASH sipas Flakron

Bexhetit është që të fitojë verdiktin e popullit shqiptar se sa pjesëmarrja në Qeveri.

"Sa i përket pjesëmarrjes sonë në qeveri të zgjeruar, e para s'kemi marrë një ftesë të tillë zyrtare, në qoftë se do kemi, sigurisht se ne konsultim me organet tona partiake dhe miqtë tonë ndërkombëtar do ta kishim marrë një qëndrim. Por ajo që është e rëndësishme për ne është ta fitojmë verdiktin e shqiptarëve dhe në Qeveri të jemi si fitues, vetëm në këtë mënyrë do të artikulohej drejt zëri i shqiptarëve, si dhe kthimi i shpresës për një jetë të mirë, duke krijuar vërtetë kushte politike për funksionim e shtetit ligjor, drejtësisë, luftës ndaj korrupsionit, si dhe për të krijuar kushte politike për një barazi ekonomike-politike mes maqedonasve dhe shqiptarëve duke hapëruar se bashku në BE dhe NATO", theksoi për gazetën KOHA Flakron Bexheti nga Aleanca për shqiptarët.

Por për kthim në Qeveri lideri i ASH-së dy ditë më parë tha se në politikë asnjëherë nuk ka jo. "Nuk besoj se do ketë shanse të kthehemi në qeveri, sepse punohet për ndershmëri. Por, në politikë nuk ekziston ajo 'jo', por nga ana tjetër në këto rrethana jo", ka deklaruar Ziadin Sela pr radion "Evropa e Lirë".



## PROTESTË KUNDËR LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Shkup, 18 mars - Para Qeverisë së RM-së sot u mbajt protestë kundër ligjit për përdorimin e gjuhëve, të cilin Qeveria e Maqedonisë e miratoi më 14 mars. Qytetarët e pranishëm u tubuan që

ta shprehin revoltin e tyre kundër këtij ligji dhe e porositën presidentin Gjorge Ivanov që të mos e nënshkruajë dekretin, për, siç thanë, të mos vendoset "dygjuhësia në Maqedoni".

Dje kishte protesta edhe nëpër disa qytete të Maqedonisë, kryesisht para shtëpive të deputetëve të LSDM-së, të cilët votuan për ligjin për përdorimin e gjuhëve.





Pavarësisht joshjeve financiare, detyrime ligjore që shkollat të planifikojnë me patjetër programe me karakter multietnik, integrimi ndëretnik në shkolla mbetet shumë larg kuptimit të mirëfilltë të fjalës. Aktivitet "integruese" janë të kufizuara vetëm në programe të karakterit zbatimës

## INTEGRIMI NDËRETNIK NËPËR SHKOLLA

## JO NGA QEJFI POR NGA HALLI



Pavarësisht joshjeve financiare, detyrime ligjore që shkollat të planifikojnë me patjetër programe me karakter multietnik, integrimi ndëretnik në shkolla mbetet shumë larg kuptimit të mirëfilltë të fjalës. Aktivitet "integruese" janë të kufizuara vetëm në programe të karakterit zbatimës. Një Analizë e USAID-it e publikuar në vitin 2016 dhe që ka të bëjë me realizimin e Projektit "Integrimi Ndëretnik në Arsim" (PINA) tregon se pjesa më e madhe e aktiviteteve të përbashkëta, mes nxënësve të etniteteve të ndryshme kanë karakter zbatimës dhe realizohen në shkollat ku mësimi zhvillohet në dy dhe më tepër gjuhë. Rastet kur këta aktivitete përfshijnë dy ose më tepër shkolla ku mësimi

zhvillohet vetëm në një gjuhë, janë të pakta. Në instancë të fundit, integrimi ndëretnik do të duhej të ndodhet nga dëshira dhe jo nga halli. E, nëse do ta analizonim këtë dimension të projektuar në organizimin e mbrëmjeve të maturës dhe gjysmë maturës, do të vinim në përfundim se shkollat (nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit) nuk e pëlqejnë aspak integrimin ndëretnik. Po ta kishin parapëlqyer një gë të tillë, do të festonin bashkë mbrëmjet e maturës dhe gjysmë maturës. Në Maqedoni janë 433 shkolla fillore dhe të mesme, ndërsa në periudhën e viteve 2011-2015 janë zhvilluar në total 1.563 aktivitete të përbashkëta të të gjitha kategorive Analiza e USAID-it, vëren

gjithashtu se ky numër i aktiviteteve është evidentuar në bazë të asaj që kanë deklaruar shkollat, pra jo në bazë të konfirmimeve. Sepse, sikurse nënvizohet aty "jo çdo herë shkollat janë në gjendje të vërtetojnë aktivitete e deklaruara", pra nuk përjashtohet mundësia që edhe të fryjnë pjesëmarrjen e tyre në aktivitete me karakter ndëretnik, në emër gatishmërisë për të mbështetur PINA-n. Ky projekt, i cili nisi nga vitit shkollor 2011/2012 (në përpjekje për të ndihmuar zbatimin e Strategjinë për Arsim të Integruar) ka përfshirë të gjitha shkollat, janë realizuar 325 programe ku janë përfshirë 60.000 nxënës dhe 12.000 mësimdhënës dhe janë harxhuar 1.5 milion dollarë amerikan. Por,

janë të vakëta rezultatet në frymën e integrimin të mirëfilltë ndëretnik. Integrimi ndëretnik dominohet nga shëtitje, vizita dhe aktivitete sportive shumë më tepër se sa me organizim të mbrëmjeve të maturës apo aktivitete me karakter humanitar.

Nga viti shkollor 2011/2012 deri vitin shkollor 2015/2016 ka pasur vetëm 41 matura të përbashkëta edhe atë 33 organizime të këtilla (festim mature) janë në shkollat ku mësimi zhvillohet në dy apo tre gjuhë të ndryshme. Madje edhe brenda këtij rrethi dominojnë organizimet për moshat e vogla, pasi 24 mbrëmje të përbashkëta mature janë në shkollat fillore dhe 9 në shkollat e mesme. Tetë organizimet e mbetura të maturës janë mes shkollave një gjuhësore, të gjitha të nivelit të arsimit fillor të organizuara në gjithë Maqedoninë në harkun kohor prej pesë viteve. Pra një tregues më tepër se sa simbolik i integrimin ndëretnik në Maqedoni. Nëse shohim pjesëmarrjen e mbrëmjeve të maturës në kuadër të gjithë llojeve të aktiviteteve ndëretnike, i bie që ato ti kenë kontribuar integrimin me vetëm 2 për qind, pra kemi 41 mbrëmje mature në 1.563 aktivitete. Të gjitha këto mbrëmje, nëse i shohim të ndara vit për vit i bie të kemi mesatarisht nga 8 mbrëmje mature në vit në 433 shkolla fillore dhe të mesme gjithsej.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 18 mars - Në shtete pa demokraci të konsoliduar sikurse është Maqedonia, është e kotë të presësh rezultate në projekte që kanë për qëllim integrimin ndëretnik në sistemin arsimor dhe aq më tepër kur ata projekte bien në duart e politikanëve që udhëhiqen nga mendësia e standardeve të dyfishta dhe politikave diskriminuese në arsim. Jo shumë vite përpara kishim diskriminimin e hapur për vendosjen së maqedonishtes si lëndë të detyrueshme për shqiptarët nga klasa e parë. Kjo, jo vetëm që nuk i ndihmoi zbatimin në shkolla të Strategjisë "Hapa drejt integritimit arsimor", të sponsorizuar nga OSBE-ja, por forcoi ende më shumë rezistencën kundër programeve dhe strategjive të tilla. Pra, një hap i gabuar, i Strategjisë në fjalë thelloi ende më shumë ndarjet ndëretnike në sistemin arsimor.

## SEKTORI CIVIL NË PRAG TË PROTESTAVE

## PËRMBARUESIT PO USHTROJNË GJENOCID MBI QYTETARËT

Nëse Qeveria së shpejti nuk ndryshon ligjin për përmbarrim, organizatat joqeveritare si mbrojtëse e të drejtave të qytetarëve paralajmëron proteste masive ku do të ftohen të marrin pjesë 200 mijë qytetarë ndaj të cilëve përmbarruesit me ndihmën e shtetit me vite po ushtrojnë gjenocidit ndaj qytetarëve të varfër



nga Organizata Joqeveritare (OJQ) "Njeriu mbi profitin" e cila së bashku me OJQ-në "No Pasaran" dhe Konfederatën e organizatave sindikale në Maqedoni gati dy muaj mbledhin nënshkrime me moton "Stop Përmbaruesve" ku kërkojnë që përmbarruesit të kthehen në gjykatë dhe të bëjnë të njëjtën punë para se të hyn në fuqi Ligji për përmbarrim nga viti 2007. "Bllokimi i llogarive transakcionale 10 vitet e fundit që po bëhet nga ana e përmbarruesve është e jashtë ligjshme dhe me këtë nuk respektojnë ligjin për përmbarrim. Sipas Ligjit për qarkullim pagesor, vetëm një institucion shtetëror mund të miraton vendime për bllokim për

qarkullim pagesor gjegjësisht Drejtoria për të Hyra Publike (DHP). Kjo do të thotë se përveç DHP-së askush tjetër nuk ka autorizim ligjor të bëjnë veprime për pagesë me dhunë të borxheve. Ligji për përmbarrim saktëson se përmbarruesi ka të drejtë të dorëzojë kërkesë për pagesë me dhunë deri të bartësi për qarkullim pagesor, por jo edhe të merr vendim dhe të kërkojë nga bankat që të bllokoi llogarinë transakcionale të qytetarëve, dhe këtë kërkesë duhet ta bëjë deri të DHP-ja e jo te bankat" thotë Ana Gligorova.

Në anën tjetër Marjan Risteski nga Konfederatën e Organizatave Sindikale në Maqedoni (KOSM)

thotë se shteti kur bëhet fjalë për borxhet e qytetarëve të thjeshtë dhe borxhet që kanë organet shtetërore ndaj subjekteve të ndryshme atëherë vendoset në mbrojtje te organeve shtetërore të cilët më para te qytetarëve blejnë vetura luksoze me CO21mime shume të larta ndërsa lejon një gjenocid që përmbarruesit ua bëjnë qytetarëve të varfër duke i çuar ata në një varfëri tepër ekstreme.

"Nëse shteti mund të merr kredi dhe t'i deblokon llogaritë e komunave apo kryetarëve të komunave et cilët më para të qytetarëve kanë marre me kredi vetura luksoze dhe nuk e kthejnë kredinë për shkak se këta shteti në asnjë mënyrë nuk lejon që përmbarruesit tua bllokojnë xhiro llogaritë komunave atëherë pse mos të emeton letra me vlerë dhe më mjetet që do të grumbullohen nga shitja e bonove të thesarit t'ju mundëson qytetarëve që kanë borxhe të mbetura të marrin kredi nga bankat dhe at pa kamatë dhe të kthejnë të gjitha borxhet e mbetura. Propozimi ynë është nëse shteti bëhet garant ndaj

bankave dhe bankat u lejojnë kredi pa kamatë atëherë vlera e lejuar kredisë aspak mos t'i jepet qytetarit por në mënyrë direkte shumën e plotë kredisë së lejuar bankat ta transferojnë në llogarinë e kreditorëve ndaj të cilëve qytetarët kanë borxhe të mbetura", thotë Risteski. Risteski njëherit thotë se nëse ky propozimi i organizatave joqeveritare nuk merret parasysh nga qeveria aktuale atëherë ne si mbrojtës të drejtave të qytetarëve do organizojmë proteste ku do të ftojmë të marrin pjesë 200 mijë qytetarë ndaj të cilëve përmbarruesit me ndihmën e shtetit me vite po ushtrojnë gjenocidit ndaj qytetarëve të varfër. "Së shpejti do të organizojmë protesta masive ku presim të marrin pjesë mbi 200 mijë qytetarët të cilët janë në gjenocid financiar, ndërsa shteti mere pjesë në vjedhjen e padijet të parave të qytetarëve me llogaritë e mbyllura të qytetarëve nga ana përmbarruesve që në mënyrë direkte çojnë qytetarëve të drejtë një varfëria të skajshme", thotë Marjan Risteski kryetar i KOSM-së.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 18 mars - Për momentin 300 mijë qytetarë nuk mund të marrin rrogën, pensionin, apo ndihmat sociale për shkak përmbarruesit me vite u kanë bllokuar llogaritë transakcionale duke u marrë edhe denarin e fundit apo çdo denarë që ka qytetari në llogarinë transakcionale. Kështu thotë Ana Gligorova



## KRONIKA E POLLOGUT



## Shkolla e mesme e bujqësisë shënoi 90 vjetorin

Shkolla e mesme profesionale "Moshë Pijade" në Tetovë ka shënuar 90 vjetorin e themelimit. Në këtë manifestim për shënimin e 90 vjetorit përveç profesorëve të kësaj shkolle ka marrë pjesë edhe përgjegjësi për veprimtari publike dhe arsimore pranë komunës së Tetovës Ahmed Qazimi i cili në fjalën e tij përshëndetëse para të pranishmëve ka përmendur disa nga të ariturat e kësaj shkolle në vitet e fundit. Përndryshe shkolla e mesme profesionale komunale "Moshë Pijade"-Tetovë është themeluar në vitin e largët 1928, si shkollë e ulët e bujqësisë. Në vitin shkollor 1946/47 u zhvillua në shkollë të mesme bujqësore me shkollim tre vjecar, kurse në vitin 1950/51 kaloi në katërvjecare. Prej vitit 1960 shkolla mban emrin "Shkolla e Mesme Bujqësore "Moshë Pijade" – Tetovë. Në vitin 1961, viti i vdekjes së Moshë Pijades -15 mars është shpallur festa e patronatit të shkollës. Shkaku i lënjes pas dore të shoqërisë për bujqësinë dhe rritjes së nevojave të ekonomisë për profile dhe kuadro tjera,

shkolla e mesme bujqësore më 1973 u transformua dhe u rit në qendër shkollore për kuadro profesionale në ekonomi.

## Dashmir Izairi hap ekspozitën personale

Në Galerinë e arteve në Tetovë është hapur ekspozita me fotografi artistike të autorit Dashmir Izairi, i cili përmes artit fotografik sjell bukuritë dhe veçantitë e vet qytetve ku janë realizuar këto fotografi kryesisht qytetit të Tetovës, Shkupit, Ferizajit dhe Tiranës. Sipas autorit këto fotografi pasqyrojnë detaje urbane, esencën të bukurën e qyteteve ku janë realizuar edhe vet fotografitë. Sipas publicistit Bardhyl Zaimi fotografitë artistike të autorit Dashmir Izairi paraqesin dy tipe të fotografisë, fotografinë dokumentare dhe atë artistike. Përndryshe profesor Salajdin Salihu shkruan se artisti Dashmir Izairi është fokusuar të transformimi dhe deformimi i ambientit, tek estetika e detajeve urbane por edhe sub-urbane. Ai dialogon me këtë botë dhe më shumë se sa kaq e zbulon të bukurën, që gjendet kudo, mjafton që ta kemi sensing dhe shqisën për ta parë.

## Aleanca franceze organizoi garën e këngës frankofone

Aleanca Franceze në Tetovë në bashkëpunim me shoqatën e profesorëve të gjuhës frënge në Maqedoni, ministrinë e Kulturës, ambasadën franceze, institutin francez kanë organizuar në Tetovë garën e këngës frankofone ku marrin pjesë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga qytete të ndryshme të Maqedonisë ku ka marrë pjesë edhe ambasadori francez në Maqedoni Christian Timonier. "Sot jemi këtu për të festuar këngën frankofone, gjegjësisht garën e këngës frankofone, ku organizator kryesor është Aleanca Franceze në bashkëpunim me ambasadën franceze. Në këtë garë marrin pjesë të gjithë ata nxënës që kanë shprehur dëshirë, kemi 74 kandidatura prej qyteteve të ndryshme të Maqedonisë, ndërsa sot do të performojnë 20 nxënës nga të cilët dhjetë janë në kategorinë e shkollës fillore dhe dhjetë në kategorinë e shkollës së mesme", tha Timonier. Ambasadori francez në Maqedoni Christian Timonier

theksoi se ambasada franceze do të vazhdojë që të mbështes këto aktivitete kulturore që organizohen këtu në Tetovë, gjithashtu ne do të ndajmë bursa për ato nxënës që duan të studiojnë në Francë. "Për në qyteti i Tetovës është një qytet shumë i rëndësishëm sepse është një qytet ku jetohej në harmoni.

Ne patjetër që do të vazhdojmë që të mbështesim Tetovën në organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore si ky që organizohet sot, dhe pas këtij aktiviteti ne do të jemi këtu për të bashkëpunuar me shkollat fillore dhe të mesme të Tetovës për të ndarë bursa për nxënësit të cilët duan që studime ti vazhdojnë në Francë por për të realizuar këtë nxënësit apo ato që janë të interesuar duhet që të mësojnë gjuhën frënge", u shpreh ai. Organizatorët kishin paraparë që të gjithë pjesëmarrësit në garën e këngës frankofone t'i shpërblejnë me nga një dhuratë modeste, ndërsa dy fituesit në dy kategori do të prezantojnë Maqedoninë në garën e këngës frankofone në Serbi. Organizatorët në këtë Aleanca Franceze në Tetovë ka falenderuar të gjithë sponsorët që kanë ndihmuar organizimin e garës frankofone. (U.H)

## SERBIA PARALAJMËROI KUNDËRMASA

Në pritje të zgjidhjes së problemit me miellin e Serbisë në Maqedoni që u aktualizua periudhën e kaluar nëse deri më 14 prill nuk gjendet zgjidhje e përhershme Serbia do të vendos kundërmasa. Nga ana tjetër, autoritetet kompetente në Maqedoni theksojnë se vendi përmes Komitetit të Përzier punon në gjetjen e zgjidhjes së përhershme dhe sistematike për importimin e miellit të Serbisë. Ministri i Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikimeve, Rasim Ljajiq, duke marrë pjesë në programin e mëngjesit në TV N1, tha se Serbia do të jetë e durueshme pasi lufta tregtare dhe doganore nuk janë në interes të të dyja vendeve. "Deri më 14 prill duhet të gjejmë zgjidhje të përhershme për eksportin e miellit në Maqedoni. Vendosja e kundërmasave, për fat të keq, akoma është opsion. Ne kemi durim, nuk duam të futemi në luftë tregtare dhe doganore, të vendosim kundërmasa, pasi që kjo nuk është në interes të ekonomisë dhe marrëdhënieve të ndërsjella. Unë u thash të mos na detyrojnë ta bëjmë këtë, por këtë me të vërtetë do ta bëjmë këtë herë nëse nuk gjejmë zgjidhje të përhershme", theksoi ministri serb dhe paralajmëroi takim të ri në Shkup për dy javë.

Sipas tij, problemin me miellin e bëjnë tre mullisë nga Maqedonia të cilët, siç përmendi, kanë ndikim ekonomik dhe financiar me çka arrijnë të imponojnë barriera jashtë-

doganore. Është duke u kërkuar model, shtoi Ljajiq, për zgjidhje të përhershme që të mos përsëritet problemi çdo vit. Sipas ekzistojnë disa modele për zgjidhjen e problemit, në mesin e të cilave, pezullimi i plotë i pullave të sigurisë dhe njohja e përhershme e certifikatave.

Lidhur me deklaratën e Rasim Ljajiq sipas së cilës Serbia do të vendosë kundërmasa nëse deri më 14 prill nuk gjen zgjidhje të përhershme për miellin, ministri i bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Nikollovski për MIA-n tha se problemi është duke u tërhequr zvarrë për disa vite me radhë dhe për tejkalimin e tij është duke u biseduar për një kohë të gjatë.

"Edhe njëri prej konstatimeve



të Komitetit të Përzier është të kërkohet zgjidhje e përhershme dhe sistematike. Qëllimi është tejkalim përfundimtar i problemit, që të mos përsëritet çdo vit", deklaroi Nikollovski. Sipas tij, Komiteti i cili për herë të parë kryesoi pardje në Beograd, në afat prej 30 ditësh duhet të dalë me propozime për

zgjidhje të përhershme dhe sistematike, jo vetëm për miellin, por edhe për të gjitha barrierat e tjera jodoganore të cilat do ta zhvillojnë këmbimin tregtar. "Është e mundur seancë e re e Komitetit të Përzier deri në fund të marsit, nëse jo edhe më herët", theksoi Nikollovski.



Koha, e hënë 19 mars, 2018

## Arrestohen vjedhësit e shitoreve të armëve

Policia e Shkupit, pranë Prokurorisë Themelore Publike, ka parashtruar katër kallëzime penale për "vjedhje të renda" dhe "trafikim me armë". Në komunikatën e lëshuar për media nga Sektori për Punë të Brendshme- Shkup, kanë njoftuar se kundër personi B.Z (27), janë ngritur tre kallëzime penale, dy për "vjedhje të rëndë" dhe një për "trafikim me armë". Tutje ndaj personave A.J dhe A.B të moshës 23 dhe 25 vjeç, para Prokurorisë Themelore, janë ngritur kallëzimet e njëjta. Dhe, siç njoftojnë nga SPB-Shkup, kallëzim penale për "trafikim me armë", është ngritur edhe kundër personi B.J (57).

"Me kryerjen e këtyre veprave penale, personat në fjalë kanë përfituar të mira materiale në mënyrë jashtëligjore, në vlerë prej 4.8 milion denarë. Dokumentet dhe të dhënat e mbledhur nga hetimet, thonë se personi B.Z veprën penale e ka kryer me katër persona tjetër, mes periudhës 11.11.2017 dhe 13.11.2017, në një shitore për pajisje gjyqësive dhe piroteknike. Dyqani në fjalë gjenden në rrugën "Vasill Gjorgjo", ku vitin e kaluar u vodhën 52 revole të kalibrave të ndryshme", thonë nga policia e Shkupit.

Mes tjerash ato njoftojnë se i personi B.Z, së bashku me personat A.J dhe A.B, me datë 9 shtator të vitit të kaluar, pas mesnate, në shitoren për armë në pozicionuar në rrugën "Kej 13 Noevmri", kanë arritur të vjedhin 19 copë revole dhe nëntë pushkë.

Pas marrjes së urdhrat gjyqësor, siç theksojnë nga SPB-Shkup, është kryer bastisje në shtëpitë dhe disa hapësira tjera, me çka te personi A.J, është gjetur një sasi e madhe e armëve dhe municioni, si dhe në shtëpinë e personi B.J është gjetur një sasi e konsiderueshme e armëve.

## Dy të rinj, rrokullisen e motoçikletën katërgomëshe

Dy djelmosha të ri, nga fshati Belovishtë, rrethinë e Gostivari, gjatë vikendi të kaluar, janë përfshi në një aksident komunikacioni. Siç informojnë nga MPB-ja, të dy banorët e fshatit Belovishtë, duke drejtuar motoçikletën me katër goma, në një rrugë lokale, kanë humbur kontrollin dhe janë përplasur në një murr shtëpie. Intensiteti i lartë i goditjes, nga ndikuar që shoferi dhe bashkudhëtari i tij të rrokullisin së bashku me motoçikletën e tyre. Shoferi 17 vjeçar, si pasojë e këtij aksidenti ka marrë lëndime të rënda trupore (frakturë në dorë dhe lëndime në pjesën e kokës) i njëjtit menjëherë është transferuar në Qendrën Klinik "Nëna Terezë" në Shkup. Ndërsa, bashkudhëtari i tij, 18 vjeçari (R.M) nga fshati Çajlje, ka marrë lëndime më të lehta trupore. Ne vend ngjarje ekspertiza ka kryer përfaqësuesi i Prokurorisë Publike dhe shërbimet përkatëse të policisë.

## Nusja që vrau vjehrrën takon në burg foshnjën 6-muajshe

Marjana Cmeta, nusja që helmoi me fostoksinë vjehrrën e saj Lirije Lami 48-vjeç, gati një vit më parë është transferuar në burgun e grave "Ali Demi" në kryeqytet, aty ku dje ka pasur edhe vizitën e parë të rëndësishme. Prindërit i kanë çuar për të takuar foshnjën e saj 6-muajshe.

Burime pranë burgut konfirmojnë se nëna 21-vjeçare ndodhet në gjendje të rënduar psikologjike e ka shpërthyer në lot në momentin e takimit me të bijën.

Edhe pse me një peshë të rëndë mbi supë, Marjana ka marrë në krahët e saj foshnjën, e ka puthur përqaftuar e ushqyer me gj, por pas 1 ore ato të dyja janë ndarë. Foshnja, të cilës Olti Lami nuk i ka dhënë ende atësinë e është i pavendosur nëse do ta bëjë një ditë, është marrë nga gjyshërit, prindërit e Marjanës.

## Sherri në Itali, shqiptari merr plumb në kokë

Një shqiptar ka përfunduar në spital pasi është plagosur me plumb në kokë në Itali.

Mediat vendase raportojnë se po hetohet mbi plagosjen e shqiptarit Mustafa Hasi, i cili përfundoi dje në spital nën kujdes intensiv në Foggia për shkak se ishte qëlluar me armë zjarri në kokë nga një person i paidentifikuar.

Incidenti ndodhi dje në një shtëpi në fermë në pronësi të një sipërmarrësi bujqësor në Borgo Cervaro, disa kilometra larg Foggias.

Pronari i vilës i cili zbuloi të



plagosurin, lajmëroi menjëherë policinë.

Plagosja ndodhi me një pistoletë e kalibrit 7.65, ndoshta do t'i nënshtrohet një operacioni de-

likate për nxjerrjen e plumbit. Agjentët po marrin dëshmitë e banorëve të fshatit ndërkohë që shqiptari ndodhet në gjendje të rëndë në spital. (BalkanWeb)

## Traktori merr jetën e një të riu në fshatin Popajan

Të shtunën në mbrëmje rreth orës 19.30 minuta ishte lajmëruar se në Kërçovë në rrugën lokale drejt fshatit Padalishtë, 22 vjeçari V.Sh nga fshati Popajan duke drejtuar një traktor në të cilin ka qenë dhe 41 vjeçari N.Sh, ka humbur kontrollin dhe është rrotulluar.

"N.Sh ka kërcyer nga traktori ndërsa V.Sh ka qenë i bllokuar brenda traktorit dhe ka vdekur në vendin e ngjarjes", theksojnë nga MPB.

Në vendngjarje hetim ka bërë prokurori publik dhe policia lokale ndërkohë që trupi i pajetë i është dorëzuar familjes për varim.



## Vritet një çift nga Mali i Zi në Ekuador

Shtetasi i Malit të Zi Fadil Kaçaniq (64) dhe bashkëshortja e tij Fatima (63) janë vrarë në Ekuador, shkruan Portali RTCCG. Portali "Eltelegrafo" shkruan se Kaçaniq është vrarë me të shtëna nga arma e zjarrit, gjersa bashkëshortja e tij është vrarë me goditje të sendit të fortë në kokë. Sipas informatave jozyrtare të medieve Kaçaniq u likuidua me tre plumba nga pistoletë. Mediet thonë se Kaçaniq për shkak të trafikut të lëndëve narkotike ishte

disa vite në burg, gjersa ishte i akuzuar edhe për grabitje.

Pak kohë më parë u lirua dhe po kryente dënimin me kusht.

Në vendngjarje u gjetën gjurmët balistike dhe guri për të cilin dyshohet se është shfrytëzuar si armë, për ç'arsye dyshohet se viktimat janë vrarë te vendi ku u gjetën. Siç transmeton portali ekuadorian "Extra", vrasësit u prezantuan si policë, duke treguar urdhërin e rrejshëm për kontroll.

"Menduan se kanë kryer krim

të përsosur, por i regjistruan kamerat e vendosura në pronë", theksoi prokurori Viktor Gonzales. Gjenerali policor Marçelo Tobar theksoi se Kaçaniq kishte dosje kriminale për shkak të trafikut të lëndëve narkotike, gjersa gruaja e vrarë punonte në aeroportin Zhoze Zhakin de Olmedo. Kjo nuk është vrasje e thjeshtë, dyshojmë në lidhshmërinë me krimin e organizuar", tha ai, ndërsa transmeton portali ekuadorian "Extra".







Agjencia e Punësimit  
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2018, e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për masën aktive Trajnimi në vendin e punës për punëdhënës të njohur Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datën **19.03.2018**, boton

#### SHPALLJE PUBLIKE Për punëdhënësit

U bëhet thirrje punëdhënësve të cilët kanë nevojë të punësojnë persona adekuat pas realizimit paraprak të trajnimit në kohëzgjatje prej tremujsh, që të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimit të RM-së.

Programi nuk i përfshin punëdhënësit nga institucionet shtetërore, publike, njësitë e vetadministrimit lokal dhe Qytetin e Shkupit, organizatat joqeveritare dhe shoqatat qytetare.

Kandidatët e zgjedhur do t'i nënshtrohen një trajnimit tremujor. Trajnimi për personat e papunë do të mbahet në hapësirat e punës së punëdhënësve, në përputhje me programin e stërvitjes së propozuar nga ana e punëdhënësve dhe pjesëmarrësve të stërvitjes do t'u jepet vërtetim për realizimin e stërvitjes praktike.

Numri i kërkuar për stërvitje nuk mund ta kalojë numrin e të punësuarve brenda firmës.

Kjo masë do të përfshijë persona të papunë, kërkuar aktiv të punës të evidentuar në regjistrin e Agjencisë së Punësimit. Në këtë masë kanë të drejtë të marrin pjesë punëdhënësit të cilët:

- Numrin e përgjithshëm të të punësuarve në kohë të pacaktuar në ditën e aplikimit nuk duhet ta kenë më të vogël se numri mesatar i të punësuarve në kohë të pacaktuar në vitin e kaluar kalendarik, përveç në raste kur shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka ndodhur me fajin dhe vullnetin e punëtorit, shfrytëzimi i të drejtës për pensionim, vdekje, paafësi për punë, por jo si rezultat i shkaqeve afariste;
- Kanë të punësuar së paku një person në kontinuitet gjashtë muaj para ditës së aplikimit, me përjashtim të organizatave qytetare;
- I kanë shlyer të gjitha obligimet e pagave dhe kontributeve të sigurimit të obligueshëm social dhe
- Nuk kanë punuar me humbje në vitin e kaluar.

Me këtë masë do të përkrahen stërvitjet për profesionet (vendet e punës) për të cilat është i nevojshëm arsimim fillor ose i mesëm dhe për të cilat nuk jepet certifikatë/licencë

Personi i papunë do të marrë pagesë me të holla prej 9.000,00 denarë në muaj, duke përfshirë këtu edhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale. Punëdhënësi është i detyruar të dorëzojë në APRM listën e evidentimit të pjesëmarrjes.

Punëdhënësi është i detyruar që ta realizojë programin e stërvitjes në përputhje me planin e vërtetuar për këtë. Punëdhënësit do t'i paguhet një shumë paushale e përmjeshme për mentorim, si dhe për harxhime materiale një shumë prej 3.000,00 denarë për person të stërvitur pas mbarimit të trajnimit.

Punëdhënësi është i detyruar që t'i mbajë në punë më së paku 50 për qind të personave të stërvitur dhe të mos e zvogëlojë numrin e përgjithshëm të personave të punësuar për kohë të pacaktuar me orar të plotë pune në një periudhë prej gjashtë muajsh nga data e punësimit, përveç në raste kur shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka ndodhur me fajin dhe vullnetin e punëtorit, shfrytëzimi i të drejtës për pensionim, vdekje, paafësi për punë, por jo si rezultat i shkaqeve afariste.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes për subvencionim ndërmjet Agjencisë së Punësimit të RM-së, punëdhënësve dhe kandidatëve.

Shfrytëzuesit e ndihmës sociale do ta kenë aktive të drejtën e ndihmës së tyre gjatë kohëzgjatjes së stërvitjes, ndërsa shfrytëzuesve të ndihmës me të holla do t'u vazhdohet e drejta deri në mbarimin e stërvitjes.

Punëdhënësit e interesuar fletëparaqitje mund të dorëzojnë deri në përmbyshjen e plotë të numrit të paraparë në përputhje me këtë program.

Për informata më të hollësishme vizitoni klubet e qendrave të punësimit, si dhe ueb faqet siç vijojnë:

Agjencia e Punësimit: [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)  
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

AGJENCIA E PUNËSIMIT  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Agjencia e Punësimit  
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës për vitin 2018, e miratuar nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për masën aktive Trajnimi në vendin e punës për punëdhënës të njohur Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datën **19.03.2018**, boton

#### SHPALLJE PUBLIKE për personat e papunë

U bëhet thirrje personave të evidentuar si të papunë të cilët kërkojnë punë në mënyrë aktive dhe të cilët janë të interesuar për t'u përfshirë në masën e Trajnimit në vendin e punës për punëdhënës të njohur, që të paraqiten në klubet e qendrave të Agjencisë së Punësimit të RM-së, ku rregullisht evidentohen si të papunë.

Në këtë masë do të përkrahen stërvitjet për profesionet (vendet e punës) për të cilat është i nevojshëm arsimim fillor ose i mesëm, dhe për të cilat nuk do të jepet certifikatë/licencë.

Kandidatët e zgjedhur do të kalojnë një trajnim tremujor dhe kjo do të mbahet në hapësirat e punës së punëdhënësve në përputhje me programin e trajnimit e propozuar nga ana e punëdhënësit. Pjesëmarrësve të stërvitjes do t'u jepet vërtetim për ndjekjen e trajnimit praktik.

Personi i papunë do të marrë pagesë me të holla prej 9.000,00 denarë në muaj, duke përfshirë këtu edhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.

Punëdhënësi është i detyruar që t'i mbajë në punë më së paku 50 për qind të personave dhe të mos e zvogëlojë numrin e përgjithshëm të personave të punësuar për kohë të pacaktuar me orar të plotë pune në një periudhë prej gjashtë muajsh.

Shfrytëzuesve të kompensimit me të holla do t'u vazhdohet e drejta e pagesës deri në mbarimin e stërvitjes, ndërsa shfrytëzuesit e ndihmës sociale do të vazhdojnë të marrin ndihmë me të holla gjatë stërvitjes. Nëse shfrytëzuesi i ndihmës sociale nxirret nga puna para mbarimit të trajnimit, ka të drejtë të kthehet në regjistrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet më konkretisht do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet Agjencisë së Punësimit të RM-së, punëdhënësve dhe kandidatëve.

Personat e papunë që janë të interesuar për këtë shpallje, fletëparaqitjet mund t'i dorëzojnë deri në plotësimin e numrit të planifikuar.

Për informata më të hollësishme vizitoni klubet e qendrave të punësimit, si dhe ueb faqet siç vijojnë:

Agjencia e Punësimit: [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)  
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale: [www.mtsp.gov.mk](http://www.mtsp.gov.mk)

AGJENCIA E PUNËSIMIT  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-3145/1 dt. 15.03.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

### KOMUNIKATË

#### për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 37, komuna e Tetovës

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 37 KK Tetovë 1, komuna e Tetovës** me nr. teknik 1-3/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Dimo Gavrovski Kara", rr. "Jane Sandanski", rr. "Boris Kidriç (Metodija Antonov Çento, dhe rr. "Ilijirja (Marshall Tito)".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 3.97 ha.

Brenda përfshirjes planore të bllokut 37, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, A2 - banim në ndërtesa kolektive, B2 - njësi të mëdha tregtare, A4 - strehim të përkohshëm, D1 - Park për gjelbërim, E2 - Suprastrukturë komunale (trafostacioni), E1 - Infrastrukturë komunale.

**ANKETA PUBLIKE** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 37, komuna e Tetovës, do të zgjas 10 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 26.03.2018 - 06.04.2018 vjet.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës [www.tetovo.gov.mk](http://www.tetovo.gov.mk) dhe në sistemin e e-urbanizmit.

**PREZANTIMI PUBLIK** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 37 KK Tetovë 1, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 28.03.2018 në ora 12:00, në zyrën nr.20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 37, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës [www.tetovo.gov.mk](http://www.tetovo.gov.mk), informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,  
Teuta Arifi

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-3144/1 dt. 15.03.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

### KOMUNIKATË

#### për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 35, komuna e Tetovës

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 35 KK Tetovë 1, komuna e Tetovës** me nr. teknik 9-2/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Lubo Bozhinovski Pish", rr. "Bane Stefanovski", rr. "Boris Kidriç (Metodija Antonov Çento, dhe rr. "Bllagoja Toska".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 3.38 ha.

Brenda përfshirjes planore të bllokut 35, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, A2 - banim në ndërtesa kolektive, B1 - Destinime komerciale të vogla dhe afariste, V2 - Mbrojtje shëndetësore dhe sociale (çerdhe për fëmijë), D1 - Park për gjelbërim, E2 - Suprastrukturë komunale (trafostacioni), E1 - Infrastrukturë komunale.

**ANKETA PUBLIKE** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 35, komuna e Tetovës, do të zgjas 10 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 26.03.2018 - 06.04.2018 vjet.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës [www.tetovo.gov.mk](http://www.tetovo.gov.mk) dhe në sistemin e e-urbanizmit.

**PREZANTIMI PUBLIK** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 35 KK Tetovë 1, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 28.03.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 35, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës [www.tetovo.gov.mk](http://www.tetovo.gov.mk), informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,  
Teuta Arifi



Në kryeqendrën e Francës, në Paris, të enjten mbrëma, ka nisur panairi i librit "Livres Paris". Kjo ngjarje e rëndësishme për dashamirët e fjalës së shkruar do të mbledhë për disa ditë më radhë në Francë shkrimtarë, botues, kritikë e lexues. Në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare për librin, po merr pjesë edhe Kosova me standin e saj "1-L86", ku po prezantohen disa botues



## NË PANAIRIN E LIBRIT "LIVRE PARIS", EDHE LETËRSIA SHQIPE

Besian Zeneli, nga Shoqata e Botuesve të Kosovës, konfirmoi për gazetën "Zëri" se botuesit kosovarë po prezantohen sivjet me një numër të madh titujsh në Paris.

"Kosova prezantohet me një stand, ku po marrin pjesë shumë botues kosovarë. Në kuadër të kësaj stende po prezantohen rreth 150 tituj, mes tyre edhe disa tituj të rinj. Pritet të jetë një panair me plot aktivitete dhe mundësi të mira promovimi për librat nga Kosova", theksoi Zeneli.

Në edicionin e 38-të të Panairit Ndërkombëtar të Librit në Paris, që po mbahet nga 16-19 mars, qyteti Sharjah i Emirateve të Bashkuara Arabe është zgjedhur si qytet nderi i këtij panairi.

Kështu Emiratet e Bashkuara, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Librit Sharjah, SBA, dhe në bashkëpunim me institucionet kulturore dhe entitetet e trashëgimisë, do të organizojnë një seri sesionesh, seminaresh, shfaqjesh dhe ngjarjesh folklorike që komunikojnë në kuptim autentik dhe kuptimplotë të kulturave dhe trashëgimisë së pasur të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe rajonit arab. Delegacioni i Emirateve të Bashkuara Arabe në panair po përbëhet nga mbi 150 au-

torë, intelektualë, gazetarë dhe personel të medias arabe dhe emirate.

Subjektet kulturore në pavionin e Sharjahut përfshijnë "Shoqatën e Shkrimtarëve të Emirateve", "Shoqatën e Botuesve të Emirateve", "Këshillin Kombëtar të Medias", "Departamentin e Kulturës Sharjah", Institutin e Trashëgimisë Sharjah, "Qendrën e Sultan Al Qasimit për Studimet e Gjirit", "Sharjah Media Corporation", "Bibliotekat e të rinjve në Sharjah", "Njohuri pa kufij", iniciativa "1001 tituj", publikime "Al Qasimi", grupi "Kalimat dhe cmimi "Etisalat për letërsinë arabe të fëmijëve".

Panairi i Librit të Parisit 2018 pritet të tërheqë më shumë se 150.000 vizitorë, duke sjellë së bashku mbi 3.000 autorë, intelektualë dhe akademikë nga e gjithë bota, si dhe 30.000 profesionistë nga industria botuese.

Ahmed Al Ameri, Kryetar i SBA, tha se: "Panairi i Librit të Parisit konsiderohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme letrare që merr pjesë Sharjahu".

Al Ameri theksoi se përzgjedhja e Sharjahit si mysafir special pasqy-

ron angazhimin historik të Emirateve për të marrë pjesë në të gjitha ekspozitat dhe ngjarjet që mundësojnë që Emiratet të promovojnë kulturat dhe vlerat e rajonit arab.

"Kjo është një mundësi për ne, për të rritur bashkëpunimin me institucione të ndryshme franceze dhe për të përfutur nga lidhjet kulturore dypalëshe që ndihmojnë në nxitjen e dialogut midis Sharjahut dhe Parisit. Sharjah është një nga destinacionet kryesore të favorizuara nga autorë dhe studiues francezë që kërkojnë të marrin një shikim të shkurtër në përvojën kulturore arabe, duke kuptuar historinë e pasur të formimit, letërsisë, trashëgimisë dhe historisë", ka përfunduar ai.

Panairi i librit në Paris është një nga ngjarjet më të rëndësishme kulturore në Evropë. Në një sipërfaqe prej 55.000 metra katror, në Parkun e Ekspozitave në Porte de Versailles, çdo vit në pranverë, mirëpret rreth 1.200 botues dhe 2.000 autorë nga 37 vende dhe ofron 500 takime me shkrimtarë. Vizitorët e panairit mund të zbulojnë të gjitha shtëpitë botuese franceze dhe ndërkombëtare, me rreth 500 sten-

da dhe sportelet e përbashkëta tregtare.

Panairi i Librit në Paris gjithashtu ka disa lloje të ngjarjeve: takimet me autorë, ngjarjet kryesore dhe ngjarjet që lidhen me digjitalizim. Çdo vit, ekzistojnë pesë tema kryesore, duke përfshirë një vend dhe një qytet të përfaqësuar nga një delegacion i shkrimtarëve, duke formuar një bazë për disa cikle konferencash. Kjo ngjarje prandaj ofron një program të pasur për publikun e gjerë, por gjithashtu ofron shumë platforma për punë dhe shkëmbime me profesionistë të librave, si: shitësit, punëtorët e bibliotekave, shpërndarësit, agjentët dhe madje edhe përkthyesit dhe ilustruesit.

Shqipëria nuk është as këtë vit pjesë e "Livres Paris" Panairit të madh të Librit që mbahet çdo vit në Francë, një prej eventeve më të rëndësishme të botës së letrave. Panairi i cili vetëm një ditë më parë u vizitua e nga presidenti francez, konsiderohet si një pikë e rëndësishme takimi mes botuesish e agjentësh të librit, dhe renditet ndër panairin e mëdha si ai i Frankfurtit, apo Londrës.



## Themelohet Instituti i Teatrit Kombëtar Eksperimenta I "Kujtim Spahivogli"

Është themeluar Instituti i Teatrit Kombëtar Eksperimental Kujtim Spahivogli, iniciativë e një grupi artistësh, botuesish, studiuesish. Vepra e parë e këtij institute është "Stanislavski – SISTEMI (Puna e aktorit me veten)", përkthyer dhe përgatitur nga Mehmet Xhelili. Instituti i TKEKS është je platforme e kerkimit dhe e shprehjes krijuese në fushën e teatrit, performances artistike, te ndikimit poetik dhe e teorive mbi teatrin eksperimental. Instituti duke qenë një takim i hapur mes autorëve, përkthyesve, regjisorëve, aktorëve, skenografeve, kostumografeve, muzikantëve, koreografeve, dramaturgëve, regjisorëve të ndriçimit, fotografëve dhe analisteve të artit bashkëkohor, ka si qëllim ndërtime të gjendjeve, depozitim të kërkimeve, interpretuese dhe edukative të veprave dhe shfaqjeve, kultivimin e teorive radikale, aktit artistik me një grup të gjerë shoqëror që do të kapërcejë pengesat dhe kufizimet komerciale dhe kulturore e regjimit dominues. Në çdo projekt të institutit të TKEKS ekziston përpjekja për një eksperiment, një procedure prove, një pyetje. "Vendi i punës" ose është një feste ose nuk ekziston, asnjë nuk të detyron që të jesh aty. Akti teatral bëhet një fushë shprehje e jetës kolektive, të bashkësisë së lashte, të respektit, dashurisë, ndihmës reciproke dhe sinjeritetit të shpenguar midis të gjithë zbatuesve. Hierarkia zhduket. Marrëdhëniet behen të vërteta, nuk ekzistojnë kompromiset dhe detyrimet e përditshme të jetës tone ia lenë vendin angazhimeve

## "BOTA" E KADARESË PËRKTHEHET NË ANGLISHT

Tri esetë e Ismail Kadarese nga "Letërsia Botërore", përkthehen në anglisht nga Ani Kokobobo, botuar në Brooklin nga Restless Books. Reflektimi personal i shkrimtarit shqiptar mbi Eskilin, Danten, Shekspirin, të sjella së pari në shqip mes viteve 1985-2006, si libra më vete, përcillen nga profesori i Universitetit shtetëror të Michiganit, Sean Guynes Vishniac

Koleksioni i parë dhe i vetëm i esëve të përkthyer në anglisht nga Ismail Kadare, kësaj here direkt nga origjinalet shqiptare, shkruar nga 1985 deri në 2006, ofrojnë meditime të thella, thelbësisht personale të autorit mbi figurat kanonike të historisë së letërsisë botërore. Esetë njëherësh vlerësojnë qarkullimin e literaturës "botërore" (gjithmonë


qartësisht europiane, sipas Kadarese) në Shqipëri dhe, po ashtu, argumentojnë rëndësinë e tragjedisë për jetën, imagjinatën dhe vetidentifikimin e popujve të Ballkanit.

Kjo përfshin impulsin për të fshehur ndryshimet kulturore, gjuhësore, etnike dhe historike në shërbim të një "ballkanizmi" të dalueshëm që dëshmohet në dhimbjen unifikuese përtej konfliktit etno/gjeokulturor gjatë mijëvjeçarëve. Kadare reflekton në tri ese mbi shkrimtarët "e mëdhenj" të traditës letrare botërore: mbi Eskilin, të cilin ai e quan "humbës i madh"; mbi Danten, "e pashmangshëm"; dhe Shekspirin, "princin e vështirë".

Esetë e Kadarese japin historinë dhe vendin e këtyre shkrimtarëve

në imagjinatën intelektuale dhe mitologjike shqiptarë, si dhe ndikimin e tyre në mendimin e Kadarese mbi qëllimin e shkrimtarit letrar. Eskili ka gëzuar një prezencë pak a shumë të vazhdueshme, Dantja dhe Shekspiri nga shkaku i sundimit shtypës osman mbërrijnë të vonuar te shqiptarët me përkthime vetëm pas pavarësisë në shekullin e njëzet. Dantja lë një përshtypje të veçantë te Kadareja.

Ai thotë se mësimi më i madh i poetit fiorentin ishte se "gjendja natyrore e shkrimtarit të madh është të udhëtojë i gjallë në mesin e të vdekurve". Kështu, Dantja është interpretuar si poeti i përvojës themelore shqiptare; "danteske" nuk përshkruan asgjë më shumë, sesa spiralen shekullore të jetës shqiptarë



re nën perandori të shumta, më pas dhe nën Hoxhën. Eskili, tema e esesë së tij më të hershme dhe më të gjatë, për Kadarenë përfaqëson origjinën e humbur të letërsisë botërore dhe kështu të vetë "qytetërimin".



# Ismail Kadare dhe Ukshin Hotin, këta kolosë të intelektualizmit shqiptar



Nga  
Rexhep Torte

Ismail Kadare kolosi i letrave shqipe ndoqi në vazhdimësi vuajtjet e Ukshin Hotit kolosit të strategjisë së politikës mbarëshqiptare, i cili u burgos nga rregjimi fashisoid i Serbisë. Duke parë indiferentizmin e klasës politike të Kosovës dhe shteteve të mëdha, institucioneve ndërkombëtare të drejtave të njeriut, të cilat nuk po bënë asgjë për lirin nga burgu të Ukshin Hotit, vendosi që këtë çështje ta sensibilizojë ndërkombëtarisht.

Këta dy kolosë të intelektualizmit shqiptar edhe pse nuk ishin takuar asnjëherë e kishin njohur njëri tjetrin nëpërmjet leximit të veprave dhe bëmave të tyre për çështjen mbarëshqiptare.

Ismail Kadare në vitin 1997 për këtë qëllim zgjodhi idenë që Ukshin Hotit që ndodhej në burgun e Nishit t'ia dërgojë fshehurazi një sërë pyetjesh dhe sëbashku me përgjigjet nga Ukshin Hoti ti botojë në librin me titull "Bisedë përmes hekurash" të përkthyer edhe në gjuhën frënge për ta sensibilizuar ndërkombëtarisht burgosjen dhe mbajtjen në burg të Ukshin Hotit. Dërgimi i pyetjeve në burg dhe nxjerrja e përgjigjeve nga burgu përbënë një vështirësi dhe sfidë të vërtetë që fatmirësisht u tejkalua.

## U FLIJUA POPULLI SHQIPTAR PËR PAQEN EVROPIANE

Ja disa nga pyetjet që Ismail Kadare ia dërgoi Ukshin Hotit në burgun e Nishit.

"Emri i juaj është përmendur shpesh, por së shumti pa zjarrmi dhe ndoshta pa sinjeritet sepse s'ka sitë quhen ndryshe deklaratat e atyre politikanëve që gjer më sot nuk kanë bërë asnjë përpjekje për lirin tuaj nga burgu. Ju jeni padyshim i burgosuri politik numër 1 i Evropës. Qenkësh e thënë që populli shqiptar të japë prapë shembuj brengosës, dhe që Evropa e verbër të mos ketë sy për të shikuar. Askush s'ka të drejtë moralisht të flaes për ju, sa për të larë gojën. Do të doja të dija për këtë qëndrimin tuaj të gjatë në pranga, a mendoni se është fajtorë në rradhë të parë harresa shqiptare, madje dëshira e fshehtë e rrethëve të caktuara që jut ë mbeteni atje ku jeni, apo shurdhimi i Evropës. Se më 27 shtator 1994 para gjyqit të egër komunist serb keni theksuar Eduard Grey, kryeministrin anglez, i cili në Konferencën e Ambasadorëve në Londër ka thënë, "Ne jemi të detyruar të flijojmë popullin shqiptar për hir të paqes Evro-

piane". Jua thashë këto për të treguar se unë i njoh mirë mangësitë e Evropës, amoralitetin e saj, forcën, mençurinë dhe moralin e saj. Ju jeni shkencëtar i politikës për çka ka nevojë të madhe populli shqiptar. I vetëm në këtë hapësirë që ndihet tejet i vetmuar është populli shqiptar, sepse të tjerët kanë nga dy nëna. Janë tre mbledhje botërore ku fati i Shqipërisë dhe shqiptarëve është vënë në balancë, Kongresi i Berlinit më 1878, Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1913 dhe Dejtoni në vitin 1995. Në vitin 1995 kur Shqipëria konsiderohej mik i Evropës dhe i SHBA-së, kur çështja e Kosovës ishte bërë e njohur në botë, ku Jugosllavia ishte shpërbërë, shqiptarët e Kosovës të këshilluar nga liderët e tyre mbajtën një heshtje të plotë. Ajo heshtje ishte ogurzezë dhe përgatiste varrin të Kosovës.

Ëndërohet shumë për një strategji politike kombëtare shqiptare. Nëse nuk kemi strategji shqiptare dyshohet se ka strategji kundërshqiptare. Drama shqiptare në përgjithësi duhet të dëshmohej para botës vitet e fundit propaganda serbe ka bërë më shumë se 800 botime për tu

hedhur hi syve njerëzimit për Kosovën. Kombi shqiptar më shumë se kurrë sot ka nevojë për ringritje morale. Heshtja e gjatë për burgimin tuaj është rrjedhojë e këtij përçudnimit. Ivo Andriç shkruantari i madh Jugosllav ka propozuar zhdukjen e Shqipërisë, kjo tregon se Serbia nuk mund të demokratizohet. Dua mendimin tuaj për politikën paqësore që sot ndiqet në Kosovë. Ju jeni një i burgosur i pafajshëm sepse keni kërkuar lirinë e një populli, dhe nga egësia çnjerëzore serbe përveç prangave keni thyer jetën tuaj, keni humbur shumë edhe pse jeni njeri i shenjuar në horizontin shqiptar dhe se a mendoni se përpjekja juaj nuk ka shkuar kot". Janë disa nga pyetjet kryesore që Ismail Kadare ia dërgoi Ukshin Hotit në burgun e Nishit.

Këto pyetje të Ismail Kadaresë me vështirësi kishin arritur në dorën e Ukshin Hotit në burgun e Nishit. Ukshini këto pyetje i kishte patur në dorë vetëm dy-tre orë, sepse kodoshët kishin spiunuar dhe gardianët pas kontrollit të bërë ja kishin marrë këto pyetje. Megjithatë për aqë sa i kishte mbajtur mend Ukshin Hoti u përgjigjet pyetjeve të Ismail Kadaresë.

## ISMAIL KADARE U PËRPOQ TA LIROJË NGA BURG UKSHIN HOTIN

Ja disa nga përgjigjet që Ukshin Hoti nga burgu i Nishit ia dërgoi Ismail Kadaresë. "Para Gjykatës serbe në Prizren deklarova se më burgosi policia e Serbisë me kërkesën e një pjese të alternativës shqiptare në Kosovë. Shkaku kryesor i burgosjes time ishte frika e qarqeve politike të qendrave të vendosjes edhe në Beograd edhe në Prishtinë se vendosja ime në Prishtinë si kryetar i Unikomb-it do të mund të më vinte në pozitë pakëzë më të barabartë me të tjerët dhe në këtë mënyrë do të mund ta rrezikoja baraspeshën të vendosur të forcave politike. Unë vetëm dëshiroja ta provoja shpërthimin e bllokadës gati totale që ma kishin vënë qysh nga dalja ime nga burgu i parë në maj të vitit 1985.

"Mendova se vetëm si i vetes, kështu siç isha, do të mund të mereshim vesht, ose së paku të respektoheshim në mes nesh me Evro-Amerikën. Evropa ende nuk i ka tejkaluar botëkuptimet e veta të vjetra për interesat e saj në Ballkan. Politika serbe është duke e shfrytëzuar

**Ismail Kadare në vitin 1997 për këtë qëllim zgjodhi idenë që Ukshin Hotit që ndodhej në burgun e Nishit t'ia dërgojë fshehurazi një sërë pyetjesh dhe sëbashku me përgjigjet nga Ukshin Hoti ti botojë në librin me titull "Bisedë përmes hekurash"**



## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e diel 18 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



këtë paqartësi të Evropës që ajo ti pranojë si të vetët, si partner. Ky është një problem i vjetër i Serbisë që nga koha e përpjekjeve për tu paraqitur si fuqi e vogël koloniale. Politika shqiptare jo vetëm ajo në Kosovë ende nuk ka arritur t'ia qartësojë Evropës me argumente të qëndrueshme se ndryshimi pozitiv i pozitës së shqiptarëve i ndihmon Evropës në qartësimin e pozitave të veta, se ndryshimi pozitiv i kësaj pozite do të ishte me rëndësi në ndërtimin e rendit të ri ndërkombëtar. Për hatër të Evropës nuk do të mund ta ndërroja as pozitën gjeopolitike të hapësirave shqiptare sepse kjo kryesisht varet nga lëvizja dhe raportet e qendrave të fuqive botërore dhe jo nga ne. Shqiptarët jashtë kufijve të shtetit Shqiptar, ishin demografikisht dhe teritorialisht pothuaj më tepër se ata brënda, por pa ndonjë "kornizë" të përbashkët institucionale, (feja ishte trillojëshe), ato u copëtuan brenda njësive të ndryshme të Jugosllavisë së vjetër, të së resë, dhe mbetën të tilla edhe në më të rene. Për këtë shkak as që mund të kishite dilemë rreth pikësnyimit, çlirimit përfundimtar nga jurisdiksioni sllav dhe bashkimit në një shtet të vetëm shqiptar të cilin sllavët nga Beogradi e gjer në Moskë e përjetonin si forcim të anës së kundërt. Pa prapavinë ruse dhe të një tolerancë, ndihme apo neutraliteti mirëdashës në favor të tyre, të Evro-Amerikës, nuk do të kishte pasur as sundim mbi shqiptarët. Orientimi për çlirim përfundimtar nga jurisdiksioni sllav duket më me vend. Evropa e di se me botëkuptime të vjetra nuk mund të ndërtohen realitete të reja. Nuk besoj se në prag të mijëvjeçarit të tretë do tu shkojë mendja që të gjithëve sëbashku të na zhdukim si popull. Ajo e ka poashtu të qartë se as ne shqiptarët nuk mund dhe as që do të mundim të lozim edhe më tej rolin e kurbanit. E dimë nga historia se ekzistonin projekte dhe plane për reduktimin e shqiptarëve si komb dhe si shtet. Hartvigë, konsulli i Rusisë, Nikolla Pashiqit i thoshte se "shqiptarët janë vetëm fise të përshtatshme për asimilim". Ai nuk i raportonte Sazanovit, ministrit rus të jashtëm por drejtpërdrejt Nikolla Romanovit, carit rus. Serbët me politikën e këtyllë anti-shqiptare që e prezentojnë si legjitime bie ndesh me vetë tendencën themelore të kohës. Shqiptarët edhe si popull edhe si komb-shtet, politikisht janë shndëruar në një realitet politik të Evropës së sotme. Falë vetes por edhe Evropës edhe ne u konstituam si komb në një gjysmështeti mbi bazën e lëvizjes politike shqiptare dhe luftërave heroike të popullit shqiptar. Për krijimin e shtetit të vet etnik. Për shqiptarët e mbetur jashtë kufirit shqiptar nuk u pa kurrfarë mbrojtje as e brendshme dhe

as ndërkombëtare. Ky qe një kompromis mes fuqive të mëdha dhe Rusisë. Për mua si ish punëtor shkencor i kësaj sfere të veprimtarisë shkencore (Politika Ndërkombëtare; Marrëdhëniet Ndërkombëtare Politike), nuk mendoj për mundësinë eventuale të zhdukjes sonë as si shtet dhe as si komb. Shqiptarët mund të këmbëngulin në realizimin e të drejtave të veta dhe kjo do të ishte e arsyeshme si një e drejtë realizimi i së cilës u ndihmon proceseve integrative në Evropë, përdërisa këmbëngulja serbe në konservimin e pozitave të veta do ti rrezikonte ato procese. Bashkimi i shtetit shqiptar të përgjysmuar ndoshta do ti thyente paragjykimet e krijuara artificialisht ndër sllavët, për ne por sinqerisht nuk e shoh se do të mund ta rrezikonte ndonjë balancë të fuqive të Evropës dhe se një gjë e tillë rusët do ta përjetonin si forcim të palës së kundërt, apo serbët si ndonjë rrezik për veten. Te serbët ekziston sindromi për ta mbajtur Kosovën. Një ditë lexova një fejtun të një doktori serb të historisë i cili argumentonte se Aleksandri i Madh kishite qenë serb i kulluar. Një tjetër argumentonte se gjuha shqipe është tejet e përafërt me irlandishten dhe se ne do të duhej të kishim ardhur nga andej, por pas serbëve. Për një intelektual tjetër Bizanti kishte qenë tërësisht serb dhe se serbët kishin qenë këtu qysh para shekullit të parë të e.r., përdërisa ne, shqiptarët, nëqoftëse e mohojmë prejardhjen tonë irlandeze patjetër që vinim nga Kaukazi. Gjatë pushimeve verore me disa shokë në Greqi pata rastin të shikoj se në atë familje ku qëndronim flitej shqip dhe kuptova se asimilimi kishte qenë i dhunshëm sepse je i detyruar të harrosh se je i vetes. Sipas Glibbon 95% e udhëheqësve të kryengritjes greke që kishin ndihmuar fuqimisht në pavarsimin dhe formimin e shtetit grek kishin qenë shqiptarë orthodoxë. Unë kam patur edhe shokë shqiptarë orthodoxë por asnjëherë nuk dëgjova prej tyre se nuk janë shqiptarë. Si ishte e mundur që serbët të identifikoheshin me shqiptarët. Dëshironin të vishnin historinë shqiptare, por duke mbetur serbë me përmbajtje shqiptare. Mund të ishin shqiptarë të serbizuar por nuk mund të ishin serbë dhe shqiptarë në të njëjtën kohë. Mu duk sikur serbët kishin problem me identitetin e tyre që në sytë e mi i binte disi diabolikë. Serbët shqiptarëve përpiqen tua mohojnë historinë e tyre dhe pastaj pikërisht atë që ua mohojnë, si trashëgiminë dhe prejardhjen ilire, dëshirojnë tua përvetësojnë, ta bëjnë të vetën.

Një kohë të gjatë qëndrova edhe në SHBA dhe pata vizituar edhe shumë vende tjera. Ame-

rikanët i kishin detyruar indianët të asimiloheshin, por nuk kishin pretenduar t'ua vidhnin historinë. Këtu buronte stabiliteti i tyre edhe si individë edhe si komb ose kolektivitete.

#### SERBËT KANË PROBLEM ME INDETITETIN DHE GJUHËN E TYRE

Gjersa punoja në Prishtinë shoqërohesha shpesh me arkeologë të ndryshëm që punonin në Kosovë ose që hulumtonin aty. Ish bashkëshortja ime Edi, arkeologe, më kishte folur për veprën e një arkeologu serb, Çershkov që kishte vdekur i ri. Ai kishte bërë hulumtime për dardanët dhe kishte shkruar një libër të vlefshëm për këtë, duke argumentuar me fakte edhe mundësinë e prejardhjes shqiptare të ilirëve. Kolegët e tij serbë u bishtëronin pyetjeve të mijta. U desh të bëja përpjekje të shumta për ta gjetur librin e tij. Këtë libër e lexova me kënaqësi përshkak të saktësisë dhe asnjëanësisë së duhur si shkencëtar. Në saj të Edit kisha njohur edhe dy arkeologë të mëdhenj serbë nga Beogradi Garashanin dhe Srejoviç. Këta insistimit tim për prejardhjen ilire të shqiptarëve i përgjigjeshin qëllimisht me argumente të mjegulluara. Në publikimet serbe për arkeologji qëllimisht lihej hapësirë që lexuesi i rëndomtë të kuptonte se ishte fjala për dëshminë e lashtësisë serbe në Ballkan. Kjo më krijonte përshtypjen sikur përpiqeshin të futeshin në indetitetin ilir por duke i dëbuar shqiptarët prej andej. Për këtë shkak mendoja se kishin problem me indetitetin dhe historinë e tyre dhe me atë botërore prej të cilës kisha mësuar mbi prejardhjen e fiseve sllave. Nga kjo përfundova se serbët kishin problem edhe me gjuhën e tyre, që i takonte grupit të gjuhëve sllave. Në qoftëse se gjuha shqipe me argumente bindëse ishte dëshmuar si përsardhëse e ilirishtes së vjetër, atëherë mbetej mundësia që një pjesë e tyre të ishin qoftë ilirë të sllavizuar, qoftë shqiptarë të serbizuar. Nuk e kuptoja se si ishte e mundur se serbët të krenoheshin me përkatësinë e vet sllave dhe njëkohësisht të argumentonin se kishin prejardhje ilire. Ku mbetën atëherë sllavët e ardhur në këto treva. Të dyja bashkë më dukej se nuk shkonin. Këto probleme nuk zgjidhen me futjen në indetitetin e tjetrit dhe me as fajëzimin apo me mohimin e tij. Ato nuk zgjidhen as me përpjekjet për dobësimin ose për zhdukjen tonë si komb apo si shtet. Prej këtu buron egërsia e manifestimit dhe sindromi antishqiptar ndër serbët, por kjo nuk mund ti frikësojë ata dhe as ti zbrapsë nga kërkesa për realizimin e vetes si shqiptarë. Me argumente serioze

gjuha shqipe është argumentuar si trashëguese e drejtpërdrejtë e ilirishtes së vjetër. Nuk mund të vihet në pyetje indetiteti i shqiptarëve as si individ dhe as si kolektivitet. Në vitin 1978 kur gjende-sha në Harvard në Institutin e Teknologjisë në Masaçuset një profesor i vjetër aty, që ishte edhe këshilltar i presidentit Karter më shtroi pyetjen se a ishte Enver Hoxha nationalist. Unë i thashë se sikur Ju t'ia garantoni bashkimin e Kosovës me Shqipërinë ai do të hiqte fare dorë nga komunizmi. Detyrë e shqiptarëve është që ta luftojnë frikën e Evro-Amerikanëve, sepse me bashkimin e shqiptarëve në një shtet, shqiptarët sëbashku duke luftuar për veten do të luftojnë edhe për Evropën. Dëgjoj se UÇK rreptësisht u përmbahet normave ndërkombëtare të luftës dhe për këtë më vjen mirë. Të bashkuar në një shtet do të ishim ndihmesë me rëndësi në suksesin e proceseve të Evro-Atlantizmit. Mbi këtë mund të vihen themelet edhe të ngrihet ndërtesa e mendimit politik shqiptar. Gjatë zhvillimit të proceseve mendoja si duhet vepruar. Tashmë isha i përfshirë në një luftë të ashpër të gjithanëshme teoriko-politike ku Republika e Kosovës duhej të ishte në funksion të bashkimit me Shqipërinë duke ruajtur integritetin territorial dhe multikonfesional të saj. Kjo jo për inat të serbëve, por për hir të vetvetes si e drejtë e jona. Isha shqiptari i vetëm i burgosur që nuk hezitova ta kërkoja hapur në mbrojtjen time para Gjykatës serbe bashkimin në një shtet të trojeve dhe të popullit shqiptar. Duke e pranuar vendosjen në Prishtinë si kryetar i Unikombit në rrugë për atje më arrestuan sërish dhe më dënuan me 5 vite burg. Bllokadat lidheshin edhe me prejardhjen time fshatare, sepse nuk i takoja asnjë grupi apo tarrafi të krijuar për interesa të ngushta. Nuk dëshiroj të konsiderohem kuadër i askujt, përveç i vetes sime dhe i popullit shqiptar. Në të gjitha burgosjet që i pata nuk iu dhimba askujt, përveç të afërmeve të mij dhe popullit tim. Unioni i pavarur i studentëve të Universitetit të Prishtinës me guxim dhe hijeshinë që i takon rinisë studentore, i parapriu procesit të zhbllokimit dhe dinamizimit të jetës politike në Kosovë, vërtetë u gëzo-va. Ndonëse ende ndodhesha në vuajtjet e dënimit me burg e ndjeva veten shpirtërisht të lirë. Në ndërkohë mësova për daljen në skenë të UÇK-së që ishte si vendosmëri e popullit që të mos e lejonte më tutje nëpërkëmbjen, anashkalimin e pashembullt të dinjitetit, të unit të vet si komb. Ishite shtetësia e Kosovës ajo që më interesonte edhe kur punoja si sekretar i l i jashtëm i Kosovës. Gjatë karrierës sime të shkurtër politike

ndodhte të bia në konflikte të ashpër politike si me rrymën unitariste serbe në Beograd, ashtu edhe me inercionin burokratik në Prishtinë. Isha tejet i shkolluar gjatë rënies në burg dhe disponoja përvojë të rëndësishme të punës shtetërore. Kjo më ndihmoi ta kuptoja mirë lidhshmërinë e një fati individual me atë të një kombi. Shqiptarët etnikisht janë një komb i pastër. Serbia manipulon me numrin 10-15 milion serbë. Ata janë vetëm gjysma e këtij numri, sepse të tjerët janë vllahë, romë, dhe shqiptarë të serbizuar. Unë për vete nuk e besoj se ka qenë e nevojshme burgosja ime ndoshta kam qenë pengesë për ndonjë skenar. Raportet e mia me elitën politike të para vitit 1981 qenë ndërprerë me burgosjen time të atij viti.

Çdo fëmij evropian që moti e ka të qartë se po të donte Evro-Amerika do të ndalej tashmë valja e vdekjes, e ndoshta as që do të kishte filluar fare. Cinizmin dhe indiferencën mezi të kamufluar ndaj barbarizmit të serbëve ndaj shqiptarëve Evropa e din sikurse edhe ne. Si shqiptar dhe iliro-shqiptar, u linda këtu ndër të parët dhe nuk erdha nga askund. Askujt, madje as Evro-Amerikës nuk do të provoj ti vardisem me ndërimin e fesë dhe as të emrit. Do të duhej të ishte e bindshme sikur të këmbëngulnim në faktin se nuk jemi duke luftuar për forcimin e një shteti musliman, por për bashkimin e dy gjysmave të një populli të tillë siç është trekonfesional. Kjo do të ishte ndihmesë për zhvillimin e proceseve globale të çdo niveli. Richard Hollbrook në librin e tij ka thënë troç, "Nuk do të kishte ngjarje Srebrenica sikur të ishte fjala për një popull të krishterë". Do të vazhdoj të luftoj për respektimin e indetitetit tim kombëtar ashtu çfarë është, trekonfesional dhe jo ashtu çfarë do të dëshironin të tjerët, madje me asfarë kushti. Shqiptarët nuk i pushtuan ndonjëherë tokat serbe, por qenë vazhdimisht të detyruar të tkuren në trojet e veta.

Pavarësisht nga vrasjet shqiptarët do ta vazhdojnë marshimin e tyre drejt lirisë së vet caqeve që u takojnë edhe si popull edhe si komb. Ky është fati i tyre i determinuar historikisht dhe ato këtë doemos do ta takojnë", janë disa nga përgjigjet që Ukshin Hoti ia dërgoi Ismail Kadaresë, të cilat ai i botoi në librin Ismail Kadare-Ukshin Hoti "Bisedë përmes hekurash" që u botua në Tiranë në vitin 2000 në shtëpinë botuese "Onufri".

Përshkak të përmbajtjes së tij të rëndësishme mendojmë se do të ishte e preferueshme që këtë libër dhe librat e tjerë të publikuara të Ukshin Hotit t'i lexojnë tërë shqiptarët që me zemër e duan shqiptarizmin dhe forcimin e përparimin të kombit shqiptar.



## Hat-trik i Berishës ndaj Mariners

Besart Berisha dëshmon edhe një herë se është në formë të mirë. Ai në përballjen e fundit, ka realizuar tre gola për Melburn Viktori kundër Central Coast Mariners. Sulmuesi i kombëtare së Kosovës, shënoi golin e parë në pjesën e parë dhe pastaj shtoi edhe dy në vazhdim të takimit, të cilën Melburn Viktori e mbylli me fitore të thellë 5-2. Sulmuesi kosovar me tre golat e shënuar ngjitet në kuotën e 12 golave në 23 javë të futbollit në Australi, duke u pozicionuar në vendin e tretë të listës së golashënuesve.



## KARATE, TURNIRI "NIKON OPEN" NË BULLGARI



## Idrizi i argjendtë në Sofje

Shkup, 18 mars – Abdurahim Idrizi nga skuadra e "Makpetrol" ka fituar medaljen e argjendtë në konkurrencën e juniorëve në turnirin ndërkombëtar në karate "Nikon Open", i cili u mbajt në Sofje të Bullgarisë duke ruajtur kështu nderin e skuadrës së tij. Ndryshe, në luftën e parë Abdurahimi triumfoi ndaj karateistit Driton Halimi na radhët e KK Fati, në të dytin mposhti e 3-0 Teo Kristos nga Qipro, ndërsa në gjysmëfinale ishte më i mirë se Strfan Trpçev. Derisa, në finale Abdurahimi u mund me rezultat të ngushtë 2-1 nga Stole Smilkovski nga KK Olimpik, por nga klubi "Makpetrol" kanë vërejtje në referimin. Ndërkohë, Idrizi në garat ekipore e arriti fitoren e vetme. Ndryshe, pos KK "Makpetrol", në këtë turnir morri pjesë edhe klubi shqiptar KK "Kushtrimi". Nga gjithsejtë tre garuesve sa morrin pjesë, Emir Ramadani u shpall kampion në kategorinë U 12 (-40 kg), ndërsa te femrat kampione në kategorinë kumite (2003/2004) u shpallën Rudina Aliu dhe Xhejlani Jahii. Vlen të përmendim se në këtë event morrin pjesë rreth 800 karateist, që dëshmon fuqinë e këtij turniri.

Edhe pse para ndeshjes shihej si favorit i madh për tre pikët, futbollistët e Shkupit u mposhtën me 0-2 nga skuadra e vendit të fundit "Skopje". Një rezultat aspak i pritur, por që i real duke marr parasysh se futbollistët e "Skopjes" ishin kundërshtar më i mirë.

### REZULTATET:

AKADEMIJA P-PELISTER	1-1
VARDARI - RENOVA	1-0
SHKËNDIJA - SILEKSI	1-0
POBEDA - RABOTNIÇKI	2-0
SHKUPI - "SKOPJE"	0-2



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 18 mars – Zekirja Ramadani nuk do të mbajë mend për të mirë debutimin e tij në bankinën e FC Shkupi. Në ndeshjen e tij të parë Ramadani pësoi një nokdaun të vërtetë, duke u mundur nga skuadra e fundit në renditjen tabelore "Skopje" me rezultatin 0-2. Ramadani nuk i ndihmuan as ndryshimet në formacion, të cilët ishin të dukshme dhe në fund me plot meritë u mundën nga "Skopje, futbollistët e së cilës më shumë e dëshironte fitoren. Derisa, formën e mirë të cilën të po kalojnë futbollistët e "Skopjes" e dëshmuar edhe ndaj Shkupit, ku pas gjashtë ndeshjeve pa humbje, arritën fitore duke mbajtur shpresat për mbijetesë. Në ndeshjen e cila u zhvillua në Gostivar, ata treguan lojë më të

## LIGA E PARË, JAVA E 24

# DEBUTIM I HIDHUR PËR RAMADANIN

mirë, dhe kjo rezultoi me golin e hershëm në minutën e tetë, kur ish-futbollisti i FC Shkupi, Mario Desniq, mposhti portierin Mustafa, ndërsa fituesin e vulosi Kofi në minutën e 53. Ndërkohë, pas kësaj disfata FC Shkupi ngec edhe më tepër nga pozita e tretë, por arriti të ruan pozitën e katërt, e cila qon në Liga Evropë, në rast se KF Shkëndija fiton trofeun e Kupës së Maqedonisë, derisa "Skopje" me këtë fitore edhe më tej mbetet në pozitën e fundit, por është më afër zonës së mbijetesës.

### FAZLLAGIÇ: GOLI, REALIZIMI I ËNDRRËS

Kuqezinjët të dielën me fitoren e 20-të në këtë sezon të Ligës së Parë ndaj Sileksit me 1-0, shkuan me stil në pauzë dy javore (shkaku i ndeshjeve ndërkombëtare të eki-

peve përfaqësuese), duke ruajtur distancën prej 16-të pikëve larg vendit të dytë. Për tre pikë të reja përballë Sileksit mjaftoi super goli i 17-të vjeçarit Enis Fazllagiç, i cili realizoi për mrekulli në minutën e 16-të që në fund u tregua të jetë rezultati final i takimit. Goli debutues për ekipin e parë ka entuziazuar mesfushorin e talentuar, që nuk gjen fjalë për të përshkruar momentin kur pa se topi u ndal në rrjetën kundërshtare. "Sinqerisht është ndjenjë e mrekullueshme për të shënuar. Ëndrrat realizohen ngadalë. Nuk e kisha pritur të shënoj në këtë ndeshje. Luaj si mesfushorë i fundit dhe jam pak më shumë i orientuar në defensivë. Por gjithsesi është bukur të shënoh. Vërejtja këndin e zbrazët, mendoja ta provoj dhe falënderoj Zotin që doli mirë. Falënderoj Emi-

nin për asistimin. Shpresoj të vazhdojmë me këtë rritëm dhe fitojmë dy titujt", komenton Fazllagiç momentin e shënimit të golit i cili të shtunën Shkëndijës i solli fitore 1:0 përballë Sileksit.

### RENOVA E PAFAT

Skuadra e Renovës ka pësuar humbje minimale në Shkup nga Vardari me rezultat 1-0. Golin i vetëm është shënuar nga Blazhevski në pjesën e parë. Vlen të përmendim se skuadra tetovare nëpërmjet Gafurit, Nafiut, pati rast të shënojë, por portieri i Vardarit Gacevski nuk lejoi të mposhtet porta e tij.

Ndërkohë, në ndeshjet tjera, Pobeda ka mundur Rabotniçkin me 2-0, derisa pa fitues ka përfunduar takimi mes Akademija Pandevit dhe Pelisterit 1-1.

# SHKUPI MPOSHTË THELLË STRUMICËN

Shkup, 18 mars - Nën hijen e derbit të madh të basketbollit vendor Rabotniçki – MZT Skopje, i cili nuk e priti fundin e tij, të shtunën janë zhvilluar edhe katër ndeshje të tjera të javës së 19-të, të elitës së basketbollit vendor. Fitore të mëdha në këtë javë kanë shënuar basketbollistët e Shkupit, Kozhufit dhe Pelisterit. Këtë iu gëzuan fitoreve në përballjet

me Strumicën (109:76), FENI (97:93) gjegjësisht Kumanovës (83:82). Kjo ishte fitorja e katërt për skuadrën e Shkupit e cila ka 15 disfata. Ndërkohë, më efikas në radhët e bardhekaltërve ishte Xhordan Red me 22 pikë, ndërsa Dogbo shënoi 19, kurse Hill 14. Kur jemi te derbi i madh mes Rabotniçkit dhe MZT Skopje, ndeshja u ndërpre pas një seri prej

tw incidenteve. Për fat të mirë në incidentet që ndodhën në palestrën e sporteve "Parku i qytetit", nuk pati të lënduar. Në minutën 3:18 minuta para mbylljes së çerekut të tretë, zyrtarët e kësaj ndeshje vlerësuan e nuk ka kushte për të vazhduar ndeshja dhe morën vendimin që ajo të ndërpritet. Derisa, e njëjta u zhvillua dje.





EGJIPTIANI MË I MIRË NË 5 KAMPIONATET MADHORE

# SALAH, MBRETI I EVROPËS

Salah shënon 28. Dhe nuk po fli-  
tet për vitet, sot nuk është absoluti-  
sht jo ditëlindja e tij. Por, egjiptiani  
ka shumë për të festuar. Nën dë-  
borën e Liverpool shënon, shërben  
që të shënojë dhe vazhdon të  
mahnitë Evropën. I shkreti Watford  
rikthehet në shtëpi me pesë gola të  
pësuar, që të gjithë golat të ni-  
sur nga këmbët e ish-lojta-

rit të Romës, që të shtunën shënoi vetëm katër  
gola dhe nisi një asistim, duke marrë topin  
me vete në shtëpi, sikurse e kërkon tradita.  
Një sezon i çmendur për Momo, që fluturon i  
vetëm në krye të klasifikimit të golashënuesve  
me të mirë në pesë kampionatet më të mëdha  
evropiane, duke lënë pas krahëve Immobile,  
Kavani, Levandovski dhe Messi. Në total gjatë  
këtij sezoni janë plot 36 golat e shënuar prej

Salah. Përfshirë këtu edhe goli i re-  
lizuar për të dërguar kombëtaren e  
Egjiptit në Botërorin "Rusi 2018", ku do  
të jetë patjetër një nga yjet potencia-  
le. Ndërkohë, një video ka dalë në rrjet-  
et sociale pas përfundimit të ndeshjes  
mes Watfordit, ku Mohamed Salah shihet  
duke i kërkuar falje portierit Orestis Kar-  
nezis pasi shënoi katër gola ndaj tij.  
Egjiptiani ishte i pandalshëm teksa shë-  
noi hat-trikun e parë me Liverpoolin.  
Patjetër që blerja e sezonit tashmë  
është edhe kandidati kryesor për t'u  
shpallur Lojtari i Vitit në Premier Ligë. Bashkë  
me topin e tij të hat-trikut, 25-vjeçari shkoi te  
portieri Karnezis dhe e përqafoi duke i  
kërkuar falje pasi i bëri një mbrëmje makthi  
në "Anfield". Çfarë klasi nga Salah.



## Kalinić bëhet problem, Gattuso e përjashton

Dashuria mes Milanit dhe sul-  
muesit kroat, Nikola Kalinić, e  
cila lindi në verën e 2017-ës, ka  
filluar të venitet tashmë. Sul-  
muesi nuk po bind dhe prej  
kohësh e ka humbur vendin e ti-  
tullarit, kjo edhe për shkak të  
shpërthimit të të riut Patrik Ku-  
trone, që po shënon gola në  
vijimësi. Gjithsesi, ndaj Kievos,  
trajneri Gattuso ka vendosur të  
mos e grumbullojë fare Kali-  
nićin, duke treguar se raporti  
mes palëve është thyer tashmë.  
"Kalinić nuk ka asnjë problem fi-  
zik, por është lënë jashtë për ar-  
syje teknike", deklaroi Gattuso,  
duke mos preferuar të japë më  
shumë shpjegime mbi lënien ja-  
shtë të sulmuesit kroat. Gjithsesi,  
mediat pranë Milanit raportojnë  
se përjashtimi i Nikola Kalinićit  
ka ardhur për mungesë impenji-  
mi në stërvitje gjatë javës, gjë që  
nuk është toleruar nga Gattuso.



Një sezon i çmendur për Momo, që fluturon i vetëm në krye të klasifikimit të golashënuesve më të mirë në pesë kampionatet më të mëdha evropiane, duke lënë pas krahëve Immobile, Kavani, Levandovski dhe Messi. Në total gjatë këtij sezoni janë plot 36 golat e shënuar prej Salah

## Pogba kërkon rrogë javore sa të Sançezit




E ardhmja e Pol Pogbas është  
vënë në pikëpyetje te Mançester Ju-  
najtedi. Mesfushori francez ka luaj-  
tur këtë sezon në 18 nga 30 ndeshjet  
e Ligës Premier për "Djajtë e Kuq".  
Hoze Murinjo mendohet të jetë i  
vetëdijshëm se Mino Raiola ka fil-  
luar të kërkojë rritje të pagës për  
klientin e tij dhe ky besohet se është  
çelësi kryesor për paraqitjet e dobë-  
ta të lojtarit. Pas transferimit të Alek-  
sis Sançezit nga Arsenali në afatin  
kalimtar të janarit e bëri atë lojtarin  
më të paguar në "Old Trafford". Rai-  
ola tashmë thuhet se i ka kërkuar një  
rritje page drejtuesve të skuadrës an-  
gleze duke i barazuar me të Sançezit,  
i cili fiton rreth 170 mijë euro në javë.  
Mbetet të shihet nëse do të ketë rritje  
të pagës apo largimit të francezit për  
të dytën herë nga Junajted. Ndryshe,  
25-vjeçari deri më tani ka pasur 49  
paraqitje dhe ka shënuar tetë gola  
në të gjitha garat për Mançesterin.

## Milan – Inter do të luhet më 4 prill

Derbi i Madonninës, Milan-Inter do të  
luhet më datë 4 prill në orën 18:30. Vdekja e  
kapitenit të Fiorentinës Davide Astori, bëri që  
një pjesë e mirë e takimeve të javës së 30, të  
Serisë A të mos luheshin, mes të cilave edhe  
derbi i Milanos. Për të rikuperuar një nga  
ndeshjet më të rëndësishme të kampionatit  
italian, drejtuesve të Ligës i është dashur të  
zbatojnë një sërë rregullash, të cilat para-  
shikonin që ndeshjet të luheshin brenda 15-  
ditëshit nga data e shtyrjes dhe të caktohej  
data më e afërt.

U vendos orari 18:30 për takimin Milan-  
Inter dhe jo në mbrëmje siç luhen zakonisht  
sfidat më të rëndësishme të kampionatit ita-

lian, sepse pikërisht në atë datë luhet dhe  
ndeshjet çerekfinale të Ligës së kampionëve  
dhe UEFA nuk lejon zhvillimin e ndeshjeve të  
kampionateve të rëndësishme në oraret e  
mbrëmjes. Ndërkohë, ndryshime oraresh,  
liga e Serisë A ka marrë edhe për 3 takime të  
tjera. Kështu një tjetër takim i rëndësishëm,  
ai mes Milanit dhe Napolit do të luhet në  
orën 15:00 dhe jo në 20:45 siç ishte para-  
shikuar, ndërkohë sfida Juventus-Sampdo-  
ria nuk do të zhvillohet në orën 15:00, por në  
orën 18:00. Përsa i përket derbit të kryeqytet-  
it, Roma-Lacio do të luhet pasdite ose në  
mesditë, ndërsa orari ende nuk është për-  
caktuar.



Ka shkruar historinë e fizikës dhe ka lënë  
një boshllëk të madh. Pak kohë nga ndarja e tij  
nga jeta, Stephen Hawking, vazhdon të  
mbahet mend si një gjeni i madh dhe një tifoz  
i zjarrtë i futbollit. Përveç leksioneve të jashtë-  
zakonshme dhe zbulimeve në lidhje me Uni-  
versin, Haëking ka qenë edhe një njohës i  
madh i futbollit. I ndarë nga jeta në moshën 76

## Hauking dhe formula e penaltisë perfekte

vjeç për shkak të sklerozës laterale amiotro-  
fike, ish-astrofizikani britanik ka treguar më  
shumë se një herë magjepsjen e tij ndaj fut-  
bollit. Në një intervistë të vjetër, para një pyetje  
për kombëtaren e Anglisë, Hauking ka befa-  
suar bashkëbiseduesin e tij me një të dhënë  
interesante. "Statistikat kanë treguar se  
kombëtarja jonë fiton më shumë kur vesh  
uniformën e kuqe. Kjo ngjyrë, në fakt, i jep më  
shumë besim atij që e zgjedh, dhe kjo konfir-  
mohet nga disa studiues gjermanë që kanë  
zbuluar se kjo ngjyrë të shtyn të jesh më agre-  
siv dhe dominues", ka thënë Hauking. Pasi ka  
dhënë këshilla për mënyrën e ekzekutimit të  
penaltive (duhen bërë shumë se tre hapa para

ekzekutimit dhe duhet gjuajtur me pjesën e  
brendshme të këmbës) dhe pse paraqiten më  
mirë futbollistët pa flokë ("Ata pa flokë kanë  
më shumë mundësi për të shënuar në kraha-  
sim me kolegët"), Hauking ka dhënë këshilla  
edhe për modulën që duhet të përdorte Anglia.  
"Kam analizuar të gjithë skemat e mundshme  
të lojës dhe kam arritur në përfundimin se  
moduli 4-3-3 është më i miri, që i jep më  
shumë avantazhe ekipit në profilin taktik dhe  
atë psikologjik. Për këtë arsye këshilloj tra-  
jnerin tonë që të heqë dorë nga skema 4-4-2 sa  
më shpejt. Të dhënat, në fakt, nuk gënjejnë:  
me skemën 4-3-3 shanset për të fituar rriten  
me 10 për qind".



Koha e hënë 19 mars, 2018

ETHONË TË GJITHË

## KA SHUMË SHANSE

## QË NEJMAR TË LARGOHET NGA PSZH!

E ardhmja e Neymar vazhdon të jetë ushqim për mediat dhe të gjithë rrejetin sportiv në Francë. Jo vetëm trajneri i tij Unai Emery, apo dhe kolegët te PSZH pyeten në lidhje me të ardhmen e brazilianit. Në "hetim" janë përfshirë edhe rivalët e yllit të PSZH. Këtë të shtunë, përpara ndeshjes mes Olimpik Marsej dhe Lion, Luiz Gustavo, bashkëkombësi dhe mik i Neymar, në lidhje me lajmin që e cilëson ish-yllin e Barças larg Parisit dhe Francës deklaroi se preferon që shoku i tij të qëndrojë në Ligue 1, edhe pse pranoi se ka shumë shanse që ai të ndryshojë klub. Pavarësisht deklaratave të presidentit të PSZH, Al-Khelaifi, ku pretendon se

Neymar do të qëndrojë në Francë, te PSZH i frikësohen largimit të yllit brazilian. Në fillim ishte Markuinjos që i dha zë frikës në dhomën e zhveshjes, pas eliminimit nga "Champions League". "Unë i kërkoj Neymarit të qëndrojë. Është koha që të reflektojmë, të rritemi dhe të marrim fuqi. Neymar është një futbollist i rëndësishëm për ne dhe duhet të ketë besim te projekti ynë, në ekipin tonë dhe stafin. Ai duhet të rikupërohet", tha Markuinjos. Më pas një rrëfim nga gazeta 'Le Parisien', që publikoi një diskutim mes drejtorit sportiv të PSZH dhe një përfa-

qësuesi të lojtarit, në të cilën zyrtari tha se nuk mund të garantonte vijueshmërinë e Neymar, që është objektivi kryesor i Real Madrid për sezonin e ardhshëm. Sikurse konfirmohet nga 'AS' ka dhënë aprovimin e tij për nënshkrimin, pas një takimi mes emisarëve të

Pas trajnerit Emery, zvrave se braziliani Neymar do të largohet nga Parisi i janë bashkangjitur edhe bashkëkombësi i tij te Olimpik Marsej, Luiz Gustavo. Derisa gazetës "AS", ka dhënë aprovimin e tij për nënshkrimin, pas një takimi mes emisarëve të Los Blancos dhe babait të tij, disa javë më parë në Paris

Los Blancos dhe babait të tij, disa javë më parë në Paris. Lojtari që nënshkroi verën e kaluar për PSG për shumën e 222 milionë euro për një kontratë që skadon në 2022 është i ngopur me Ligue 1. Sipas burimeve pranë tij, Neymar ka thënë se ka kaluar 5 muaj në Paris, që i janë dukur si 5 vite.



## Refuzon Çellsin, synon vendin e Venger

Është përfolur gjatë se Luis Enrique do të jetë pasuesi i Antonio Konte te Çellsin, por marrëveshja mes palëve po vonon të viovjë, ndaj dhe trajneri spanjoll duket se ka vendosur të shohë në një drejtim tjetër. Ish-trajneri i Barcelonës i ka vënë syrin një tjetër ekipi të Premier Ligës, atij të Arsenalit, që duket se do të divorcojë pas 22 vitesh nga francezi Arsene Venger. Enrique këtë sezon ka qenë pushim pas 3 sezonesh të mbushura me trofe me skuadrën e Barcelonës, ndaj është gati të nisë një projekt të ri dhe mundësia e transferimit të "topçinjtë" e tërheq. Por duket se tërheqja është reciproke, pasi edhe skuadra e Arsenal është gati të kthejë faqen dhe të mbyllë lidhjen 22-vjeçare me Venger, për t'ia besuar skuadrën trajnerit 46-vjeçar, që ka treguar se është mjaft i aftë. Problemi i vetëm i transferimit të Enrikes te skuadra e Arsenal mund të jetë "Europa League" dhe në rast se Venger fiton këtë trofe, mund të detyrojë drejtuesit e klubit ta mbajnë sërish. Gjithsesi, trajneri spanjoll ka shumë admirues në Evropë, pasi edhe francezët e PSZH-së janë në bisedime me Enriken, për ta sjellë në Paris sezonin tjetër.

## Murinjo kërkon transferimin e Alonsos



Menaxheri i Mançester Junajtedit, Hoze Murinjo po shqyrton mundësinë e "peshkimit" të Çellsin. Portugezi transferoi Nemanja Matić nga "Stamford Bridge" verën e kaluar dhe tani është i vendosur të lëvizë sërish për një tjetër lojtar. "Don Balon" shkruan se trajneri i ka kërkuar shefave të klubit të transferojnë mbrojtësin e Çellsin, Markos Alonso. Produkti i Akademisë së Real Madridit ka krijuar një reputacion si një nga mbrojtësit më të mirë të Ligës

Premier që nga kthimi transferimi nga Fiorentina për 24 milionë funte. Dhe duket se referenca e Murinjos për mbrojtësin e krahut të majtë ka bindur Junajtedin se ai është një nga lojtarët që duhet të transferohet. Murinjo beson se zyrtarët e klubit nuk do të tërhiqen edhe nëse Çellsin kërkon 80 milionë euro për spanjollin. Ndryshe, 27-vjeçari deri më tani ka pasur 59 paraqitje dhe ka shënuar 12 gola në të gjitha garat e skuadrës angleze.

## BRAZILI DHE SPANJA ÇMENDEN PAS VINICIUS

Vinicius Junior ka magjepsur që të gjithë. Jo vetëm në Brazil, ku ata që tani e kanë etiketuar si Neymar i ri, por gjithashtu edhe në Spanjë. Real Madridi nuk humbet nga sytë për asnjë moment evolucionin e perles së vet braziliane, vetëm 17 vjeç, i blerë për shumën e 45 milionë euro, pasi ai është në planet e ekipit "Los Blancos", për t'u bashkuar me galaktikët që sezonin e ardhshëm. Futbollisti i Flamengos po dëshmon një nivel të jashtëzakonshëm dhe mediat nuk reshtin së lëvduari lojtarin. Paulo Cesar Karpegiani, trajneri i skuadrës u kritikua në ndeshjen e parë të Kupës Libertadores për mosaktivizimin e Vinicius, pasi barazuan 2-2 ndaj River Plate. Ishte pikëri-



sht i aktivizuar në minutën e 67' si zëvendësues, që ringriti skuadrën përmes dy golave të shënuar në më pak se 20 minuta. Javë më vonë ai u bë titullar. Edmundo, ish-sul-

muesi i Brazilit, tashmë në cilësinë e komentatorit për 'Fox Sports', fërkoj duart kur foli për të ardhmen e Vinicius: "Ai do të jetë Neymar i ri. Nëse do të ketë lirinë e të

shprehurit, nëse është i aftë të luajë futbollin që po bën, atëherë do të jetë Neymar i ri". Vinicius, që ka si qëllim të fitojë besimin e trajnerit Tite, për tu grumbulluar nga përfaqësuesja braziliane për Kupën e Botës, po krahasohet tashmë me yllin e PSZH, që aktualisht është edhe objektivi kryesor i skuadrës së Real Madrid për sezonin e ardhshëm. Futbollisti të Flamengos, i janë dashur 21 muaj më pak se Neymar për të shënuar golin e tij të parë në Kupa Libertadores, por ky nuk është rekordi i tij i vetëm. Klauzola e tij e parë e shitjes ishte më e madhe se ajo e Neymar, në të njëjtën moshë, njëloj si paga e parë, ose vitet me të cilat ai debutoi si futbollist pro-

fesionist. E ardhmja e tij është kryeqyteti i Spanjës.

Real Madrid zyrtarizoi nënshkrimin me lojtarin për shumën e 45 milionë euro, gati një vit më parë. Sipas gazetës braziliane 'O Globo', Flamengo dhe Real Madrid do të diskutojnë në mes të këtij viti për të vendosur mbi të ardhmen e futbollistit. Nëse klubi Los Blancos dhe ai brazilian arrijnë marrëveshjen për mbëritjen e lojtarit në Spanjë, atëherë transferimi do të ndodhë që në qershor. Por, nëse nuk arrihet marrëveshja, me Flamengon që dëshiron të mbajë lojtarin të paktën deri në dhjetor, kur përfundon kampionati, atëherë Vinicius do të marrë vendimin.



RAFAEL NADAL FLET PËR PLANET E TIJ

## NËSE NUK DËMTOHEM, SYNOJ TITULLIN NË ROLAND GARROS



“Tashmë objektivi kryesor është fitorja e grand slemmit të ‘Roland Garros’, për të 11-n herë. Por ajo që kërkoj më shumë nga vetja është që të mos kem asnjë dëmtim tjetër dhe të stërvitem pa presionin e frikën se mund të kem sërish probleme. Nëse jam në formë mund të arrij objektivin”, pohon Nadal

“Isha gati për të luajtur në Akapulko, rikthehesha pas një dëmtimi, por në momentin e fundit u detyrova të përballesha me dëmtimin tjetër dhe kjo është një goditje e rëndë psikologjike për një sportist. Problemi është se dëmtimi ndodhi në zonën që ka qenë edhe më parë e dëmtuar. Për fat të mirë gjërat po shkojnë

drejt përmirësimit, të shohim se si do të shkojnë gjërat me kalimin e ditëve”, u shpreh Rafael Nadal, aktualisht numri 2 në botë. Tenisti spanjoll nuk do të luajë as javën e ardhshme në turnirin “Masters” të Majamit, duke vijuar rehabilitimin, me shpresën që të luajë në prill në turnetë e parë që nisin në fushat me dhe. Spanjoll-

li pranon se pushimi pas dëmtimit ishte i detyruar dhe se shpreson të jetë në formë kur të nisin turnetë në fushat me dhe, që është edhe sipërfaqja e tij e preferuar. “Tashmë objektivi kryesor është fitorja e grand slemmit të ‘Roland Garros’, për të 11-n herë. Por duhet që të luaj disa ndeshje në këtë sipërfaqe fillimisht para se të

fitoj në Paris, ndaj besoj se më 15 prill do të jem në Montekarlo. Por ajo që kërkoj më shumë nga vetja është që të mos kem asnjë dëmtim tjetër dhe të stërvitem pa presionin e frikën se mund të kem sërish probleme. Nëse jam në formë mund të arrij objektivin”, deklaroi spanjollli Rafael Nadal.



## Hirsher shkruan historinë

Skiatori austriak Marcel Hirsher ka triumfuar në garën e slalomit gjigant të zhvilluar në pistën e Are, në Suedi, duke fituar si trofeun e kësaj disipline ashtu dhe atë të Kupës së Botës, për të 7-in vit me radhë, askush si ai. Austriaku bëri një paraqitje të shkëlqyer në pistë, duke qenë më i shpejti në të dyja zbritjet, ku dha kohën e përgjithshme 2'13"63. Në vendin e dytë u rendit rivali i tij kryesor për titull, norvegjezi Henrik Kristoffersen, ndërsa në të tretin francezi Viktor Muffat. Për Hirsher ky është suksesi i 58-të në garat e Kupës së Botës për meshkuj në ski, një garë ku ai thua se garoi me veten. Për sa i përket renditjes së përgjithshme të Kupës së Botës, llogaritë tashmë janë mbyllur, pas Hirsher ka siguruar matematikisht titullin me 1,620 pikë, ndërsa Kristoffresen qëndron i dyti më 1,295 pikë, ndërkohë që kanë mbetur edhe 3 gara nga fundi i sezonit 2017-2018 në ski.

## PARKER MBËRRITI NË LONDËR

### GATI PËR SFIDËN ME XHOSHUAN

Boksieri nga Zelanda e Re, Josef Parker, ka mbërritur në Londër, ku pas dy javësh do të duellojë ndaj britanikut Antony Xhoshua për unifikimin e titujve kampionë bote në peshat e rënda. Sfidat mes tyre do të zhvillohet më 31 mars në Kardif, një sfidë ku duellohet për titujt e kategorive VBO (mbahet nga Parker), VBA e IBF (mbahen nga Xhoshua). Të dy boksierët janë të pamposhtur, çka e bënë këtë sfidë mjaft intere-

sante, por Parker, pas mbërritjes në Londër, ka deklaruar se nuk ka ardhur për shëtitje, por për të marrë titujt kampionë të rivalit britanik dhe për të qëndruar i pamposhtur edhe pas këtij dueli. “Jam i lumtur që ndodhem këtu sot, mezi po e pres këtë përballje. Numërimi mbrapsht për të marrë titujt kampionë bote ka nisur. Jam në formën optimale, fizikisht dhe mendërisht dhe shoh me optimizëm



përpara. Jam i ri, i fortë, lëviz mirë në ring dhe kam një ekip fantastik që më mbështet. Nëse vjet ndaj Hughie Fury nuk dhashë më të mirën në ring, ky është shansi për ta korrigjuar këtë gabim dhe për t'i treguar Joshua

vendin që meriton”, tha 26-vjeçari Parker, që më tej shtoi se është fokusuar vetëm te sfida ndaj Joshua. “Këtu kam ardhur për të boksuar ndaj Joshua dhe nuk më interesojnë thashethemet”, deklaroi Parker.

## Mësohet arsyeja se pse MekGregor nuk i ka mbrojtur asnjëherë titujt



Edhe pse ka fituar dy tituj kampionë bote në artet marciale mikse, madje duke u bërë sportisti i parë që mban dy tituj njëherazi, kampioni irlandez i UFC-së, Konor MekGregor, sot nuk ka asnjë prej tyre. Jo vetëm kaq, por atij i janë hequr të dy këta tituj nga UFC-ja,

pasi nuk i mbrojti asnjëherë ato. Hera e fundit që MekGregor është ngjitur në kafaz daton në nëntor të vitit 2016, kur mposhti Eddie Alvarez dhe mori titullin kampion bote të peshës së lehtë, ndërkohë që mbante edhe atë të peshës pupël (featherweight). Por të dy

këta tituj iu hoqën, fillimisht ai i peshës pupël dhe një muaj më parë ai i peshës së lehtë, pasi irlandezi nuk është ngjitur në kafaz. Trajneri i tij Ouen Roddy, që mbulon sportin e karatesë, ka deklaruar sot se përse MekGregor nuk duellohet për një kohë kaq të gjatë. “Konor nuk e mbrojti titullin e peshës pupël, pasi asokohe nuk kishte asnjë rival të denjë që të duelloste me të. Ndaj ai u detyrua

të kalonte në një kategori tjetër, duke synuar dhe fituar titullin e peshës së lehtë. Në fund, Konor u bë një yll i arteve marciale mikse dhe për t'u ngjitur sërish në kafaz duhet një rival që ta motivojë, duhet edhe një pagesë e majme. Por sërish UFC-ja nuk ka një emër të madh, ndaj dhe Konor nuk po rikthehet në kafaz, duke dorëzuar edhe titullin e peshës së lehtë”, deklaroi trajneri Roddy.



## Shiffrin e pandalshme

Edhe pse e ka siguruar titullin për këtë edicion 2017-2018 të Kupës së Botës për femra në ski, Mikaela Shiffrin vazhdon të dominojë, duke korrur të shtunën një tjetër triumf. Skiatorja amerikane korri sot fitoren e 43-të në karrierë, arrihur në garën e slalomit, të zhvilluar në pistën suedeze të Are. Pas dy zbritjesh, ajo dha kohën e përgjithshme 1'46"42, duke qenë më e shpejta në pistë. Në vendin e dytë u klasifikua skiatorja zvicerane Vendy Holdener, ndërsa në të tretin u rendit ajo suedeze Frida Hansdotter. Por ajo që ra në sy është forma e shkëlqyer e skiatores amerikane, që nuk toleron në asnjë garë ku merr pjesë, pavarësisht se ka fituar titullin. Në renditjen e përgjithshme të Kupës së Botës, Shiffrin ngjitet në kuotën e 1,773 pikëve, e pakapshme nga të gjitha rivalët.



# “DER STANDARD”: MARRËVESHJA HISTORIKE KOSOVË-SERBI, NË FUND TË VITIT TË ARDHSHËM

Gazetarja dhe ekspertja austriake e Ballkanit, Adelheid Wölfl në një analizë të botuar në gazetën austriake “Der Standard” trajton gjerësisht gjendjen dhe trendet aktuale rreth zgjidhjes së problemit të Kosovës. Për fillim, ajo e bën të qartë se “ndarja e Kosovës veriore nuk merret në konsideratë dhe se SHBA dhe Rusia nuk do të përfshihen në tryezën e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë, transmeton albinfo.ch.” E këto bisedime, që pritet të jenë përmblylëse, do të kurorëzohen në fund të vitit të ardhshëm, kohë kjo që përkon me përfundimin e mandatit të Komisionit të BE-së.

Engarkuara e BE-së për këtë dialog, (Përfaqësuesja e Lartë e BE për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë) Federica Mogherini ka thënë pak kohë më parë se ajo ka parë vendosmëri si në Beograd ashtu dhe në Prishtinë, që marrëveshja të nënshkruhet vitin që vjen. Aktualisht duhet të vazhdojnë bisedimet në nivelin më të lartë, pra në mes të presidentëve Thaçi dhe Vučić. Serbia ka provuar javëve të fundit të “skenojë” se çfarë opsionesh mund të vinin në rend dite dhe në këtë kontekst u bë fjalë edhe rreth idesë për ndryshim të kufijve. Ky qëndrim është përfaqësuar në veçanti nga ministri i jashtëm prorus i Serbisë, Ivica Dacic. Ai angazhohej për një ndarje të Kosovës në një pjesë “serbe” dhe një tjetër, “shqiptare”. Këtë ndarje ai madje e quante si zgjidhje të vetme realiste dhe afatgjatë.

## NDARJA DHE SHKËMBIMI I TERRITOREVE

Edhe Vucic dukej se nuk ishte kundër kësaj ideje dhe lobonte që të mbeten të hapura të gjitha opsionet. Në fakt Vučić dhe Thaçi qëndrojnë në kontakt të ngushtë dhe telefonojnë rregullisht mes vete. Ndonëse një ndarje do të ishte kundër kushtetutës së Kosovës, shumë shqiptarëve kosovarë “po u shkon në nerva” problemi i përjetshëm i Kosovës së Veriut dhe disa prej tyre e shohin ndarjen e Kosovës veriore si një mundësi për të hequr më në fund qafe problemin, transmeton albinfo.ch. Por me këtë, sigurisht, do të shpërbëhej konstrukti i Kosovës multietnike.

Për këtë arsye së fundi në këtë temë është inkuadruar edhe Qeveria Federale e Gjermanisë. “Mbrapa



Ndarja e Kosovës veriore nuk merret në konsideratë dhe ndërsa SHBA dhe Rusia nuk do të përfshihen në tryezën e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë. E këto bisedime, që pritet të jenë përmblylëse, do të kurorëzohen në fund të vitit të ardhshëm, kohë kjo që përkon me përfundimin e mandatit të Komisionit të BE-së

kulisave është thënë në mënyrë të qartë se nuk do të negociohet përndryshim kufijsh, ka thënë një diplomat për gazetën “Standard”. Ndërkaq “ekziston rreziku që dy të `dinakët` mund të merren vesh me njëri tjetrin për ndonjë itinerar tjetër”. Me `dinakët` është menduar për Vučićin dhe Thaçin, transmeton albinfo.ch. Por Vucic me gjasë ndërkohë e ka kuptuar mesazhin nga Berlioni. Ndërsa nga ana kosovare duket se ka ende probleme për formulimin e synimeve. Kjo për faktin se ka forca që e kanë syrin te Luginë e Preshevës e cila ndodhet në Serbi, në kufirin me Kosovën dhe ku jetojnë shumë shqiptarë. Është bërë fjalë edhe për një shkëmbim territorësh. Tema është prekur në vazhdimësi, pasi që negociuesit e ekipit të Mogherinit deri tash nuk kishin tërhequr publikisht ndonjë vijë të kuqe të qartë dhe nuk kishin sqaruar se çfarë mund të vihet në tryezën e bisedimeve e çfarë jo. Duke qenë se BE-ja nuk dëshiron të importojë probleme kufijsh, Serbia duhet që me marrëveshjen e pritshme të njohë edhe kufijtë e shtetit të saj fqinj (Kosovës) dhe duhet të parandalohet që Serbia në të ardhmen të pengojë pranimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare si OKB dhe BE, thuhet më tej në artikull.

## GABRIEL DHE KEQKËPTIMI NË MES TË “AKCEPTIMIT” DHE “NJOHJES FORMALË” TË KOSOVËS NGA SERBIA

Më tutje aty bëhet fjalë për vititën e paradokshme të ish mini-

strit të jashtëm gjerman, Sigmar Gabriel në Prishtinë, ku ai ka deklaruar në mënyrë të qartë linjën. Serbia duhet ta `akceptojë` shtetin e Kosovës, ka qenë formulimi i tij, i cili sipas gazetës, është kuptuar gabimisht nga mediet, përcjell albinfo.ch. Kjo sepse me `akceptim` nuk është menduar edhe pranimi ose njohja formale e Kosovës nga Serbia. “Nëse Serbia dëshiron që të përparojë drejt Bashkimit Evropian, ngritja e shtetit juridik është kushti i parë por edhe akceptimi i pavarësisë së Kosovës”. Pra akceptimi, që nënkupton pranim indirekt të ekzistimit të shtetit të pavarur të Kosovës dhe mospengimin e pranimi të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Në këtë pikë, për kosovarët ka më shumë rëndësi pranimi në OKB, pasi që kjo është penguar deri tash nga vetoja e Rusisë dhe Kinës, si anëtare të KS të OKB-së, vëren gazeta.

Si bazë për marrëveshjen e pritshme në mes të Kosovës dhe Serbisë thuhet më tutje do të jetë marrëveshja bazë që funksiononte dikur në mes të Republikës Federale Gjermane (RFGJ) dhe Republikës Demokratike Gjermane (DDR).

Roli eventual i SHBA-së dhe Rusisë në bisedimet përfundimtare Kosovë-Serbi është po ashtu temë e kësaj analize. Ndërkohë që në Serbi ka qarqe që e preferojnë përfshirjen e Rusisë, kosovarët duan ta kenë në krah mbështetësen deri tash më të rëndësishme të tyre, SHBA-në, përcjell albinfo.ch. Por ministri i jashtëm amerikan Mike Pence, sipas një zrytari të BE-së ka

sqaruar se SHBA nuk ka interes që të luajë një rol në këtë marrëveshje.

## A PO BËHEN SPANJOLLËT “MË SERBË SE SERBËT”?

Një detaj interesant në këtë analizë është ai rreth qëndrimit të Spanjës. Ministri serb për “dialog të brendshëm” me Kosovën, Marko Gjuric thotë për gazetën se “BE nuk ka një pozicion të qartë lidhur me çështjen e pavarësisë së proklamuar njëanshëm të Kosovës, gjë që po tregohet edhe në strategjinë e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor”. Këtu ai e ka fjalën për Spanjën, e cila, e tmerruar nga separatistët katalunas, e vë gjithnjë e më shumë në lidhje çështjen e Kosovës me problemet e saj të brendshme politike, transmeton albinfo.ch. Së fundi ishte ministri i jashtëm i Spanjës ai që votoi kundër dokumentit të BE-së për Zgjerim ku përfshihej edhe Kosova krahas 5 shteteve tjera ballkanike kandidate. Edhe për takimin e planifikuar për muajin maj në Sofje, ku do të marrin pjesë veç 28 shteteve anëtare edhe gjashtë shtetet aspirante për anëtarë të BE-së, Spanja është shprehur kundër pjesëmarrjes së Kosovës. Por diplomatët e BE-së shpresojnë se megjithatë “spanjollët nuk do ta teprojnë dhe nuk do të bëhen më serbë se serbët”. Kjo për faktin se siç dihet, përfaqësuesit e Serbisë gjithnjë më shumë gjatë viteve të shkuara kanë pranuar që të paraqiten në takime ndërkombëtare krahas për krah me përfaqësuesit kosovarë.



## Meta: Kushtetuta, vija e kuqe për marrëveshjen e detit

Presidenti Ilir Meta ka rithekësuar se Kushtetuta është vija e kuqe e për marrëveshjen e kufirit detar mes Shqipërisë dhe Greqisë. Këtë deklaratë, kreu i shtetit e ka bërë gjatë një interviste për gazetën greke “To Vima”, ku ka theksuar se është me rëndësi që marrëveshja të jetë perfekte nga ana ligjore. “Së pari, në çdo rast e kam theksuar faktin se marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë janë me rëndësi të madhe dhe strategjike. Gjithmonë kam dashur të shoh një dialog të hapur bazuar në vullnetin reciprok pozitiv për të diskutuar të gjitha çështjet me interes. Kjo axhendë nuk vjen nga një planet tjetër, as nuk na imponohet, por përfshin çështje, disa të trashëguara nga e kaluara dhe të tjerët nga e tashmja, të cilat janë të një interesi të përbashkët dhe shqetësojnë popujt tanë. Unë e mirëpres faktin që ka një qëllim të mirë për t'u ulur dhe për të diskutuar të gjitha këto çështje, me shpresë se ato janë adresuar në mënyrën më efektive. Së dyti, të dyja, Shqipëria dhe Greqia janë reciprokisht të interesuara që të kenë një marrëveshje me të cilën ata mund të kufizojnë zonat e tyre detare përkatëse. Është me rëndësi vitale që të dyja palët të hyjnë në këtë proces negociatash me një mision të qartë: të arrijnë një marrëveshje që është ligjrisht e patëmetë, praktikisht e zbatueshme dhe përfundimisht e përvokueshme. Në këtë kontekst, të dy vendet janë gjithashtu të vetëdijshme se ndërsa ne jemi po aq palë në Konventën e Ligjit të Deteve, ne gjithashtu duhet t'i përmbahen dispozitave ligjore vendase që kushtëzojnë negociatat e ardhshme për një marrëveshje të re”, thotë Meta gjatë intervistës për “To Vima-n”.



## Zbulohen deputetët me “njollë” nga komunizmi

Autoriteti për hapjen e dosjeve ka konfirmuar për Shqiptarja.com se nga 795 figura të verifikuara, 13 prej tyre kanë rezultuar me materiale në emër të tyre, si informatorë të ish-Sigurimit të Shtetit apo si të spiunuar nga të tjerët. Mbi bazën e dokumentacionit të admi-

nistruar, rezultojnë pozitiv 795 figura të verifikuara (nuk ekzistojnë dokumente të ish-sigurimit të shtetit për ta) dhe negativ 13 figura të verifikuara (figurojnë të ketë materiale në emër të tyre), nga Autoriteti, sipas nenit 29, pika 2, dhe nenit 30 të ligjit 45/2015”, ka sqaruar Au-

toriteti. Në listën e zyrtarëve që janë verifikuar për pastërtinë e figurës katër janë deputetët të Kuvendit të Shqipërisë. Nga verifikimet rezultojnë se për të katër rastet nuk figurojnë të ketë materiale në ngarkim të tyre, e për rrjedhojë nuk figuron që të kenë qenë ba-

shkëpunëtorë apo i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit, sipas ligjit 45/2015. Shqiptarja.com ka mësuar se dy nga katër deputetët që janë verifikuar i përkasin Partisë Demokratike. Ata janë deputetët Myslim Murrizi dhe Romeo Gurakuqi, shkruan gazeta Monitor.



Ka një përplasje totale tashmë ndërmjet Donald Trump dhe FBI-së. Dy krerët e agjencisë më të fuqishme të SHBA-së i kanë dorëzuar Prokurorit special, Robert Mueller një dosje të plotë të takimeve të krerëve të kësaj organizate me Presidentin Donald Trump ku ky i fundit ka kërkuar mbylljen e dosjes me rusët.

Avokati i Trump, John Dowd, ka kërkuar që zv.ministri i Drejtësisë, Rod Rosenstein, të bëjë atë që shefi i tij, Jeff Sessions bëri me largimin e numrit dy të FBI-së, pra shkarkimin e prokurorit Robert Mueller, i cili është nomenklaturë e zv.ministrit të Drejtësisë. “Është momenti të mbyllet hetimi”, ka thënë avokati i Trump për mediat amerikane. Por më pas ka ardhur një reagim i Shtëpisë së Bardhë e cila e ka konsideruar “personale”, deklaraten e John Dowd. Por Administrata Trump ka qenë nën syrin e ciklonit pas një dite me një lumë twitt-esh nga Presidenti pas shkarkimit të numrit dy të FBI-së.

“Largimi i McCabe është një ditë e madhe për demokracinë. Nuk ka pasur fare çështje të lidhjes me rusët. Tjesht ka qenë një dosje e manipuluar”, shkruan Trump.

Presidenti i SHBA-së sulmon më pas krerët e Departamentit të Drejtësisë dhe të FBI-së duke i cilësuar si të korruptuar. Por Andrew

## PËRPLASJE TOTALE NDËRMJET DONALD TRUMP DHE FBI-së



McCabe nuk se po rri kot. Ai ka ruajtur shënimet e tij rreth takimit që ish shefi i FBI-së, James Comey ka kryer me Donald Trump, ku i është kërkuar mbyllja e hetimeve për “Russia Gate”.

Wall Stret Journal shkruan se këto dokumente tashmë janë në dorë të Prokurorit special, Robert Mueller. Dhe në orët e vona të mbrëmjes së djeshme vjen edhe lajmi që Mueller e ka marrë zyrtarisht dëshminë e nëndrejtorit të FBI-së dhe e ka vendosur në dosje.

Por nuk mbaron me kaq. James Comey, drejtori i FBI-së i shkarkuar me forcë nga Donald Trump bëhet i gjallë. “Zoti President, populli amerikan do të mësojë së shpejti të vërtetën. Dhe ata do ta gjykojnë vetë kush është i ndershëm dhe

kush jo”. Shkruan Comey në faqen e tij të twitter-it, ndërkohë që në cover ka kopertinën e librit të tij “Ndershmëria e Lartë: e vërteta, gënjeshtrat dhe lidhshipi”, i cili del këto ditë nga botimi. Gjithashtu, po dje ka qenë një nga “big”-ët e inteligjencës amerikane, John Brennan, i cili ka mbrojtur kolegët e tij, duke sulmuar fuqishëm presidentin Donald Trump. “Kur rryshfetet, poshtërsia morale dhe korrupsioni yt politik të bëhen gjerësisht të njohura publikisht, ti do të marrësh vendin e merituar si demagog i diskredituar në koshin e plehrave të historisë. Ti mund të bësh fajtor e dënosh Andy McCabe, por Amerikën nuk e shkatërron dot...Amerika do të triumfojë mbi ty.”, shkruan Brennan. Sërisht nuk

mbaron me kaq. Në skenë rikthehet gjenerali Michael Flynn. Ish-këshilltari për Sigurinë Kombëtare i Shtëpisë së Bardhë i shkarkuar nga Presidenti se e ka gënjyer në lidhje me rusët.

“Jam këtu për të folur për të ardhmen e popullit. Unë pagova mbështetjen që bëra për Trump. Asnjëri prej nesh nuk është prefekt dhe unë mbështeta Donald Trump-in si kandidat jo-perfekt.

Doja të thoja se ai nuk është një kandidat tradicional. Por filozofia e tij që ta bëjë Amerikën të madhe i ka kthyer energji vendit. Na pëlqen apo jo, ajo ndodhi”, tha Flynn në La Quinta të California-s, ku mbështeti kandidaturën e Omar Navarro-s për kongresmen republikan në atë zone.



### BE paralajmëron për prodhime të rrezikshme

Që prej vitit 2004 autoritetet e vendeve të ndryshme evropiane kanë vënë alarmin dhe paralajmërojnë njëra-tjetrin kur diku në BE dhe në tri vende të tjera që marrin pjesë, zbulohet një produkt i rrezikshëm. Komisioni i BE bëri të ditur se në vitin 2017 ka pasur rreth 4.000 aksione për kthim produktesh, ndalim shitjeje apo ndalim importimi. Njëllor si edhe një vit më parë. Fëmijët janë ata që rrezikohen më shumë, sepse vitin e kaluar nga BE janë nxjerrë nga qarkullimi më shumë lodra se çdo produkt tjetër. Gati një në tre njoftime për produkte të rrezikshme me gati 29 për qind ka qenë lodra për fëmijë, pasuar nga automjetet me 20 për qind dhe veshjet me 12 për qind.

Mes lodrave të njoftuara 10 për qind janë të ashtuquajturat Fidget Spinner. Ato kanë pasur kimikale të rrezikshme ose bateri, që mund të gëlltiten prej fëmijëve.

Jo gjithnjë rastet përfundojnë pa dëme. Ndër rreziqet e paralajmëruara vitin e kaluar rreziku i lëndimit ka qenë më i larti, me 28 për qind. Në vend të dytë ndodheshin rreziqet kimike me 22 për qind, ndjekur nga rreziku i mbytjes gjatë gëlltitjes.

Më shumë se gjysma e produkteve të rrezikshme kanë ardhur vitin e kaluar nga Kina. Edhe një vit më parë prodhimet ‘Made in China’ kanë qenë në krye të listës.

“Në Gjermani zbulohet dhe lajmërohet pjesa më e madhe e produkteve të rrezikshme – pikërisht rreth 350. Kjo ka të bëjë me madhësinë e tregut, volumin e importeve dhe eksperiencën e kontrollorëve”, thotë Komisioni i BE, shkruan DW.

Problemi më i madh është se konsumatorët blejnë gjithnjë e më shpesh direkt online në vendet e treta. Në rastin e blerjeve të tilla është e vështirë të sigurosh që këto produkte t’u përgjigjen standardeve të BE.

Ndërkohë BE është duke zhvilluar bisedime me tregtarët që shesin prodhime online si Amazon, Ebay, kompaninë kineze Alibaba ose atë gjermane Otto-Gruppe.

Ata duhet të japin vetë të dhëna pavarësisht nga kërkesat e ligjit. Për shembull kompanitë mund të shohin cilat produkte janë afishuar si të rrezikshme në platformën e BE dhe të hyjnë në kontakt me kompanitë që i ofrojnë ato.

## USHTRIA TURKE HYN NË AFRIN

Me të gdhirë, Presidenti Erdogan ka njoftuar marrjen e Afrinit nga trupat turke, objektivi kryesor i invazionit disajavor të pagëzuar si “Dega e Ullirit”, në veriun e Irakut, zona kurde ku veprojnë grupime që ajo Ankaraja i konsideron terroriste.

“Tashmë në qendrën e Afrinit valëvitën simbolet e qetësisë dhe sigurisë dhe jo lecat e organizatës terroriste. Aktualisht atje valëvitën flamujtë turq dhe të Ushtrisë së Lirë Siriane”, ka kumtuar Erdogan.

Erdogan tha Turqia do të ndër-marrë menjëherë hapat e nevojshme për të siguruar që banorët e qytetit të jenë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre sa më parë të jetë e mundur.

“Korridor i terrorizmit është thyer në katër fronte”, tha kreu i shtetit turk duke iu referuar përpjekjeve të YPG-së të lidhur me PKK për të krijuar një korridor përgjatë kufirit me Turqinë.



Operacioni “Dega e Ullirit” nis më 20 janar me synimin për të eliminuar grupet PKK / PYD / YPG / KCK dhe ISIS nga Afrini në Sirinë veriperëndimore.

Sipas Shtabit të Përgjithshëm Turk, operacioni synon të krijojë siguri dhe stabilitet përgjatë kufijve turq dhe në rajon, si dhe për të mbrojtur popullin sirian nga

shtypja dhe mizoria e terroristëve.

Turqia i konsideron luftëtarët YPG të milicisë kurde si zgjatim të partisë së jashtëligjshme të Punëtorëve të Kurdistanit, që lufton prej 3 dekadash për autonominë e kurdëve në juglindje të vendit.

Operacioni turk në Afrin i quajtur “Dega e ullirit” është dënuar fu-

Operacioni turk në Afrin i quajtur “Dega e ullirit” është dënuar fuqishëm nga Damasku, duke e quajtur veprimin e Ankarasë “një shkelje të sovranitetit të vendit”. Ministri i Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu është përgjigjur duke thënë se ruajtja e integritetit territorial të Sirisë është qëllimi i përbashkët i Ankarasë dhe Damaskut

qishëm nga Damasku, duke e quajtur veprimin e Ankarasë “një shkelje të sovranitetit të vendit”. Ministri i Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu është përgjigjur duke thënë se ruajtja e integritetit territorial të Sirisë është qëllimi i përbashkët i Ankarasë dhe Damaskut dhe se trupat turke nuk do të sulmojnë forcat qeveritare në Siri.



# PSE HEBRENJTË JANË KAQ INTELIGJENTË?

Studimet kanë treguar se koeficienti i tyre i inteligjencës është rreth 15 njësi mbi mesataren duke i bërë të njihen si gjeni në popullatën botërore. Kjo gjë nuk është pak

Besimtarët e krishterë e dinë se Jezu Krishti ka qenë hebre. Me siguri keni dëgjuar edhe se Ajnsh-tajni ka qenë hebre. Adhuresit e modës e dinë tashmë se Calvin Klein ka qenë gjithashtu hebre. Disa nga ata që janë lexues të rregullt të librave të ndryshëm, ndoshta kanë dëgjuar edhe për Ana Frank, vajzën me ditarin më të dhimbshëm të shkruar ndonjëherë, që po ashtu ka qenë hebre. Ajo çfarë të kalon menjëherë në mendje kur flitet për hebrejtë, është inteligjenca e tyre shumë e lartë. Studimet kanë treguar se koeficienti i tyre i inteligjencës është rreth 15 njësi mbi mesataren duke i bërë të njihen si gjeni në popullatën botërore. Kjo gjë nuk është pak. Por çfarë i bën hebrejtë kaq të zgjuar? Në fakt ka dy teori të mbështetura nga mjekë, psikologë dhe shkencëtarë në mbarë botën. Njëra ka të bëjë me aspektin gjenetik, dhe tjetra me ambientin që i rrethon.

## ASPEKTI GJENETIK

Thuhet se hebrejtë e kanë të trashëguar në gjene inteligjencën e tyre. Shumë persona mund të mendojnë se inteligjenca nëse nuk vihet në punë, është e kotë, por studimet ka treguar se fëmijët hebrej, edhe të pastimuluar nga ambienti për ta treguar inteligjencën e tyre, sërish kanë treguar intelekt më të zhvilluar se fëmijët e tjerë. Mirëpo të njëjtat studime kanë nxjerrë në pah edhe



shumë sëmundje në rrethin e hebrejve. Pothuajse çdo hebre vdes nga sëmundja e Gaucher-it, Tay-Sachs, ose nga forma të rralla të anemive. Dy sëmundjet e para kanë të bëjnë me degjenerimin dhe shkatërrimin e neuroneve, pra të qelizave bazë të trurit që janë përgjegjëse për gjithë aktivitetin mendor. Pra, vërtet hebrejtë kanë inteligjencë më të lartë, por kanë edhe më shumë rrezik për të vuajtur nga sëmundje nervore. Studimet e tyre kanë ngritur edhe shumë teori të rëndësishme, sipas të cilave, nëse vërtet gjendet një mënyrë për të përdorur një pjesë të madhe të trurit tonë (jo vetëm 10 të tij sa përdorim të gjithë ne), kjo do të shtojë rrezikun edhe për shfaqjen e sëmundjeve nervore.

## ASPEKTI AMBIENTAL

Këtu ndalen shumë studimet dhe e mbështesin fortë idenë se fëmijët hebrej rriten të zgjuar, se-

pse prindërit i kushtojnë shumë vëmendje edukimit dhe arsimimit të tyre. Është e pamundur që të gjeshe një fëmijë hebre në moshën 5 vjeçare që të mos dijë minimumi dy gjuhë të huaja dhe kjo ndodh, sepse sapo fëmijët nisin të flasin, prindërit e tyre u mësojnë fillimisht shkrimin, leximin dhe gjuhët e huaja. Kjo gjë i bën ata më të zgjuar dhe më të dalluar në aspektin verbal. Nuk ndodh shpesh të gjeshe hebrej të famshëm në fusha të artit. Shumica e tyre janë avokatë, gjuhëtarë, mjekë, sepse në vite stimulojnë dhe përforcojnë vetëm pjesën e të mësuarit verbal në tru.

E dini se si funksionon truri i njeriut? Njësoj si muskujt e një personi body-builder. Ushtrimet e shpeshta që ai bën, ia bëjnë muskujt më të mëdhenj e më të fuqishëm. Njësoj edhe truri i njeriut, nëse stërvitet, vë në punë një pjesë më të madhe të tij dhe arrin "të



Prindërit hebrej, sapo fëmija i tyre nis të flasë, fillojnë të ulen e t'i mësojnë ata. Fillimisht nisin me një orë e më pas me rritjen e tyre, e shtojnë edhe kohëzgjatjen e mësimit. Dhe nëse e mendoni, është e pamundur që një fëmijë të mos bëhet një i rritur inteligjent, nëse përditë truri i tij vihet në punë kaq shumë kohë për të mësuar

përthithë" më shumë informacione. Prindërit hebrej, sapo fëmija i tyre nis të flasë, fillojnë të ulen e t'i mësojnë ata. Fillimisht nisin me një orë e më pas me rritjen e tyre, e shtojnë edhe kohëzgjatjen e më-

simi. Dhe nëse e mendoni, është e pamundur që një fëmijë të mos bëhet një i rritur inteligjent, nëse përditë truri i tij vihet në punë kaq shumë kohë për të mësuar. Këtë shembull kanë marrë edhe familjet në Indi dhe Kinë, ku mund të shohësh fëmijë në kopsht që mbajnë në duar libra që mezi sa i ngrejne. Ata duan të mësojnë. Ata duan të bëhen inteligjentë e ta çojnë përpara botën dhe shoqërinë. Në fund të fundit, inteligjenca drejton botën. Kjo është arsyeja se pse Adolf Hitleri i trembej hebrejve. Ai nuk i trembej atyre si njerëz, sepse lehtësisht mund t'i ekzekutonte siç bëri me gjithë viktimat gjatë kohës së sundimit të tij. Ai i trembej inteligjencës së tyre dhe e dinte që, nëse do t'i jepte atyre sadopak liri, ata do ta rrëzonin nga pushteti.

Hebrejtë janë shembulli perfekt i thënies së psikologut të njohur Skinner: "Më jepni një fëmijë dhe unë do ta bëj atë si ta doni juve". Pra, nëse ne duam një shoqëri inteligjente, duhet të punojmë me fëmijët tanë. Nuk është gjë e keqe ta largojmë pak fëmijën nga lojërat reale apo elektronike dhe ta mësojmë atë nga pak që të vogël, sepse siç ka thënë edhe populli ynë "Cur gur bëhet kalaja". Dalëngadalë edhe inteligjenca e tyre do të forcohet akoma më shumë. Hebrejtë në fund të fundit janë një mit, për aq kohë sa mbështetet fortësisht se ata bëhen të zgjuar, sepse prindërit u kushtojnë orë të tëra duke i mësuar që të vegjël. Për aq kohë sa kemi të bëjmë me një mit, ne mund të bëjmë më shumë se aq, nëse i përkushtohemi fëmijëve tanë aq sa duhet, për t'i bërë ata, të rriturit që ne duam të shohim në këtë shoqëri. (bota.al)

## Si u bë Lady Diana, një ikonë e përjetshme

E bukur, bionde, princeshë dhe nënë, e pakënaqur, e trishtuar, e tmerruar dhe e vdekur: ja se si princesha britanike i hyri në zemër popullit të saj

Njëzet vjet më vonë, Diana është një mungesë që është e pranishme në dhimbjen e pandryshuar të fëmijëve të saj. Sot, mungesa e saj risjell skenarin e njëjtë si atëherë, në një version të përditësuar. Mbretëresha Elizabetë mbështillet në heshtjen e saj midis muve të kështjellës në Balmoral.

Në Londër, Uilliam dhe Herri shfaqen para publikut në Pallatin Kensington, por këtë herë brita-

nikët nuk kanë asgjë për t'u ankuar kundër sovranes, sepse në ndërkohë ka lindur një përrallë e re tek e cila të besojnë, ajo e Kate. Vdekja e ka zmadhuar mitin e Dianës, Princeshës së trishtuar, të Uellsit dhe njerëzve. Ajo që vetëm donte ta donin, u bë qendra dhe kthesa e madhe e një familje mbretërore, e ngërthyer në mesin e shekujve të traditave të saj, duke sjellë një frymë ajri të freskët fillimisht, dhe një stuhi polemikash më pas, sepse ajo ishte aq e ndryshme, sa që u shfaq, një hap larg fronit, e papajtueshme dhe kundër rrymës. Ose më thjeshtë: Kundër.

Ish i n



mediat që e transformuan në një ikonë pop, duke shfrytëzuar me të dyja duart idetë që ofronte: Diana princesha, Diana fashion, Diana rebele. Janë fytyrat me të cilat ajo zbuloi veten dhe popullin e saj e ka dashur për këtë. Ajo ndau shpirtrat, anglezët, familjen dhe komentet në pro dhe kundër saj. Ajo ishte në gjendje të përdorte shtypin, madje edhe kundër kurorës dhe burrit të saj në një martesë sa për dukje, duke dalë fituese. Ngushëlimi i saj i fundit, i hidhur, në iluzionin e një ëndrrë të humbur. Diana, në kohën e vdekjes së saj, nuk ishte në lartësinë mbretërore, madje as në zemrën e Uindsorëve, por reagimi

i njerëzve ishte i mahnitshëm, kështu që familja e saj duhej të kthehej prapa dhe ta detyronte mbretëreshën të bënte homazhet, që ajo nuk do të donte të ofronte. Nga hiri i Princeshës së Uellsit, u lind princesha e popullit, me në mes transformimin e një stili të jetesës, ndaj të cilit Diana u rebelua, duke rrëfyer në megafonët e medias, dobësitë e saj.

Ato të një gruaje të zakonshme: e tradhtuar dhe tradhtare, bulimike dhe e palumtur, por mbi të gjitha nënë, asi nën mëngën e saj, që ajo e hidhte mbi tryezë me klasin e një lojtari profesionist. E bukur, bionde, princeshë dhe nënë, e palumtur, e trishtuar, e guximshme dhe e vdekur: kështu Diana është bërë një ikonë pop, popullore dhe e popullit. Një ikonë e përjetshme. (Sette)





Agjencia e Punësimit  
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën aktive të stërvitjes për zejet e kërkua, të financuar nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datën 19.03.2018, boton

### SHPALLJE PUBLIKE për punëdhënësit zejtare të cilët janë të interesuar

U bëhet thirrje punëdhënësve të cilët janë të interesuar për realizimin e stërvitjeve për zeje, nëpërmjet marrjes së aftësive dhe shkathtësive, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit më së voni deri më 20.04.2018.

Stërvitjet kanë të bëjnë me zejet e vjetra siç vijojnë:

- farkëtar
- vozëtar
- jorganpunues
- qelqpunues
- oxhakfshirës
- pikturim me qelq
- përpunim vitrazhesh (ngjitja e qelqeve me metal)
- përpunim stolish prej monistëve (me teknikë të qostekut)
- gdhendës
- gëzoftar
- shtambar
- këpucarnues
- orëndreqës
- thurës dhe qendisë me dorë
- dhe zeje të tjera

Stërvitja (pjesa teorike dhe praktike) do të realizohet në një periudhë prej 3 deri 6 muaj në kushte reale të realizuesi i stërvitjes.

Punëdhënësit zejtare të cilët janë të interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet siç vijojnë:

- Të kenë dokument për regjistrimin e veprimtarisë zejtare adekuate si zejtare ose si ushtrues të veprimtarisë zejtare (Vendim për regjistrimin e veprimtarisë zejtare ose vërtetim për ushtrimin e veprimtarisë zejtare të lëshuar nga Dhoma e Zejtareve) dhe
- Gjendjen e tanishme jo më të vjetër se dy muaj të lëshuar nga Regjistri Qendrori RM-së

Realizuesit e stërvitjes varësisht nga zeja dhe kohëzgjatja e stërvitjes, e cila mund të jetë 3-6 muaj, do të marrin deri 30.000,00 denarë pagesë me të holla për secilin person të stërvitur.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, Dhomës së Zejtareve të Republikës së Maqedonisë dhe punëdhënësve.

Punëdhënësit e interesuar, fletëparaqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë në qendrat e punësimit prej orës 09:00 deri 14:00. Informata të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, në telefonin kontaktues 02/3111-850 dhe ueb faqet e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë ([www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ([www.mtps.gov.mk](http://www.mtps.gov.mk))

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Agjencia e Punësimit  
e Republikës së Maqedonisë

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave të punësimit dhe shërbimeve në tregun e punës gjatë vitit 2018, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë për masën aktive të stërvitjes për zejet e kërkua, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datën 19.03.2018, boton

### SHPALLJE PUBLIKE për personat e evidentuar si të papunë që janë të interesuar

U bëhet thirrje personave të evidentuar si papunë, të cilët janë të interesuar për të marrë pjesë në stërvitjen për aftësi në zeje, që të paraqiten në klubet e qendrave të punësimit ku janë të evidentuar si të papunë më së voni deri 20.04.2018.

Stërvitjet kanë të bëjnë me zejet e vjetra siç vijojnë:

- farkëtar
- vozëtar
- jorganpunues
- qelqpunues
- oxhakfshirës
- pikturim me qelq
- përpunim vitrazhesh (ngjitja e qelqeve me metal)
- përpunim stolish prej monistëve (me teknikë të qostekut)
- gdhendës
- gëzoftar
- shtambar
- këpucarnues
- orëndreqës
- thurës dhe qendisë me dorë
- dhe zeje të tjera

Stërvitja (pjesa teorike dhe praktike) do të realizohet në një periudhë prej 3 deri 6 muaj në kushte reale të realizuesi i stërvitjes.

Personat e papunë, që do të përfshihen në stërvitje, do të marrin një pagesë mujore prej 9.000,00 denarë, duke përfshirë këtu edhe tatimin personal për të ardhurat dhe sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe sëmundjes profesionale.

Personat e papunë të cilët do ta mbarojnë stërvitjen (pjesën teorike dhe praktike) dhe që do ta japin me sukses provimin përfundimtar, do të marrin certifikatë për aftësi dhe kompetenca, të lëshuar nga Dhoma e Zejtareve të Republikës së Maqedonisë.

Shfrytëzuesve të pagesës me të holla do t'u vazhdohet e drejta për këtë kompensim pas mbarimit të stërvitjes, ndërsa shfrytëzuesit e ndihmës sociale do të vazhdojnë ta marrin atë gjatë stërvitjes.

Kushtet, të drejtat dhe detyrimet do të përcaktohen me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë dhe kandidatëve.

Personat e papunë që janë të interesuar, fletëparaqitjet e tyre mund t'i dorëzojnë në qendrat e punësimit prej orës 09:00 deri 14:00. Informata të hollësishme mund të merren në klubet e qendrave të punësimit, ku janë të evidentuar si të papunë, në telefonin kontaktues 02/3111-850 dhe ueb faqet e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë ([www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale ([www.mtps.gov.mk](http://www.mtps.gov.mk))

AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16dhe163/16) dhe Vendim me nr. 10-776/2 nga 14.03.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

## KOMUNIKATË

### për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike për Dokumentacionin urbanistik planor lokal për pjesë nga P.K. nr. 7806, K.K. Tetovë jashtë r.nd. v.q. Klukovë, me destinim B1- objekte të vogla komerciale dhe aktivitete afariste, Komuna e Tetovës

Njoftohen qytetarët e komunës së Tetovës se kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për pjesë nga P.K. nr. 7806, K.K. Tetovë jashtë r.nd. v.q. Klukovë, me destinim B1 - objekte të vogla komerciale dhe aktivitete afariste, Komuna e Tetovës.

Lënda e përfshirjes planore është i locuar në territorin e komunës së Tetovës. Parcela kadastrale PK 7806 shtrihet jashtë kufirit të përfshirjes të planit planor urbanistik ekzistues të PGJU-së për qytetin e Tetovës. Parcela kadastrale PK 7806 në anën perëndimore kufizohet me rrugën ekzistuese lokale, në anën lindore me rrugë lokale dhe në anën jugore me PK 7807 dhe në veri kufizohet me PK 8149.

Përfshirja është me sipërfaqe prej **1026,77 m<sup>2</sup>**

**ANKETA PUBLIKE** sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për pjesë nga P.K. nr. 7806, K.K. Tetovë jashtë r.nd. v.q. Klukovë, me destinim B1- objekte të vogla komerciale dhe aktivitete afariste, Komuna e Tetovës do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 26.03.2018 – 30.03.2018.

**PREZANTIMI PUBLIK** sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për pjesë nga P.K. nr. 7806, K.K. Tetovë jashtë r.nd. v.q. Klukovë, me destinim B1- objekte të vogla komerciale dhe aktivitete afariste, Komuna e Tetovës, do të mbahet me dt. **27.03.2018** në ora 11:00, në zyrën nr.20 në Komunën - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Listat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 në komunën e Tetovës ose në formën elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë me planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Shtojca grafike e Dokumentacionit urbanistik planor lokal për pjesë nga P.K. nr. 7806, K.K. Tetovë jashtë r. nd. v.q. Klukovë, me destinim B1- objekte të vogla komerciale dhe aktivitete afariste, Komuna e Tetovës do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës në ueb faqen e komunës, informata më detale për Dokumentacionin urbanistik planor lokal do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,  
Teuta Arifi

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05; 106/08; 161/08; 114/09; 130/09; 149/09; 50/10; 52/10; 124/10; 47/11; 11/12; 39/12; 13/13; 25/13; 170/13; 187/13; 113/14; 20/15; 33/15; 72/15; 129/15 dhe 27/16) dhe nenit 11 të Ligjit për zjarrfikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/04, 81/07, 55/13, 158/14, 193/15 dhe 39/16), ndërsa në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Kavadarit nr. 09-2375/1 nga 05.05.2016, Rregulloren për ndryshimet dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Kavadarit nr. 04-5645/1 nga 29.11.2016, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Kavadarit nr. 09-762/1 nga 24.02.2017, Rregulloren për ndryshimet dhe plotësim të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Komunën e Kavadarit nr. 04-5259/2 nga 28.12.2017 dhe Mendimit pozitiv të Planit vjetor për punësim për vitin 2018 nr.12/6-1040/4 nga 06.03.2018, Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

#### Për punësim të punëtorëve në marrëdhënie të rregullt pune për kohë të pacaktuar të punës në Njësinë territoriale të zjarrfikësve Kavadar (13 realizues)

1. Komuna e Kavadarit ka nevojë për punësim të personave të autorizuar zyrtar, për vendin e punës – Zjarrfikës shpëtimtar me shifër POZH 02 10 V04 000 në Njësinë territoriale të zjarrfikësve Kavadar 13 realizues.

2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të shfrytëzojë gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi shëndetësore dhe psikofizike, të përcaktuara nga institucioni i autorizuar shëndetësor;
- Me vendim të plotëfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Të ketë të mbaruar arsimin e mesëm – teknik zjarrfikës ose arsim të mesëm të drejtimit tjetër dhe arsim për teknik zjarrfikës;
- Me ose pa përvojë pune në profesion të evidentuar nga Agjencia për punësim e RM si stazh të punës;
- Të ketë të dhënë lejen e vozitjes të kategorisë "C".

4. Orari i punës për vendin e theksuar të punës është organizuar me ndërrime.

Neto pagesa fillestare është 15.619,00 denarë.

5. Të bashkëngituri me Fletëparaqitjen kandidatët për zjarrfikës shpëtimtar obligohen të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- certifikatë të shtetësisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- dëshmi për arsim të mbaruar
- leje të vozitjes me provim të dhënë të kategorisë "C".

**VËREJTJE:** Punësimet e parapara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018 janë: Maqedonas (e) 13.

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 8 (tetë) ditë pune nga dita e publikimit.

7. Komuna e Kavadarit do të bëjë zgjedhjen në afatin e caktuar në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

8. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

9. Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm, të parashtrohet në arkivin e Komunës Kavadar ose përmes postës deri te Komuna e Kavadarit rr. "Marshall Tito" pn Kavadar, me shenjë "për shpallje publike për punësim".

Nr. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ 2018  
Kavadar

Kryetari i Komunës Kavadar  
M-r Mitko Jançev







Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

MKD  
СЕРТИФИКАТ  
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

**SHPALL**

**Projekt A - leje e integruar ekologjike për Shoqatën për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme Trgopromet Toni DOOEL Tullana Kumanovë rr. Josko Ilievski nr.49 1300 Kumanovë**

Instalacioni **Shoqata për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme Trgopromet Toni DOOEL Tullana Kumanovë** paraqiti kërkesë nr. 11-4002/1 nga 29.06.2007 deri te MMJPH për marrjen e A - Lejes për harmonizim me planin operativ. Pas zbatimit të procedurës ligjore, MMJPH lëshoi A - Leje për harmonizim me planin operativ nr. 11-4249/3 nga 08.05.2013 v.

Rrjedhimisht, pas dorëzimit të njoftimit nr. 11-5528/1 nga 21.12.2017, nga ana e instalacionit dhe inspektimit të kryer në prani të inspektorit shtetëror të mjedisit nga 15.12.2017. (në pajtim me nenin 138, paragrafët 6 dhe 7 të Ligjit për mjedisin jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 53/05, 81/95, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 42/14, 44/15., 129 / 15,192 / 15 dhe 39/16) me gjendjen faktike të vërtetuar (aktivitetet e realizuara të planit operativ), MMJPH e zbaton procedurën e mëtejshme për dhënien e A-Lejes së integruar ekologjike, gjegjësisht kalim nga A-Leja për harmonizim me planin operativ në A-Leje të integruar ekologjike.

Instalacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteteve të instalacioneve i takon aktivitetit nga Shtojca I, Pika: **3. Industria e mineraleve**

**3.4 Industria për prodhimin e prodhimeve të qeramikës me pjekje, para se gjithash tjegulla, tulla, tulla zjarrdruuese, pllaka, gurëz ose porcelan, me kapacitet prodhues mbi 75 t/ditë dhe /ose me kapacitet të furrës mbi 4m<sup>3</sup> dhe me dendësi hyrëse mbi 300 kg/për furrë.**

Kapaciteti i projektuar:  
200t/ditë prodhim të pjekur

**Lloji i aktivitetit:** Prodhimi i tullave, tjegullave dhe prodhime nga argjila e pjekur.  
Drejtoria mjedisit jetësor pranë MMJPH përgatiti,

**Projekt A- Leje të integruar ekologjike për Shoqatën për prodhim, tregti të brendshme dhe të jashtme Trgopromet Toni DOOEL Tullana Kumanovë**

Projekt Leja do jetë e shpallur, në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe planifikimit hapësinor [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)

Informacione në lidhje me Projekt Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në tel: 070 243 398 (e-mail: [s.gligorova@moep.gov.mk](mailto:s.gligorova@moep.gov.mk)).

Të interesuarit, në afat prej 14 ditëve nga dita e shpalljes në njetet e informimit, do të mundet të dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 (ndërtesa e MTV kati 10), 1000 Shkup.

Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

MKD  
СЕРТИФИКАТ  
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

**SHPALL**

**Projekt A - leje e integruar ekologjike për Shoqatën për prodhim dhe përpunim të mishit Agria Grupacioni Agroindustrial SHPK, Veles (Nj.P Ferma fsh. Çiçevë)**

Instalacioni **Shoqata për prodhim dhe përpunim të mishit Agria Grupacioni Agroindustrial SHPK, Veles (Nj.P Ferma fsh. Çiçevë)** paraqiti kërkesë nr.11-5039/1 nga 27.07.2008 deri te MMJPH për marrjen e A - Lejes për harmonizim me planin operativ. Pas zbatimit të procedurës ligjore, MMJPH lëshoi A - Leje për harmonizim me planin operativ nr. 11-9072 / 3 nga 03.10.2013 v.

Rrjedhimisht, pas dorëzimit të njoftimit nr. 11-5524 /1 nga 15.11.2017. nga ana e instalacionit dhe inspektimit të kryer në prani të inspektorit shtetëror të mjedisit nga 21.11.2017. (në pajtim me nenin 138, paragrafët 6 dhe 7 të Ligjit për mjedisin jetësor, Gazeta Zyrtare e RM 53/05, 81/95, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 42/14, 44/15., 129 / 15,192 / 15 dhe 39/16 ro.ц.) me gjendjen faktike të vërtetuar (aktivitetet e realizuara të planit operativ), MMJPH e zbaton procedurën e mëtejshme për dhënien e A-Lejes së integruar ekologjike.

Instalacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteteve të instalacioneve i takon aktivitetit nga Shtojca I, Pika:

**-6.6 (b) Instalacione për shpendari intensive ose derrari me më shumë se: 2000 vende për ruajtjen e derrave ( mbi 30 kg); ose**

**-6.6 (v) Instalacione për shepztari intensive ose për derrari me më tepër se: 750 vende për derra ;**

Drejtoria mjedisit jetësor pranë MMJPH përgatiti,

**Projekt A- Leje të integruar ekologjike për Shoqatën për prodhim dhe përpunim të mishit Agria Grupacioni Agroindustrial SHPK, Veles (Nj.P Ferma fsh. Çiçevë)**

Projekt Leja do jetë e shpallur, në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)

Informacione në lidhje me Projekt Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në tel: 070 243 398 (e-mail: [s.gligorova@moep.gov.mk](mailto:s.gligorova@moep.gov.mk)).

Të interesuarit, në afat prej 14 ditëve nga dita e shpalljes në njetet e informimit, do të mundet të dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 (ndërtesa e MTV kati 10), 1000 Shkup.

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 nga Rregullorja për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore dhe aktiviteteve të tjera të lira për nxënësit e shkollave filllore nr. 07-2250/1 të datës 05.06.2014 nga MASH, ShFK ,, 7 Marsi ,, Çair Shkup publikon.

**SHPALLJE PUBLIKE**  
Për grumbullimin e ofertave

ShFK ,,7 Marsi ,, Çair Shkup rr. Kosta Abrashevqi nr. 3 – Shkup , organizon ekskursione dhe aktivite tjera të lira për nxënësit për vitin shkollor 2017/2018 në pajtim me Programin për aktivitetet e theksuara:

**1. Mësim në natyrë, tre deri në pesë ditë për nxënësit e klasës së V.**

Vendi i realizimit :Shkup – Strugë – Shkup

**Kushtet minimale të cilat duhet ti plotësojë ofertuesi janë:**

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike.
- Të ketë së paku të realizuara me sukses 3 ekskursione apo aktivite tjera të lira për nxënësit në tre vitet e fundit.
- Të plotësojë kushtet për transport të grupeve për fëmijë në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.
- Oferta e ofertuesit i cili nuk i plotëson kushtet minimale do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.

**Dokumentet të cilat duhet të dorëzojë ofertuesi:**

- Dokument nga Regjistri qendror për veprimtari të regjistruar-DRD formular, licencë për kryerje të veprimtarisë turistike.
- Kopje të marrëveshjes dhe vërtetim për realizim të suksesshëm të së paku tre ekskursioneve për nxënësit dhe aktiviteve tjera të lira, në tre vitet e fundit për secilin ekskursion të realizuar veç e veç.
- Deklaratë se plotëson kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.
- Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur dorëzon garanci bankare për realizimin kualitativ të ekskursionit dhe aktiviteve tjera të lira në shumë prej 5% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.
- Ftohen ofertuesit e interesuar të dorëzojnë ofertat sipas dokumentacionit që mund të marrin në shkollë deri më 23.03.2018 çdo ditë pune prej ora 08,00 – 14,00 tek sekretari i shkollës.
- Telefoni për kontakt 32611290
- Email – shf7mars@hotmail.com

**URGJENTISHT**

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m<sup>2</sup> së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m<sup>2</sup>. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Në bazë të nenit 131 dhe 135 të Ligjit për arsim sipëror, dhe nenit 34 dhe 35 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir, Fakulteti i teknologjive informatike dhe të komunikimit – Manastir publikon:

**KONKURS**  
**Për zgjedhje**

Shpallet konkurs për zgjedhje të:

1) Një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat shkencore: 21202 - Sistemet dhe rrjetet e informacionit; 21205 – Inteligjenca artificiale dhe sistemet; 21206 – Procesimi i të dhënave;

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir.

Së bashku me fletëparaqitjen për konkurs, kandidatët, në original ose kopje të vërtetuara në noter, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim: biografi/CV, diplomë për shkallën e arritur shkencore doktor i shkencave nga sfera për të cilën zgjidhet, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje prej tyre, certifikatë të lindjes, certifikatë të shtetësisë, dhe raport për notë pozitive nga vetëvaluimi.

Fillimi, përfundimit dhe orari i punës dhe shuma në të holla e pagesës bazë për mësimdhënës janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullin në të cilin është i zgjedhur mësimdhënësi (në neto shumë: 29.241 den./ 31.481 den./ 34.677 den.).

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit, ndërsa fletëparaqitjet së bashku me dokumentet shtesë dorëzohen në Fakultetin e teknologjive informatike dhe komunikimit – Manastir personalisht, ose përmes postës në adresën: "Partizanska" pn 7000, Manastir.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

**Fakulteti i teknologjive informatike dhe komunikimit – Manastir**

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 me pëlqimin e Ministrisë së financave nr. 18-3529/2 të datës 16.03.2018, Drejtori i Shtëpisë shtetërore studentore "N. H Orde Çopella" Prilep publikon:

**SHPALLJE**

Për themelimin të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar të punës

1. Punëtor për mirëmbajtje të shtëpisë.....1 realizues

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidati duhet të përbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:  
Kandidati duhet të ketë arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar–  
Teknik elektrik – energjetik, pa përvojë pune.

Të bashkëngjitur të lutjes kandidatët duhet të parashtrojnë:

- diplomë për arsim të mbaruar
- certifikatë të shtetësisë së RM
- certifikatë të lindjes
- certifikatë të mjekut pas pranimit

Orari i punës zgjatë 8 orë në ditë edhe atë prej ora 7.00 deri në ora 15.00, gjegjësisht 40 orë në javë.  
Neto pagesa është 18.450,00 denarë.

Shpallja zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën të cilën e flasin 20% e qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri te Shtëpia studentore e shtetit "N. H Orde Çopella" Prilep rr. "Samoilova" nr. 41 tel. 048 414 523, personi për kontakt Biljana Dançevska  
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 10 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.  
Shtëpia studentore e shtetit "N. H Orde Çopella" Prilep

Në bazë të nenit 42 të Ligjit për gjykata ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 62/06, 35/08 dhe 150/10), Gjykata Themelore Shkup I Shkup publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE nr. 1/2018**

Gjykata themelore Shkup I Shkup Këshillit gjyqësor të RM do ti propozojë 40 kandidatë për zgjedhje të gjykatësve – porotë për kohë prej 4 vjet.

Kandidatët e interesuar për zgjedhje të gjykatësit – porotë duhet ti plotësojnë kushtet nga neni 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 8/06, 62/06, 35/08, 150/10) edhe atë:

- për gjykatës – porotë mund të jetë i zgjedhur shtetas i Republikës së Maqedonisë i moshës së rritur së paku me arsim sipëror të kryer, të cilët në mënyrë aktive njohin gjuhën maqedonase, gëzon respekt për kryerjen e funksionit dhe i cili nuk është më i vjetër se 64 vjet.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet ti dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- Certifikatë për arsim të mbaruar, të vërtetuar në Noter,
- Certifikatë të shtetësisë në original ose kopje të vërtetuar në Noter.
- Deklaratë se me gjykatësin ose gjykatësin porotë në këtë gjykatë madje as me anëtarë të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nuk është në farefisni në vijë të drejtë ose anësore deri në shkallë të tretë ose bashkëshort, të vërtetuar në noter.

Afati për paraqitjen e kandidatëve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes. Kandidatët e interesuar fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme dhe kontakt telefonin mund ta parashtrojnë me shkrim përmes departamentit për pranim në Gjykatën themelore Shkup I Shkup ose përmes postës në adresën Bulevardi Goce Dellçev nr. 10 Shkup, (me shenjë për Shpallje publike nr. 1/2018).

**GJYKATA THEMELORE SHKUP I SHKUP**

Në bazë të nenit 135 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), Dekani i Fakultetit juridik "Justiniani i Parë" në Shkup pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

**KONKURS**

- Për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën shkencore marrëdhënieit ndërkombëtare për kohë prej 5 /pesë/ vjet \_\_\_\_\_/1/

Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e përgjithshme të fakultetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë: dëshmi, gjegjësisht vendim dhe/ose diplomë për shkallën e arritur përkatëse të arsimit – doktor i shkencave, deklaratë për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, certifikatë të shtetësisë, biografi të shkurtë /CV/, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të punimeve.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9b – Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

Informatat plotësuese në tel: 02/3117-244

Fakulteti juridik "Justiniani i Parë" në Shkup

**Shitet lokal afarist në Q.T. Mavrovka me 326 m<sup>2</sup>.  
Çmimi sipas marrëveshjes. Kontakt telefoni 078/386 386**



Në zgjedhjet presidenciale Kremli po mbështetet gjithnjë e më shumë tek një nga grupet e zgjedhësve: tek gratë. A po ndihmojnë ruset në rritjen e pjesëmarrjes në votime për të arritur fitoren e Putinin në zgjedhje?

# RIZGJEDHJA E PUTINIT VARET NGA GRATË

Në fakt zgjedhjet presidenciale të Rusisë, që zhvillohen më 18 mars e kanë të vendosur për rezultatin prej kohësh. Mbatësi i pushtetit Vladimir Putin që kandidon për herë të katërt, është në krye të gjithë sondazheve. Por fitorja që kërkohet të arrihet nga Kremli në nivelin "70 për qind plus x", është në rrezik që të mos arrihet për shkak të pjesëmarrjes së ulët në zgjedhje. Instituti për studimin e opinionit publik Qendra -Lewada, vlerëson se votën e tyre do e japin 52 deri 54 për qind e zgjedhësve. Nivel kaq të ulët pjesëmarrjeje nuk ka pasur kurrë. Studiuesit pranë qeverisë japin prognoza me shifra më të larta.

Fakt është se pjesëmarrja në zgjedhje në Rusi ka rënë shumë. Në Moskë, qendrën me dendësi më të madhe të popullsisë, pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare të 2016 ishte rreth 35 për qind. Kësaj here udhëheqësi i opozitës Alexej Nawalny, ka bërë thirrje për bojkotim. Duke patur parasysh këto, Kremli është duke kërkuar gjithnjë e më shumë mbështetjen e grave.

## SI TËRHIQEN GRATË

Pavarësisht prezantimit të papritur të armëve të reja atomike gjatë fjalimit të tij për gjendjen e kombit në fillimi të muajit mars, shumë vëzhgues thonë se fushata zgjedhore e Putinin është e shpëlarë. Një nga iniciativat që kujtohet ende është futja e parave mujore për fëmijët. Putini e njoftoi këtë masë në muajin nëntor, pak ditë para se të bënte të ditur kandidimin e tij. Ligji i ri prej të cilit përfitojnë qindra mijëra familje, hyri në fuqi në muajin janar, pikërisht kur filloi faza më e nxehtë e fushatës zgjedhore.

Ka edhe shenja të tjera, që tregojnë për rolin e rëndësishëm të gruas në këto zgjedhje. Kështu për shembull Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka prodhuar një spot ekstra për gratë.

Në një video gjysmë minuti të gjatë, gratë tregohen si "delikate por megjithatë të forta" por edhe si të tilla që "bashkojnë dhe drejtojnë". Mesazhi kryesor vjen në fund "hajdeni në votime së bashku



familjen". Në një spot të prodhuar për burrat nuk jepet mesazh i tillë. Në një video tjetër anonime të shpërndarë në mediat sociale, dhe që i flet më shumë publikut të ri, gratë prezantohen si personalitete drejtuese të vetëdijshme për përgjegjësitë, dhe që duan medemos të shkojnë në zgjedhjet presidenciale.

Në një spot tjetër, një grua vë zilen e orës, që të mos harrojë të shkojë në votime.

## SHTRESA MË BESNIKE E VOTUESVE TË PUTINIT

Pse ndodh kjo e tregojnë statistikat. Në fillim të vitit 2017 në Rusi jetonin rreth dhjetë milionë gra më shumë se burra. Një e treta e popullsisë janë gra në moshë pensioni, dyfishi i burrave në të njëjtën moshë. Ruset e moshuara vlerësohen si shumë të disiplinuar në votime dhe ia japin votën kryesisht Putinin. Sipas sondazheve të Institutit shtetëror për studimin e opinionit WZIOM, rreth 76 për qind e grave të pyetura thanë se do të zgjedhin sërish Putinin. Tek burrat Kremli arrin gati 62 për qind.

Imazhi i Putinin si burrë sportiv, i shëndetshëm dhe i fortë kultivohet prej vitesh. Imazhe me gjysmë trupi lakuriq janë pjesë e saj. Në mes të fushatës zgjedhore 65 vjeçari u shfaq më 19 janar me gjoksin përjashta, duke u zhytur në ujin e ftohtë akull në një festë kristiano-ortodokse pagëzimi.



## GRATË JANË PAK PREZENTE NË POLITIKË

Pak para fillimit të fushatës zgjedhore Putini, bëri aludime se një grua mund të bëhej presidente e Rusisë. Prej vitesh kritikohet se grupi më i madh i popullsisë është pak prezent në politikën ruse. Në Dhomën e Ulët të parlamentit rus, Duma shtetërore, pjesa e grave është aktualisht rreth 15 për qind.

Në pranverë të 2011 në Moskë u krijua një lëvizje për të drejtat e grave "Otlitschnizy", të cilën mediat e përshkruan si të afërt me Kremlinin. Synimi ishte që më 2018 presidente e Rusisë të ishte

një grua. Nisma u përkrah ndër të tjera edhe nga Ljudmila Narusowa, një senatore në Këshillin Federativ, më Dhomën e Lartë të parlamentit. Narusowa është e veja e ish kryetarit të bashkisë Anatoli Sobtschak, zëvendës i të cilit në vitet '90 ka qenë Putini. "Otlitschnizy" u zhduk shpejt nga titujt e mediave dhe duket të jetë inaktiv. Por e bija e Narusowas, gazetarja Xenia Sobtschak, është sot e vetmja grua mes tetë kandidatëve për president. Ajo nuk ka shans të fitojë dhe roli i saj është i diskutueshëm. Disa vetë mendojnë, se një nga qëllimet e saj është të nxisë pjesëmarrjen në zgjedhje ashtu siç do Kremli. (DW)



Imazhi i Putinin si burrë sportiv, i shëndetshëm dhe i fortë kultivohet prej vitesh. Imazhe me gjysmë trupi lakuriq janë pjesë e saj. Në mes të fushatës zgjedhore 65 vjeçari u shfaq më 19 janar me gjoksin përjashta, duke u zhytur në ujin e ftohtë akull në një festë kristiano-ortodokse pagëzimi





**DASHI** 21. mars - 20. prill

eta private gjatë kësaj dite do të jetë disi e lëkundur nga disa pasiguri tuajat, ndaj të cilave nuk po arrini ende të ngrini krye. Jini të hapur për dialog dhe besojani partnerit/es tuaj, çdo dyshim. Ata që janë vetëm do të kenë dëshirë për të parë përreth, me synim gjetjen e shpirtit binjak. Sa i takon punës, do të ketë situata dhe persona prej të cilëve nuk do të dukeni ndonjë "gjeni".



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Mos u përfshini nga dembelizmi, pasi në të kundërt humorit juaj do të humbasë. Organizoni diçka, edhe të thjeshtë me personin që keni përzemër, boll që të dilni nga shtëpia. Ndërsa për ata që janë vetëm, yjet premtajn një aventurë emocionuese. Në sferën profesionale do të nisë një periudhë shumë e ngjeshur me angazhimet dhe nuk mund ti lejoni vetes gabime.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Ju pret një ditë frenetike, e cila nuk do të jetë aspak e lehtë, pasi duhet të mbani në ekuilibër edhe angazhimet profesionale edhe ndjenjat. Mundohuni të gjeni një lloj kompromisi, për të mos hedhur në erë gjithçka. Ata që janë vetëm, bëjnë mirë që të mos hedhin hapa të gabuar, pasi mund të përballen me polemika të shumta.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Gjatë kësaj dite duhet ti keni idetë më të qarta sa i takon një situatë në dashuri, ndaj duhet të tregoni durim. Lajme të mira dhe për ata që janë vetëm. Një dëshirë e tyre do të realizohet. Mundohuni të mos dramatizoheni përballë ndonjë vësh-tirësi në punë. Humbja e kthjelltësisë, nuk ju ndihmon aspak.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Lrohuni nga ai ngërc i cili rrezikon që të ngadalësojë mendimet dhe veprimet tuaja. Vini në zbatim propozimet tuaja dhe flisni hapur me partnerin/en. Ata që janë vetëm, do të kenë mundësi që të flasin ballë përballë me një person që i ka mërzhitur. Gjatë këtyre ditëve nuk po jepni maksimumin në punë, ndaj duhet të merrni masa sa më parë.



**VIRJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Jeni të lodhur nga rutina, por as aventurat nuk është se ju pëlqejnë shumë. Nëse nuk keni kaluar ende në veprim, ka ardhur është momenti që ta bëni. Ata që janë vetëm, nëse nuk janë të kënaqur për mënyrën se si shkojnë gjërat, duhet të mbajnë parasysh se çdo gjë mund të përmirësohet. Në punë, do të jeni të vendosur që të çoni përpara projektet tuaja dhe askush nuk do ju ndalojë.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Prania e Hënës në shenjën tuaj, favorizon intensitetin në çift. Ekuilibri i rifituar ndikon pozitivisht në harmoninë e brendshme. Nëse jeni vetëm dhe jeni fiksuar pas dikujt që e cilësoni si të paarritshëm, dijeni se nuk është i tillë. Gjatë kësaj dite puna do të jetë në plan të parë dhe kjo do të jetë dita e duhur për të konsoliduar nismat tuaja.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Do të jetë një ditë vërtetë e çuditshme, ku do e gjeni veten të përfshirë në ndonjë debat, edhe pse pa dashur. Fatmirësisht në mbrëmje, një ndryshim programi me partnerin, do të ndryshojë gjithçka. Për ata që janë vetëm, kjo do të jetë një e diel e veçantë, ku do të triumfojë dashuria. Një projekt të cilin e keni shumë përzemër do të rezultojë shumë i suksesshëm në sferën profesionale.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Prania e Hënës në shenjën tuaj, mund të ndikojë për të përhapur nervozizëm. Ruani qetësinë, pasi në fund të fundit, nuk ka asgjë themelore për t'u ankuar. Ata që janë vetëm, duhet të analizojnë mirë ndjenjat e tyre, para se ti ekspozojnë të një person që duan. Do të keni energji të pamjaftueshme për të përballuar angazhimet e shumta që rezervon dita, por pavarësisht të gjithave, do ia dilni.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Do të lëkundeni nga një siklet në dashuri, i cili në fund të fundit nuk do të rezultojë i bazuar. Ata që janë vetëm kanë në dispozicion një ditë të shkëlqyer, për të ndryshuar pozitën e tyre. Disa çështje të punës, që ju prekin shumë afër, do të kenë nevojë për zgjidhje.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Gjatë kësaj dite duhet të merrni një pozicion të qartë, pasi do të jetë e vetmja mënyrë për të sheshuar debate të kota. Ata që janë vetëm, do të tërhiqen nga një person, i cili nuk ju përgjigjet ndjenjave të tyre. Mundohuni të organizoni sa më mirë sferën profesionale, në mënyrë që të jeni të relaksuar. Gjatë kësaj periudhe do të jeni shumë të angazhuar.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Dashuria dhe sfera profesionale ecin me hapa paralele. Megjithatë mentalisht një lajm i papritur, mund t'i turbullojë të dyja fushat. Ata që janë vetëm, do të ndihen të zhgënjyer nga sjellja e një personi dhe do të kenë dëshirë vetëm për të qëndruar vetëm. Sa i takon sferës profesionale, do të vijnë mundësi shumë të mira, të cilat duhet ti kapni pa u menduar gjatë.



KOHA	EKSPERIMENTIM	BANOR I ARMENISË	GUR I ÇMUAR ME NGËJYRË TË GJELBËR	TANTALI	PJESËTARET E FISIT AUTOKTON TË AMERIKËS	BOTA, NJERËZI E MERR ETJA	AMERIKA JUGORE	PARADË USHTARAKE ATDHEU	P
PJ. E KOMPJUT.(SH.) KOZM. RUS (DIAHTAS) NJË NGA FLUTURUESIT E PARË NË HAPËSIRË									ANJA KOZMIKE, MË TË CILËN FLUTUROI KOZMONAUTI NË FOTO
G									
SMALL AND MEDIUM-SIZED ENTERPRISES					AKTORI AMERIKAN, ROBERT MEN'S RIGHTS ACTIVIST				
LLOJ MIZASH QË JETOJNË NEPER DRURE							LLOJ KAFËJË LIDHËZ, APO		
HYJNËSHA HITTE E KAFSHËVE TË EGRA						ERSTEDI TOKË E PUNUAR		TEMPERATURA	SËMUNDJE E RENDË NGJITËSE
BANOR I MILANOS								LUJË (FRENGJ.) NIKO KANXHERI	
JHTARË TË MONIZMIT	ADEM DEMAÇI ZERO				LUMË NË KOSOVË SUEDIA				
M							DEMI		

ZGJIDHJET: P, JAVA, UMAR, KRETA, IRAK, GINA, AKIL, GA, I, ALEM, TASTIERAT, GERMAN TITOV, SME, DE NIRO, TERMIT, NES, INARA, OF, T, MILANAS, LO, AD, ERENK, MONISTË, KAU.

**Sudoku**

*shumë i lehtë*      *mesatar*

6	1	8	2	4	3	5	9	7	6	9	7	4	8	1	5	2	3
4	2	7	9	5	6	1	8	3	4	8	3	7	5	2	1	9	6
3	9	5	8	1	7	2	6	4	2	5	1	3	9	6	4	7	8
8	5	3	6	7	2	4	1	9	7	6	9	5	1	4	3	8	2
1	7	9	4	8	5	6	3	2	3	1	8	6	2	7	9	4	5
2	4	6	3	9	1	7	5	8	5	4	2	8	3	9	6	1	7
7	6	4	1	3	8	9	2	5	8	7	4	1	6	3	2	5	9
9	8	2	5	6	4	3	7	1	9	3	5	2	4	8	7	6	1
5	3	1	7	2	9	8	4	6	1	2	6	9	7	5	8	3	4

Shumë i lehtë: 618243597, 427956183, 395817264, 853672419, 179485632, 246391758, 764138925, 982564371, 531729846. Mesatar: 697481523, 483752196, 251396478, 769514382, 318627945, 542839617, 874163259, 935248761, 126975834.



# BESIMI VLEN MË SHUMË SE NJË “TË DUA”

*Dashuria nuk ka nevojë të ndihet, por të tregohet* — Paulo Coelho.



Ndonjëherë “të besoj dhe kam besim tek ty” vlen për shumë nga ne më shumë se “të dua”. Dashuria mbetet një etiketë kur nuk shoqërohet me vepra domethënëse që forcojnë lidhjen përmes kujdesit dhe vëmendjes. Pak fraza janë më të rëndësishme se “të besoj dhe jam me ty”. Të gjitha këto marrëdhënie përfshihen në atë që e njohim si psikologjia e besimit. Pak gjëra kanë një ndikim kaq pozitiv mbi trurin tonë sesa fakti i perceptimit se kemi një mbështetje të pakushtëzuar të personave që duam.

Kur vendosim një lidhje me dikë, qoftë partner apo mike, ajo që vlerësojmë më shumë dhe ajo që e forcon më shumë është mundësia e besimit tek personi në fjalë në mënyrë absolute dhe të pakushtëzuar. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë perceptojmë një mungesë sintonie ose një boshllëk në momentin kur kemi nevojë për të tillë mbështetje, diçka fillon e thyhet brenda nesh. Duam të na besojnë kur flasim për objektiva që kemi, kur themi disa gjëra nuk shkojnë mirë, kur themi me zë të lartë se do t’ia kalojmë edhe vetes. Nëse kjo nuk ndodh, nëse personi që kemi përballë ironizon, na injoron ose dyshon tek ne, truri ynë fillon e prodhon kortizol.

## BESIMI DHE MBËSHTETJA VLEN MË SHUMË SE NJË MIJË FJALË.

Në mjedisin e punës është e domosdoshme, diçka që shumë sipërmarrje

nuk e kanë marrë në konsideratë. Kështu administrator i Yahoo-së kërkon që të gjithë punonjësit të punojnë brenda të njëjtit bllok ndërtese, kërkon të kontrollojë çdo proces nga afër dhe për t’u siguruar që të gjithë departamentet të jenë brenda të njëjtës linjë. Të gjitha lidhjet njerëzore duhet të krijohen duke nisur nga besimi dhe për këtë motiv në momentin kur duhet shkrepur kreativiteti dhe produktiviteti i një punonjësi nuk ka më mirë se t’i thuash “kam besim tek aftësitë e tua dhe në përkushtimin tënd, unë të besoj kur më thua se do të bësh më të mirën për këtë firmë”. Besimi vlen më shumë se një fjalim, është një pohim pozitiv që na jep krahë. Shkencëtari i sjelljes Ernest Fehr thotë se besimi nuk është diçka që merret për të mirëqenë kur duam dikë ose kur kemi një lidhje miqësie apo dhe pune.

## KAM BESIM TEK VETJA, POR DUHET TË KESH EDHE TI.

Të paturit nevojë që edhe të tjerët të kenë besim tek puna jonë ose tek vërtetësia e veprimeve tona, nuk na transformon në qenie të varura pas pohimeve të tjerëve. Është shtylla e të gjitha marrëdhënieve. Ka nevojë fëmija për t’u rritur dhe për të rritur vetëvlerësimin dhe sigurinë, ka nevojë një çift për të siguruar stabilitetin dhe lumturinë.

## “MË JEPNI NJË LEVË DHE DO T’JU NGRE BOTËN” ARKIMEDI.

Besimi fiton mbi frikërat dhe tensionet kur e gjejmë veten të humbur. Një “të besoj” na bën të ndihemi më pak të vetmuar dhe nganjëherë na emocionon më shumë se një “të dua”. Ta dëgjosh këtë nuk na heq asnjë vlerë, as dinjitetin edhe pse besojmë tek vetja dhe tek aftësitë tona. Neuroshkenca na shpjegon se perceptimi i kësaj sigurie dhe ky lloj besimi na lejon të çlirojmë oksitocinë, hormoni i ndjenjave, i lumturisë dhe i lidhjes sociale. Fakti se mund të mbështeteni përditë mbi këtë, përcakton një sjellje pro sociale që garanton mirëqenien tonë psikologjike dhe një shëndet më të mirë mendor, shkruan bota.al. Nevoja për besim tek të tjerët është diçka që lind në ADN-në tonë. Të mbështetemi tek të dashurit tanë ka qenë gjithmonë një nevojë për mbijetesën tonë dhe për këtë psikologët, ekspertët në këtë fushë na thonë se nëse duam që të tjerët të kenë besim tek ne, duhet të fillojmë të kemi besim tek ata që kemi përpara. Jemi të ndërgjegjshëm se ndonjëherë na kushton, që jo gjithmonë është e lehtë edhe jemi mashtruar. Megjithatë në këtë mënyrë krijohen marrëdhënie më të pastra dhe në këtë mënyrë kemi marrëdhënie në çift më të lumtura dhe projekte profesionale më të forta.

## Aktori i “Slumdog Millionaire” tregon luftën me tumor

Aktori indian, Irrfan Khan, i njohur për rolet në “Slumdog Millionaire”, “The Amazing Spider-Man” dhe “Life of Pi” ka folur për luftën e tij me tumorin. Në Twitter ka shkruar se ka vuajtur nga një sëmundje e rëndë dhe e rrallë duke mos treguar më shumë. Ai ka treguar se si kishte udhëtuar shumë për të trajtuar tumorin. Për mediat italiane ai ka mohuar se ka vuajtur nga kanceri në tru, ndërsa nuk ka treguar se sa ka zgjatur trajtimin.



## KJO ËSHTË MOSHA KUR SHPENZONI MË SË SHUMTI PARA

Njerëzit janë më të prirë që të shpenzojnë më shumë para në moshën 31 vjeçare, sipas një studimi më të fundit. Ky studim u krye nga kompania ClearScore, e cila kishte anketuar tre mijë klientë të saj lidhur me shpenzimet e tyre. Ata kishin rënë në përfundim se personat në moshën 31 vjeçare do të shpenzojnë

rreth 60 mijë dollarë vetëm në atë vit. Megjithatë, 31 vjeçarët nuk shpenzojnë vetëm për qejf, pasi që ky vit del të jetë i mbushur me ngjarje të kushtueshme dhe të veçanta që kërkojnë shpenzime të konsiderueshme parash. Ndër to, përfshihet edhe martesja, blerja e një shtëpie, lindja e një foshnjeje.

KALENDARI HISTORIK 19 MARS

1452 - Frederiku III i Habsburgëve kurorëzohet Perandor gjerman.

1571 - Trupat spanjolle okupojnë Manilën.

1644 - 200 anëtarë të familjes perandorake në Pekin bëjnë vetëvrasje.

1682 - Këshilli Nacional pranon pavarësinë e Kishës franceze.

1702 - Bija e Xhejms II, Anne Stuart shpallet mbretëreshë e Anglisë.


1775 - Polonia dhe Prusia nënshkruajnë marrëveshje tregtare.

1927 - Betejë e përgjakshme mes komunistëve dhe nazistëve në Berlin.

1931 - Nevada legalizon bixhozin.

1972 - India dhe Bangladeshi nënshkruajnë traktat miqësie.

Prekja e çelikut do të heqë erë e hudhrës dhe qepës nga duart tua. Për këtë qëllim, në disa vende shiten enkas disa lloj “sapunësh” prej çeliku inoks.



Nëse kukullat Barbi do të ishin të vërteta, ato do të qenë shumë të dobëta për të patur fëmijë, dhe shumë jo proporcionale për të ecur drejt.

**KUR POLICIA NDAL MINISTRIN**  
Ministri i Brendshëm nisat në rrugë me veturë dhe e ndal policia.  
- Librezën dhe lejen e vozitjes... Ooo, qenkeni ju z. ministër. Më falni, vazhdoni...  
- Jo, jo. Veproni ndaj meje si ndaj çdo qytetari!  
- Në rregull ministër, futi nja 20 euro në librezë dhe jeni të lirë të vazhdoni...



Çdo njeri duhet të zgjedhë, nëse duhet të ecë në dritën e altruizmit konstruktiv, apo në errësirën e egoizmit shkatërrues.  
**(Martin Luther King Jr)**

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS